

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7555 E diel 10 Qershor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

## Opinion *i* Ditës

**D**ara tre javësh, forcat e policisë belge në ndjekje të një furgoni me refugjatë shtinë dhe vranë Mawdën, 2 vjeçaren kurde irakiene. Kjo ngjarje shkaktoi një stuhi ...  
Vijon në faqen 21

Nga JORGJI KOTE

Nga frenimi të zgjidhja e krizës



## Dje *në* "Europa e Lire"

Nga ARTION KONUSHEVCI

**I**nstitucionet e Kosovës janë duke lu vonuar me miratimin e pakos së ligjeve që dalin si nevojë për përbushjen e kriterëve në procesin e integrimi ...  
Vijon në faqen 22

Ecja e ngadaltë e Kosovës me agjendën europiane



Vasili kundër Ramës: Të ikë me vrap refugjat

## Presidenti thirrje partive: Të punojmë bashkë për integrimin, s'na duhen konfliktet

Kamp për ish-luftëtarët e ISIS? Presidenti: Askush nuk e cenon sigurinë kombëtare

VALENTINA MADANI

Presidenti Ilir Meta kërkoi sërish dje bashkëpunimin e palëve politike në vend në funksion të integrimit dhe çeljes së negociatave me BE. Sipas tij bashkëpunimi mes palëve politike ndihmon procesin e integrimit. Nga Pusteci ...  
Në faqen 2

## NGA 1 PRILLI 2018 LIGJI HYRI NE FUQI, RRUGET SI DO TE VILET DIFERENCA NGA BASHKITE

# TAKSA E RE E SHTEPISE, JA KUR DO NISE PAGESA

Shtesa e re për taksën e banesës do të merret pas përfundimit të kadastrës fiskale. Bashkitë do të vjelin më vonë diferencën e paracaktuar



(Në foto) Pallate në Tiranë

Në faqen 5

### FLASIN TE AFERMIT

**Vrasja e 40-vjeçares, daja i viktimës: Mbesa dhunohej shpesh nga burri, e kish denoncuar**

Në faqen 8

### HISTORIA

**Vrasja e paralajmëruar në zonën e 'Don Boskos', 19-vjeçarja denoncoi mes lotësh Xhafer Matën**

Në faqen 7

### NDRYSHIMET NE LIGJ

**Sigurimi i makinave për shitblerjen e mjetit, siguracioni duhet bërë nga e para**

Në faqen 6

### LISTA E TRETE

**10 mijë pronarët në Korçë, shqyrtimi nga ATP dhe procedurat për t'u njohur me ecurinë**

Në faqen 9-11



Në nderim të 140-vjetorit të Lidhjes shqiptare të Prizrenit

## Lidhja islamike, që u shndërrua në Lidhjen shqiptare

*Kararnameja, i vetmi dokument i miratuar në këtë kuvend, përshkohej nga besnikëria ndaj sultanit dhe Sherijatit*

Nga GAZMEND SHPUZA

**K**uvendi historik i Prizrenit, në të cilin u themelua Lidhja Shqiptare, i mbajtur pranë Bajrakkhami-së të këtij qyteti ka mbetur i pa vlerësuar dhe madje i anatemuar keqas si një tubim i organizuar dhe i manipuluar



nga elementët sultanistë. Kararnameja, i vetmi dokument i miratuar në këtë kuvend, përshkohej nga besnikëria ndaj sultanit dhe Sherijatit. Edhe vetë organizata e porsakrijuar qenka quajtur lidhje islamike dhe më vonë u quajt Lidhja Shqiptare! ...  
Suplement

### MESAZHI I RAMES



**Reforma në drejtësi, Rama: Në sitë dhe politikanët, dhe pronarët e mëdhenj**

Në faqen 3

# NEGOCIATAT DIALOGU

Kamp për ish-luftëtarët e ISIS? Presidenti: Askush nuk e cënon sigurinë kombëtare

## Skeptikë për negociatat, Meta thirrje partive: Jo frymë konfliktuale

"Të punojmë bashkë, çdo mundësi për integrimin"

Valentina Madani

Presidenti Ilir Meta kërkoi sërish dje bashkëpunimin e palëve politike në vend në funksion të integrimit dhe çeljes së negociatave me BE. Sipas tij bashkëpunimi mes palëve politike ndihmon procesin e integrimit. Nga Pusteci, Meta është pyetur lidhur me tri vendet skeptike, Franca, Holanda dhe Danimarka, për hapjen e negociatave. "Unë besoj se janë të gjitha mundësitë që vendi ynë të ketë sukses duke marrë një mesazh pozitiv. Këshilli i vendeve anëtare të BE-së në mbështetje të rekomandimit pozitiv të KE-së dhe për këtë të gjithë duhet të punojmë të angazhohemi për mirë, për pritsmëritë jo vetëm të partnerëve tanë, por edhe të këshilltarëve në mënyrën më të përgjegjshme dhe bashkëpunuese, jashtë çdo fryme konfliktuale dhe përjashtimi artificial", - tha z.Meta. Nga ana tjetër, theksoi se askush nuk e cënon sigurinë kombëtare aq më tepër në prag të sezonit turistik. Presidenti i Republikës ishte dje i pranishëm në Pustec për çeljen e sezonit turistik. Ai vizitoi dhe Kishën e Shën Marisë në ishullin e Maligradit nga ku ftoi turistët vendas dhe të huaj të shijojnë bukuritë natyrore e të pakonkurueshme të kësaj zone, veçanërisht të liqenit të Prespës, mikpritjen e jashtëzakonshme dhe gatimet tradicionale. "Së bashku me autoritetet vendore çelëm sot sezonin turistik në Bashkinë Pustec. Ftoj turistët vendas dhe të huaj të shijojnë bukuritë natyrore e të pakonkurueshme të kësaj zone, veçanërisht të liqenit të Prespës, mikpritjen e jashtëzakonshme dhe gatimet tradi-



Presidenti Ilir Meta, me banorët e Pustecit

### Paloka: Rama i jep naftë firmës ruso-serbe të Putinit dhe u vë trarin me pagesë kosovarëve

Demokratët akuzojnë kryeministrin Rama se po i jep naftë shqiptare firmës së ruso-serbe të Putinit. Nënkyretari Edi Paloka shprehet se gjithçka ndodh pasi vetë qeveria ka akuzuar PD si të lidhur me rusët dhe iu ka vënë trarin me pagesë kosovarëve. "I jep detin me gjithë zonë në naftëmbajtëse Greqisë, pasi ka eliminuar krejtësisht Gjykatën Kushtetuese (kështu askush nuk e pengon zbatimin e marrëveshjes që ka bërë). Vetë ofrohet për të kthyer vendin në një kamp të madh refugjatësh nga Siria dhe Afrika ndërkohë që ka çuar refugjatët 400 mijë shqiptarë", shkruan më tej Paloka në "Fb". Paloka deklaroi se Shqipëria është dakordur si ishulli i kirit në Europë ndërsa Rama akuzon opozitën se pengon integrimin pasi ka mbrojtur Tahirin e vazhdon të mbajë Xhafajn ministër të Brendshëm. "E ndërkohë shqiptarët vazhdojnë të vriten e vetëvriten", - thotë Paloka duke shtuar: "Çfarë Hamza! Çfarë Esat Pashe? Ky është Edvin Rama. Hapni sytë sa nuk është vonë, nga Prishtina në Tiranë."



cionale. E mahnitshme Kisha e Shën Marisë në ishullin e Maligradit. I uroj sezon të mbarë turistik Bashkisë së Pustecit, ku kam vendosur të kaloj disa ditë gjatë pushimeve verore", - tha z.Meta. Presidenti u prit nga autoritetet

të më të larta vendore si dhe nga dhjetëra banorë të minoritetit maqedonas. "Kënaqësi e veçantë të vizitoj Bashkinë e Prespës. I uroj sezon të mbarë turistik. Ftoj turistët të shijojnë bukuritë përballore e të pakonkur-

**THIRRJA**  
"Këshilli i vendeve anëtare të BE-së në mbështetje të rekomandimit pozitiv të KE-së dhe për këtë të gjithë duhet të punojmë të angazhohemi për mirë, për pritsmëritë jo vetëm të partnerëve tanë, por edhe të këshilltarëve në mënyrën më të përgjegjshme dhe bashkëpunuese, jashtë çdo fryme konfliktuale dhe përjashtimi artificial", - tha z.Meta.



### Kampi, Vasili: Kryeministri të ikë refugjat

Kreu i Grupit Parlamentar të LSI, Petrit Vasili, në një postim në "Facebook" shprehet se nuk na duhen refugjatët në Shqipëri, por na duhet që shqiptarët të mos ikin më si refugjatë nëpër botë. "Le të ikë kryeministri si refugjat, që shqiptarët të jetojnë e të punojnë në vendin e tyre, sepse "guri rëndon në vendin e vet". Boll më me këta armiq malinjë në krye të qeverisë, që e duan Shqipërinë pa shqiptarë. Tani le të presim bedelin e radhës të kryeministrit për të bërë përkthimin përkatës nga shqipja në shqip", - tha z.Vasili.

rueshme të kësaj zone, mikpritjen e jashtëzakonshme dhe gatimet tradicionale të zonës. Disa ditë nga pushimet e mia verore do t'i bëj në liqenin e drekullueshëm të Prespës. Duke ruajtur identitetin, traditat dhe vlerat e sh-



Presidenti Ilir Meta, me banorët e Pustecit

### Qendër rehabilitimi për ish-terroristët e ISIS

## Dy arsyet, Berisha akuza Ramës: Premtave njësoj si me armët kimike

Ish-kryeministri Sali Berisha reagoi pas lajmeve që qarkulluan në media se në Shqipëri mund të ndërtohej një qendër rehabilitimi për ish-terroristët e ISIS. Berisha theksoi se premtimi i Ramës për ndërtimin e kampit ishte njësoj si rasti me armët kimike siriane. Sipas Berishës, Rama e përgënjeshtroi lajmin përmes zëdhënësit të tij, njëlloj siç bëri me lajmin e pranimit të arsenalit të armeve kimike të Sirisë. "Premtimi i Ramës për kampet e rehabilitimit të ish-terroristëve të ISIS, njëlloj si ai për shkatërrimin e armëve kimike siriane! Më ketë akt Rama ka dy synime: Të mbulojë narkoshtetin, lidhjet e tij me krimin, drogën, kapjen e drejtësisë, dërgimin e mbi 300 mijë refugjatëve dhe azilkërkuesve nga Shqipëria në vendet e BE dhe të mund të marrë hapjen pa kushte të negociatave me BE. Por ky është një pretendim absurd pasi vetë kryeministri Borisov, që informoi shqiptarët për kampet e ISIS në Shqipëri, deklaroi po në atë konferencë shtypi se nuk ka hapje të negociatave pa kushte me Shqipërinë pasi shumica e vendeve të BE janë të përcaktuara për vendosjen e kushteve për hapjen e tyre! Synimi tjetër madhor i vendosjes së mijëra e mijëra ish-terroristëve të ISIS, dhe sipas "Le Monde" edhe të rreth 600 mijë refugjatëve në Shqipëri, është trafikimi i tyre masiv drejt Italisë nga mafia shqiptare e lidhur direkt me Ramën, e cila, sipas burimeve serioze inteligjente, tre vjet më parë ka porositur për këtë qëllim në vendin fqinj mbi 300 sfafe të fuqishme për të trafikuar për qëllime fitimi refugjatët drejt brigjeve të Italisë, duke shndërruar kështu Otranton në varrin gjigand të Europës!

Ju bëj thirrje vendeve të BE të hedhin poshtë ofertë në hipokritë të Edi Ramës, e cila krijon probleme shumë herë më të mëdha se sa zgjidh, ofertë me të cilën ai kërkoi t'u hedhë hi syve për mos zbatimin e kushteve për hapjen e negociatave pa kushte dhe të sigurojë një burim të ri të madh të pasurimit të mafies shqiptare, të cilën ai vetë e udhëheq", - tha z.Berisha.

këlqyera të minoritetit maqedonas, Bashkia e Pustecit mund të shndërrohet në njërin nga bashkitë më të begata të vendit. Është me përparësi zhvillimi dhe promovimi i turizmit", u shpreh presidenti. Më tej, Meta i shoqëru-

ar nga autoritetet vendore vizitoi Kishën e Shën Mhillit në Bashkinë Pustec po kështu edhe ishullin e Maligradit. "Kjo perlë e natyrës, është një destinacion atraktiv i turizmit që duhet vizituar", - u shpreh presidenti.





“Drejtori i Policisë grisi banderolën e PD”, Basha: Kacafytet me qytetarët për të mbrojtur shefin

Të rinjtë e Forumit Rinor të PD-së në Lushnje dhe Fier e pritën me protesta kryeministrin Edi Rama. Jashtë ambienteve ku z.Rama po zhvillonte takimin me qytetarë të zonës mbi llogaridhënien publike, të rinjtë u pozicionuan me parulla në duar ku shkruhej “Qeveri mafioze”, “Qeveria e drogës”, “Rama hajdut”. Por PD-ja flet për një tjetër inskenim të takimeve të kryeministrin Edi Rama me qytetarët gjatë turit të llogaridhënies publike. PD deklaroi se në Lushnje qytetarët e dyshimit, që nuk ishin kontrolluar më parë nga të besuarit e Ramës nuk janë lejuar të marrin pjesë në takimin e llogaridhënies. PD nxori edhe një video, ku sipas saj një qytetar kërkoi të marrë pjesë me dëshirën për t’i bërë një pyetje kryeministrin, por policia e ndaloi t’i afrohet zonës ku Rama po kryente takimin. Po kështu sipas PD, aty kanë protestuar edhe qytetarë të tjerë, kundër bashkëqeverisjes me krimin. Ndërsa për protestën e Fierit PD publikoi videon ku tregon se drejtori i policisë së Fierit, Albert Nushi, që ka grisur banderolën e të rinjve protestues. “E paprecedent! Drejtori i policisë Fier grisi banderolën e PD kundër bashkëqeverisjes me krimin!” shprehet PD. Për këtë ka reaguar edhe kreu i PD, Lulzim Basha, i cili në një status në Facebook shkruan: “Shihni si ka përfunduar policia e shtetit: një polici private në shërbim të dyshes Rama-Xhafaj. Drejtori i policisë i pari dhe policët e tjerë pas tij rrëmbejnë dhe grisin banderolën e qytetarëve që protestojnë paqesisht dhe me dinjitet kundër krimit dhe drogës. Polici që kacafytet me qytetarët për të mbrojtur shefin! Turp dhe mjerim!”

Ministrja Gjonaj: Shumë shpejt zgjidhje për Gjykatën Kushtetuese

Nëse procesi i vettingut ecën në këto ritme, ngritja e institucioneve të reja të drejtësisë, pikërisht këshillit të lartë të prokurorisë dhe atij gjyqësor mund të nisë që nga muaji shtator. Kështu deklaroi për News24, ministrja e Drejtësisë Etilda Gjonaj. Ajo bëri të ditur se 57 subjektet që janë kandidatë për institucionet e reja, janë në listën prioritare dhe për 15 prej tyre është dhënë një vendim. Në lidhje me situatën e krijuar në Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë, ministrja e Drejtësisë tha se çështja në Gjykatën Kushtetuese do të zgjidhet shumë shpejt, pasi presidenti dhe Kuvendi kanë hapur një proces për kandidatët. Për të shpejtuar dhe mbështetur procesin e vettingut dhe institucioneve të reja të reformës në drejtësi, qeveria ka ofruar financime jo vetëm për pjesën e pagave, por edhe për krijimin e institucioneve me kushtet më komode. Rasti më i fundit është ai i ambienteve të kolegjit të apellimit dhe komisionerëve publikë. Gjonaj tha se në 1 janar 2019 për ata që do kalojnë vettingun do të fillojë dhe rritja e pagave. Procesit të vettingut priten t’i nënshtrohen në total rreth 157 subjekte, 57 prej tyre janë në listën prioritare pasi konkurrojnë për institucionet e reja.

Kryeministri në Lushnje dhe Fier: Nuk kemi saldatorë, vijnë e punojnë nga Tajlanda dhe Kina

# Reforma, Rama: Drejtësia do merret me politikanët dhe biznesmenët

“Vetingu, dardha e ka bishtin pas”

Kryeministri Edi Rama paralajmëroi dje se pas gjyqtarëve dhe prokurorëve, pjesë e procesit të vettingut do të jenë edhe politikanët e biznesmenët. Gjatë turit të llogaridhënies në Lushnje dhe Fier kryeministri teksa u ndal te numri i madh i ankesave nga ana e qytetarëve për çështje që kanë lidhje me gjyqësorin u shpreh se reforma nuk do të ndalet. z.Rama deklaroi se “dardha e ka bishtin pas” dhe se reforma në drejtësi nuk do të ndalet deri sa sistemi të pastrohet nga të gjithë të korruptuarit në çdo nivel që ata janë. Në rrjetën e një drejtësie të pa kapur kryeministri paralajmëroi se do të bien jo vetëm drejtues nga radhët e saj, por edhe politikanë e biznesmenë. “Sistemi i pastruar i drejtësisë presupozohet se do të merret me të gjithë, politikanë, gjykatës prokurorë, biznesmenë si të barabartë përpara ligjit, natyrisht kjo do kërkojë kohën e vet dhe nuk bëhet sa hap e mbyll sytë”, tha z.Rama.



Kryeministri Edi Rama

PARALAJMËRIMI

Në rrjetën e një drejtësie të pakapur kryeministri paralajmëroi se do të bien jo vetëm drejtues nga radhët e saj, por edhe politikanë e biznesmenë. “Sistemi i pastruar i drejtësisë presupozohet se do të merret me të gjithë, politikanë, gjykatës prokurorë, biznesmenë si të barabartë përpara ligjit, natyrisht kjo do kërkojë kohën e vet dhe nuk bëhet sa hap e mbyll sytë”, tha z.Rama.

it të Fierit për sezonin e ardhshëm veror. Ai gjithashtu, tregoi projektet për rafinerinë e naftës apo programin e 100 fshatrave pasi sipas tij turizmi është motori i ekonomisë për vendin tonë. “Bypassi i Fierit është bërë stres i madh për të gjithë ata që jetojnë në këtë zonë, por edhe për turistët e shumtë. Ky do të jetë viti i fundit të këtij stresi, se prishëm kontratat me ko-

mpanitë ekzistuese pasi nuk paguanin njëri-tjetrin. Në shtator nisim e nuk e ndalim më punën përpara sezonit tjetër turistik. Qeveria ka një plan mbështetje për të gjithë atë që do investojnë në agroturizim, për të krijuar kushtet për të pasur një mikpritje, nga tryezat e deri te dhomat e fjetjes, për të pasur dallim nga restorantet në përgjithësi. Kush merret sot me agro-

turizëm bën para. Rafinimi i naftës është në rrugë të mbarë se kemi një kontratë të re. Për të rritur kapacitetet e rafinerisë, sigurinë dhe prodhimin. Uji i pijshëm ka qenë problem dhe është kthyer në një pikë parësore për ne. Do ndërtojmë ujësjellës të rinj. Por duhet të vazhdojmë të përmirësojmë problemet me përmblytjet, prandaj do bëjmë ndërhyrje të thella që ta eliminojmë”, theksoi z.Rama. Në Shqipëri tha Rama vijnë saldatorë nga Tajlanda dhe nga Pakistani, ndërsa theksoi nevojën për arsim profesional. Sipas tij, punë ka, por s’ka profesionistë. “Kjo është shprehja që e dëgjon nga çdo kompani, që kemi vende të lira pune, por na mungojnë profesionistët që mund të mbulojnë këto vende pune. Saldatorë nga Tajlanda, saldatorë nga Turqia, nga Pakistani, saldatorë nga fundi botës janë sot në Shqipëri dhe punojnë. Punojnë për stadiumin e Arenës Kombëtare, punojnë në investimet e mëdha për TAP, pse? Sepse kemi mungesë për saldatorë. Po jap vetëm një shembull, d.m.th. vijnë nga Tajlanda, nga Pakistani, nga Turqia, nga Kina saldatorë kinezë, dhe paguhen nga kompani shqiptare”, tha Rama.

Reforma, deputeti i PD: Do vijnë kriza të tjera

## Drejtësia, Bylykbashi: Simptoma e dështimit, duhen rishikuar ligjet

Në një kohë kur mazhoranca po kërkon t’i hapë rrugë emërimit dhe pranimit në Shkollën e Magjistraturës të prokurorëve dhe gjyqtarëve të rinj, demokratët shprehen se ndryshimet e propozuara nga socialistët në ligjin për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë janë simptomë e dështimit të reformës në drejtësi. Demokrati Oerd Bylykbashi tha se për të dalë nga ky kolaps duhen rishikuar ligjet e reformës në drejtësi. “Sot ata që kanë bërë keq reformën në drejtësi, po bëjnë edhe propozimin si të ndreqin atë që ka shkuar keq. Nuk mund të kurohet një sëmundje terminale e atij ligji dhe atij sistemi me aspirina. Ose rinegociohen



termat thelbësore të ligjit për organizimin dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë, ose ne do të vazhdojmë të shohim kriza të tilla. Kjo është diçka që sigurisht nuk do t’i japë zgjidhje, do vijnë kriza të tjera”, theksoi Bylykbashi për TvKlan. Sipas tij, arkitektura e re kushtetuese e atij ligji dhe atij sistemi me bazament të reformës në

drejtësi. Për pasojë një gjë e tillë ka çuar në bllokimin e institucioneve të drejtësisë, mes të cilave edhe Gjykatën Kushtetuese, që ka mbetur me tre anëtarë, nga të cilët njëri me mandat të përfunduar. “Po nga këto ligje sot ne kemi bllokimin e Gjykatës Kushtetuese. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi sot nuk funksionon, Gjykata e Lartë është praktikisht e mbaruar, sepse nuk mund të kryejë funksionet e veta kushtetuese siç i kërkon. Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe ai i Prokurorisë nuk janë ngritur. Pra, të gjitha këto janë pasojë kryesive e këtyre ligjeve që u bënë keq, në theyerje e në tradhti të konsensusit kushtetues të 22 Korrikut 2016”, tha ai.

## ZGJEDHJET AKUZAT

Vokshi publikon përgjigjen e Komisionerit: Të pezullohen Manastirliu dhe Nikolla

# PD: Kriminale, qeveria po mbledh të dhënat për vjedhjen e zgjedhjeve

## Hetimi, dorëzohet padia penale në prokurori

Valentina Madani

Demokratët përmes deputetes Albana Vokshi akuzuan dje qeverinë se po përgatit manipulimin e zgjedhjeve të ardhshme. Konkretisht Vokshi denoncoi Ministrinë e Arsimit dhe atë të Shëndetësisë se po grumbullojnë të dhënat personale të prindërve, punonjësve dhe pacientëve për t'i përdorur për zgjedhjet. Ajo përmendi se Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka konfirmuar paligjshmërinë e mbledhjes së informacioneve private për rreth 80 përqind të votuesve nëpërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Kryetarja e Komisionit të Medias, Albana Vokshi publikoi përgjigjen e dytë zyrtare nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ashtu siç PD kishte ngritur shqetësimin, Hetimi i Komisionerit konfirmoi denoncimin e PD-së, tha Vokshi, kur shprehet se "mbledhja e të dhënave dhe përditësimi i tyre nga Ministria e Shëndetësisë nuk mbështetet në asnjë bazë ligjore", pra asnjë akti ligjor apo nënligjor duke nxjerrë zbuluar mashtrimet e ministereve Manastirliu dhe Nikolla. "Në shkresën e parë, Komisioneri Urdhëronte pezullimin e menjëhershëm të të dhënave nga Ministria e Arsimit. Në këtë shkresë, Rekomandim, Komisioneri vë në dijeni që pas kërkesës së PD-së, ka kryer edhe një hetim administrativ në Ministrinë e Shëndetësisë. Në Rekomandimin nr. 21 të datës 31 maj, Komisioneri shprehet qartë se urdhri i ministres Manastirliu që kërkon nga pacientët dhe administrata "numrin personal të identifikimit" është në shkelje flagrante të ligjit "Për mbrojtjen e të dhënave personale" deklaroi znj. Vokshi. Sipas saj Komisioneri vlerëson se në shkelje të ligjit është, gjithashtu, numri i madh i të dhënave të tjera të kërkuara nga ministria e Shëndetësisë, e cila e nisi procedurën e paligjshme me urdhër të Edi Ramës. "Legjislacioni në fuqi e ndalon rreptë-



Deputetja e PD-së, Albana Vokshi

### DENONCIMI

Deputetja e PD-së, Albana Vokshi denoncoi Ministrinë e Arsimit dhe atë të Shëndetësisë se po grumbullojnë të dhënat personale të prindërve, punonjësve dhe pacientëve për t'i përdorur për zgjedhjet.



Foto ilustruese

### PADIA

PD ka dorëzuar padinë penale në prokurori për veprën penale "shpërdorim i detyrës" dhe "përdorim të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore", duke kërkuar pezullimin nga detyra të ministereve Manastirliu dhe Nikolla, deri në hetimin e plotë nga ana e prokurorisë.

## Kreu i PDIU: Na vodhën mandatet, por nuk na zhbëjnë dot

### Idrizi: Strategji që të na linin jashtë Kuvendit, të bënin rehat paktin me Greqinë

Kreu i PDIU-së, Shpëtim Idrizi, akuzoi dje qeverinë për vjedhjen e mandateve dhe se partinë e tij tentuan që ta zhduknin. Para Këshillit Kombëtar të PDIU-së, Idrizi deklaroi se qeveria mund t'i vidhte PDIU mandatet, por historinë sipas tij nuk mund ta zhdukni. "Sido që të marrin votat, të na marrin mandatet, nuk mund të na zhbëjnë se nga veriu në jug do na kenë si një thumb, ngulur në trurin e tyre. Nuk e prishin dot këtë lëvizje, pasi kjo është partia e madhe. Ata mund të vjedhin mandatin e Idrizit, Takut, Mesilës, por nuk e vjedhin dot misionin tonë. S'e vjedhin dot Çamërinë, sado që të flasësh për të, sado të përbotesh për të. Pas një viti që u krye ai turp, siç ishin zgjedhjet, pasojat janë këto. Ata tentuan të lënë jashtë Kuvendit PDIU. Jo vetëm për të pa-



### AKUZA

"Ka qenë një strategji e qartë që të mos kishte përfaqësim të Çamërisë në Kuvendin e Shqipërisë, madje kërkesë e prerë e "vëllezërve" grekë të miqve të rinj të valleve", -tha z. Idrizi.

sur tepsinë me veten, por u bë e qartë kur çështja çame nuk përfshihet në programin e qeverisë", tha Idrizi. Sipas tij, PDIU do të kishte më shumë mandate se çdo herë tjetër, nëse nuk do të ishte marrëveshja e jashtëligjshme bipartiake për ndalimin e koalicioneve.

"PDIU do të kishte sot në parlament shtatë deputetë, nëse do të përkthehej në mandate numri i votave që ne morëm kudo nga veriu në jug. PDIU do të ishte vendimtare në përcaktimin e shumicave, nëse do të zbatohet Kodi Zgjedhor, por kjo nuk ndodhi, sepse u luajt një

farsë që sot ka vënë në rrezik demokracinë, ekuilibrat e shtetit që si kurrë më parë ndodhet sot në zgrip. Mbetja jashtë parlamentit e drejtuesve politikë të PDIU vjen si pasojë e faktorëve të jashtëm, të cilët i përmenda dhe më parë, por kjo nuk do të thotë se nuk ka pasur gabime ndër në organizimin e brendshëm. Për këtë duhet të nisim ringritjen e strukturave tona, zgjedhjet në të gjitha nivelet e PDIU-së nga kryetari e më poshtë për ta bërë PDIU më të madhe sesa realisht është. Mungesa jonë në këtë institucion të lartë ka bërë që jo vetëm qeveria, por as opozita të mos artikulojnë më Çështjen Çame, duke e "harruar" atë brenda ditës", -tha kreu i PDIU.

### Nishani: Skandal, qeveria po përgatit manipulimin e zgjedhjeve

Pas akuzave të bërë publike nga Partia Demokratike se qeveria po mbledh të dhëna personale të prindërve dhe pacientëve për zgjedhjet e ardhshme, reagoi ashpër ish-presidenti Bujar Nishani. Ky i fundit përmes një status në 'Facebook' e cilësoi skandal veprimin e qeverisë, që sipas tij nuk ndodh në asnjë vend normal. Mes të tjerash ai u bëri thirrje shqiptarëve të vepronjë. "Qeveria shqiptare urdhëron marrjen e të dhënave personale të shqiptarëve duke përdorur shkollat dhe spitale. Qëllimi: manipulimi i zgjedhjeve! Një skandal që nuk mund të ndodhë në asnjë vend normal. Bota demokratike duhet ta dënojë këtë praktikë autoritariste. Veproni tani!", u shpreh ish-kreu i shtetit, z.Bujar Nishani.

pasi qëllimi i vetëm i mbledhjes së tyre është keqpërdorimi. Vokshi bëri të qartë se PD-ja është e vendosur ta ndjekë këtë çështje me të gjitha format institucionale si dhe do ta adresojë në institucionet përgjegjëse të BE për të frenuar këtë marrëzi me efekte jo vetëm elektorale, por me shumë gjasa edhe kriminale.



Pronat, taksat nga një prilli. Detyrimi do paguhet nga koha e hyrjes në fuqi

Ornela Manjani

**D**etyrimi i familjeve për ta paguar taksën e pronës sipas formulës së re ka filluar që nga data 1 prill e këtij viti. Edhe pse shumica e bashkive vazhdojnë ta mbledhin taksën sipas formulës së vjetër, qytetarët do ta paguajnë diferencën e detyrimit mes taksës së re dhe asaj të vjetrës, në një kohë të mëvonshme. Kjo vlen edhe për qytetarët e Tiranës. Vendimi i Bashkisë së Tiranës për të shtyrë mbledhjen e taksës së pronës sipas formulës së re, nuk shpëton hyrjen e saj në fuqi, por vetëm kohën kur do të bëhet pagesa. Deri në datën 31 mars taksa e pronës ka qenë fikse mbi sipërfaqen. Por nga data 1 prill taksa ka ndryshuar me ligj duke u bërë 0.05 për qind e vlerës së pronës. Për shkak se nuk janë gati nga ana teknike shumica e bashkive të vendit, përfshirë atë të Tiranës vazhdojnë ta mbledhin taksën sipas formulës së vjetër. Por në momentin që do të kenë gati hartat kadastrale, atëherë bashkitë do të bëjnë automatikisht rakordimin, mes detyrimit që duhet të paguajnë familjet sipas taksës së re dhe atij që kanë paguar sipas taksës së vjetër. Formula e re e taksës pronës është ndryshuar me ligj në parlament dhe nuk mund të ndryshohet nga asnjë bashki. Mënyra e vetme për të shtyrë hyrjen në fuqi të saj është përmes ndryshimit të ligjit nga parlamenti, por burime nga qeveria thonë se nuk ka asnjë plan për të ndryshuar ligjin, ndaj familjet do ta paguajnë detyrimin sipas taksës së re duke filluar që nga data 1 prill e këtij viti.

**TAKSA MBI NDËRTESEN**

"Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohen ndryshe. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa lege". Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përlogarjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi. Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzimi i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën", thuhet në nenin 22 të ligjit.

# Shtesa e re për taksën e shtëpisë, pas përfundimit të kadastrës fiskale

Bashkitë, që marrin paratë me formulën e vjetër, do të vjelin më vonë diferencën



Foto ilustruese

**SHKALLA E TAKSËS MBI NDËRTESAT**

- 0.05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- 0.15% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
- 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtim

## Qafë Kashar-Vorë e bllokuar të hënën dhe të martën

### ARRSH nis ndërhyrjen në autostradë

**F**illimi i javës që vjen do ta gjejë segmentin Qafë Kashar-Vorë të bllokuar. Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Policia Rrugore do të fillojë ndërhyrjen emergjente për riparimin e shtresave asfaltike në aksin Qafë Kashar - Durrës dhe Durrës-Qafë Kashar. Nga ana e Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe Policisë Rrugore është hartuar një plan operacional i ndërhyrjes dhe devijimit të trafikut për të shmangur bllokimin e qarkullimit dhe garantuar mbarëvajtjen e punës në terren. ARRSH dhe Policia Rrugore u kërkojnë drejtuesve të mjeteve sa vijon lëvizja e mjeteve të rënda në drejtim të veriut duhet të bëhet përmes Kamzës nga rreth rrotullimi Casa Italia. Ndërsa autoveturat që shkojnë në drejtim të Durrësit do të përdorin daljen tek pika e furnizimit Kast-rati dhe mbikalimin për



Kashar në drejtim të Vorës. Drejtuesit e mjeteve që kanë si destinacion jugun, duhet të përdorin drejtimin nga Elbasani si dhe kthimin për Tiranë të përdorin sërish drejtimin nga Elbasani. Sipas njoftimit mësohet se mjetet me kalim nga Rinas drejt Durrësit duhet të përdorin rrugën dytësore Qafë Kashar-Vorë (300 m përpara mbikalimit të Kasharit) ose

në drejtim të aksit Rinas-Vorë në drejtim të doganës. "Në mënyrë të veçantë drejtuesit e mjeteve që përdorin segmentin Tiranë-Durrës dhe kthimin duhet të përqipen të zgjedhin drejtime alternative sipas udhëzimeve që do të jepen në vazhdimësi nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Policia Rrugore. Punonjësit e Autoritetit Rrugor Shqiptar, Policisë Rrugore dhe firmave të mirëmbajtjes do të jenë me njësi të përqendruara në terren për mbarëvajtjen e ndërhyrjes dhe orientimin e trafikut. Ju kërkohet drejtuesve të mjeteve që të respektojnë në mënyrë rigoroz rregullat e qarkullimit rrugor, sinjalistikën provizore të vendosur në segmentet ku do të punohet dhe udhëzimet e policisë. Ndërhyrja për gjithë autostradën në dy senset do të realizohet gjatë muajit Qershor", thuhet në njoftimin e ARRSH.

**Mbledhja e taksës**

**Njësia e vetëqeverisjes vendore është autoriteti përgjegjës për funksionet në administrimin e taksës mbi ndërtesën, sa i përket pasurisë (ndërtesës) që është në juridiksionin e saj, si më poshtë vijon:**

- Mbledhjen dhe menaxhimin e informacioneve mbi ndërtesën për qëllime fiskale;
- Përditësimin e të dhënave të regjistrat qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (kadastra fiskale);
- Mbledhjen me forcë të detyrimeve të taksës mbi ndërtesën; ■ Korrigjimin e të dhënave në lidhje me llogaritjen e taksës, në rastet e saktësimin të informacionit për sipërfaqen, vendndodhjen zonale, çmimet e tregut etj.;
- Shqyrtimin e ankimit administrativ të taksapaguesve.

**PËRJASHTOEN NGA TAKSA MBI NDËRTESAT:**

- pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- banesat sociale në pronësi të bashkive;
- pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- strukturat akomoduese "Hotel me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit".

## Trafiku gjatë sezonit veror

Udhëzimi: Ja automjetet dhe akset ku do kufizohet qarkullimi

**M**inistri i Infrastrukturës dhe ai i Brendshëm kanë përcaktuar kategoritë e automjeteve dhe akset rrugore, ku do të ndalohej qarkullimi i mjeteve të rënda në fundjavat përgjatë sezonit veror, por edhe në ditët e festave zyrtare. Referuar udhëzimit të firmosur nga Damian Gjiku dhe Fatmir Xhafaj, në fundjavat e periudhës 15 qershor-15 shtator do të ndalohej qarkullimi i mjeteve rrugore me peshë mbi 7.5 tonë si dhe për ato me gjatësi maksimale më të madhe se 12 m. Po ashtu, pjesë e kategorive të automjeteve që do të ndalohej të qarkullojnë janë edhe makinat bujqësore, makinat teknologjike ose traktorët me shpejtësi më të vogël se 40 km/orë si dhe makinat bujqësore e teknologjike me gjatësi maksimale 2.55 m, lartësi maksimale 4 m dhe gjatësi jo më të madhe se 7.5m për mjetet me një kas dhe 12m për mjetet teke me dy a më shumë akse. Një tjetër kategori që nuk do të lejohet të qarkullojë janë edhe automjetet për kursantët e autoshkollave. Kufizimet e shtrijnë efektin për ditët e premtë nga ora 15:00-22:00, e shtunë nga ora 08:00-12:00 dhe nga ora 16:00 deri në orën 22:00. Ndërsa për ditët e diela nga ora 07:00 deri në orën 22:00. Megjithatë, referuar dokumentit, ka një sërë kategorish sikurse janë automjetet e shoqërimet, automjetet e Forcave të Armatosura, të mirëmbajtjes, cisternat që transportojnë ujë të pijshëm apo ato që transportojnë ushqime, për të cilat nuk do të ketë kufizime qarkullimi. Ky udhëzim ka për qëllim krijimin e lehtësive në qarkullimin e mjeteve në zonat turistike, që më së shumti vuajnë trafikun si pasojë e numrit të shtuar të automjeteve në këtë periudhë kohore.

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**

**ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'**

PASURIA NR. 8/58 + 1 - 4, E LLOJIT 'APARTAMENT', VOLUMI 3, FAQE 188, ZONA KADASTRALE 8370, ME SIPERFAQJE 75 M2, NE ADRESËN: RRUGA 'TH. ZIKO, PALLATI 65/3, TIRANË, NE PRONËSI TE SHTETASVE : Z. ENGJELL TOPORE DHE Z.NJ. NATASHA TOPORE'.  
**ÇMIMI 36.350 Euro** . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 04.06.2018 deri në datën 04.07.2018 .  
**CEL 0684026666 ; 0693262866 .**

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**

**ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'**

PASURIA NR. 101 / 8, E LLOJIT 'TRUALL + NDËRTESE', VOLUMI 8, FAQE 115, ZONA KADASTRALE 3096, ME SIPERFAQJE 3.200 M2, NGA TE CILAT 166 M² ESHTË NDËRTESE, NE ADRESËN : QERREKË-KRUJE, NE PRONËSI TE SHTETASVE : Z. YAHIA FARWATI DHE BRHXHILDA FARWATI'.  
**ÇMIMI 114.500 Euro** . Data e zhvillimit të ankandit do jetë në datën 04.07.2018 .  
**CEL. 0684026666 ; 0693262866 .**



Shoqëria përmbareme "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

"Arë" me sipërfaqe 3000 m<sup>2</sup>; a ndodhur në Tiranë, Kashar, regjistruar në pronësi të Eduard Zadeja, me Nr. Pasurie 1152/36, Zona Kadastrale Nr. 2105, volumi 17, faqe 154, regjistruar në Zyrën e Pasurive të Paluajtshme Tiranë, lënë si garanci bankës përmes kontratës së hipotekës Nr. 321 Rep dhe Nr. 125 Kol datë 12.02.2007. Çmimi fillestar i ankandit është 246.960 Euro.  
**Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 18.06.2018.**  
 Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përmbareme "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

Projektligji i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare është për shqyrtim në Kuvend

# Sigurimi i makinave, shitblerja e mjetit, siguracioni duhen bërë nga e para

## Pronari i vjetër ka të drejtë të kërkojë kthimin e pagesës

Ornela Manjani

Në rast se ndryshon pronësia e mjetit gjatë periudhës së sigurimit, të drejtat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga kontrata e sigurimit nuk i kalojnë pronarit të ri. Madje pronari i vjetër i makinës ka të drejtë të kërkojë rikthimin e pjesës së sigurimit për ditët e mbetura në rast se nuk ka përfutur siguracion gjatë periudhës së sigurimit. Rregulli i ri është përcaktuar në projektligjin e hartuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, i cili ka mbërritur për shqyrtim në Kuvend. Sipas nenit 25 të projektligjit ku përcaktohet ndryshimi i pronësisë së mjetit, përcaktohet që pronari i ri duhet të bëjë kontratë të re sigurimi për mjetin, kurse ai që e ka pasur deri dje e kthehen paratë për pjesën e mbetur të periudhës. "Në rast se ndryshon pronësia e mjetit gjatë periudhës së sigurimit, të drejtat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga kontrata e sigurimit nuk i kalojnë pronarit të ri. Pronari i ri i mjetit motorik duhet të lidhë kontratën e sigurimit, ndërsa pronari i vjetër ka të drejtë të kërkojë kthimin e pjesës proporcionale të primit, në rast se nga kjo kontratë nuk është paguar ndonjë dëm", projektligji.



Foto ilustruese

### PROJEKTLIGJI

"Në rast se ndryshon pronësia e mjetit gjatë periudhës së sigurimit, të drejtat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga kontrata e sigurimit nuk i kalojnë pronarit të ri. Pronari i ri i mjetit motorik duhet të lidhë kontratën e sigurimit, ndërsa pronari i vjetër ka të drejtë të kërkojë kthimin e pjesës proporcionale të primit, në rast se nga kjo kontratë nuk është paguar ndonjë dëm"

### NENI 25

#### Ndryshimi i pronësisë së mjetit

1. Në rast se ndryshon pronësia e mjetit gjatë periudhës së sigurimit, të drejtat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga kontrata e sigurimit nuk i kalojnë pronarit të ri.
2. Pronari i ri i mjetit motorik duhet të lidhë kontratën e sigurimit ndërsa pronari i vjetër ka të drejtë të kërkojë kthimin e pjesës proporcionale të primit, në rast se nga kjo kontratë nuk është paguar ndonjë dëm.

#### ISHTE

Në rast se ndryshon pronësia e mjetit gjatë periudhës së sigurimit, të drejtat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga kontrata e sigurimit, i kalojnë pronarit të ri dhe vlejën deri në përfundimin e kontratës së sigurimit, përshirë këtu edhe të drejtat e detyrimit e përcaktuara në nenin 8 të këtij ligji. Pronari i ri, brenda 8 ditëve, detyrohet të njoftojë shoqërinë e sigurimit për ndryshimin e pronësisë së mjetit dhe pasqyrimin e këtij ndryshimi në kontratën e sigurimit

#### BËHET

Në rast se ndryshon pronësia e mjetit gjatë periudhës së sigurimit, të drejtat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga kontrata e sigurimit nuk i kalojnë pronarit të ri. Pronari i ri i mjetit motorik duhet të lidhë kontratën e sigurimit, ndërsa pronari i vjetër ka të drejtë të kërkojë kthimin e pjesës proporcionale të primit, në rast se nga kjo kontratë nuk është paguar ndonjë dëm.

### DRAFTI

Ky draft ligj rregullon sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit. Sipas draftit, sigurimi i detyrueshëm në sektorin e transportit përfshin: a) sigurimin e përgjegjësisë së pronarit të mjetit motorik, për dëmet shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti; b) sigurimin e pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik; c) sigurimin e përgjegjësisë së pronarit të mjetit lundrues, për dëmet shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti; c) sigurimin e përgjegjësisë së pronarit të avionit, për dëmet shkaktuar palëve të treta dhe pasagjerëve nga përdorimi i këtij avioni. Ndërkohë që dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për kategori të veçanta mjetesh motorike të Forcave të Armatosura, të cilat përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

### KOMPENSIMI

Në draft është parashikuar që fondi i kompensimit administrohet nga Enti dhe ka për qëllim pagesën e dëmeve ndaj pronës dhe ndaj pronarit të ndodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë, për: a) dëmet e shkaktuara nga përdorimi i mjeteve motorike të pasiguruara; b) dëmet e shkaktuara nga përdorimi i mjeteve motorike të paidentifikuara;

### PËRGJEGJËSIA E SHOQËRISË SË SIGURIMIT DHE SHUMA E SIGURUAR

1. Detyrimi i shoqërisë së sigurimit që rrjedh nga kontrata e sigurimit, përfaqësohet nga kufijtë minimalë të mbulimit të vlefshëm në ditën e aksidentit, përveç rasteve kur në kontratën e sigurimit përcaktohet një vlerë më e lartë.
2. Minimumi i shumës së siguruar për çdo pasagjer të mbuluar nga kontrata e sigurimit, sipas nenit 17 të këtij ligji, përcaktohet si më poshtë:
  - a) 2 000 000 lekë në rast vdekjeje;
  - b) 4 000 000 lekë në rast paaftësie të përhershme për punë;
  - c) 1 000 000 lekë në rast paaftësie të përkohshme për punë dhe trajtim mjekësor.
3. Ky sigurim mbulon dëmtimet trupore të shkaktuara pasagjerit nga apo si pasojë e:
  - a) defekteve teknike që çojnë në humbjen e kontrollit mbi mjetin, defekte, të cilat ndodhin jo për faj të pronarit apo drejtuesit të mjetit të transportit urban;
  - b) rënia e objekteve të jashtme mbi mjetin motorik gjatë përdorimit të tij, qëndrimit në stacion apo gjatë qarkullimit;
  - c) dëmtime aksidentale të shkaktuara nga grumbullime masive, akte të dhunshme që mund të kenë motiv politik ose social, si atentate, sabotime, akte terroriste, dëmtime, zjarrvënie të qëllimshme, ngjarje apo shpërthime në objektet e ndryshme që ndodhen jashtë mjetit të transportit publik me kusht që ai mos të jetë pjesëmarrës aktiv në ato ngjarje;
  - c) frenim i papritur, plasje e gomës, devijimet e lëvizjes si rezultat i një shpërthimi apo shmangie e menjëhershme e detyruar që çon deri në përmbyshjen e mjetit të transportit publik;
  - d) eksplozioni që ndodh jashtë mjetit të transportit publik me kusht që mjeti mos të jetë pjesëmarrës aktiv në ngjarje;
  - dh) çdo ngjarje tjetër që ndodh jo për faj të drejtuesit/pronarit të mjetit të transportit publik dhe nuk mbulohet nga sigurimi i detyrueshëm i përgjegjësisë së pronarit të mjetit.
4. Shoqëria e sigurimit është e detyruar të zbatojë parashikimet e nenit 10 të këtij ligji për trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim.

### TARIFAT E PRIMIT TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM

1. Shoqëria e sigurimit i përcakton vetë tarifën e primit të sigurimit të detyrueshëm për mjetet motorike.
2. Shoqëria e sigurimit njofton Autoritetin të paktën 30 ditë kalendrike përpara aplikimit të tarifave të reja të primit dhe depoziton në Autoritet, bazat teknike dhe vlerësimet aktuariale të përdorura për llogaritjen e këtyre primeve, të shoqëruara me opinionin e aktuarit të autorizuar të shoqërisë.
3. Autoriteti në funksion të mbikëqyrjes së veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit, urdhëron rishikimin e tarifave të reja të primeve nëse konstaton se baza e të dhënave për hartimin e tabelave të primit nuk janë të sakta ose shoqëria e sigurimit nuk ka vepruar në përputhje me parimet aktuariale, të përcaktuara me rregulloren nga Autoriteti.
4. Tarifën e primit të sigurimit të detyrueshëm nuk mund të ndryshohet më shumë se dy herë brenda një viti kalendrik.
5. Shoqëritë e sigurimit duhet të krijojnë provigjone teknike jo më pak se niveli i provigjoneve teknike të përcaktuara me rregulloren nga Autoriteti.
6. Shpenzimet e marrjes në sigurim, shpenzimet administrative, si dhe pjesa e llogaritjes për fitimin e shoqërisë së sigurimit nuk mund të jenë më shumë se 40% i primit të shkuar bruto nga të cilat komisionet e ndërmjetësimit të mos jenë më shumë se 12% i primit.
7. Në raste të veçanta, Autoriteti mund të

miratojë për një afat të caktuar, një nivel më të ulët ose më të lartë se 10% të nivelit të shpenzimeve të marrjes në sigurim, shpenzimeve administrative, si dhe pjesës së llogaritjes për fitimin e shoqërisë së sigurimit, të përcaktuar në pikën 6 të këtij neni.

8. Shoqëria e sigurimit nuk mund të aplikojë tarifa të primit të shkuar bruto të ndryshme nga ato të përcaktuara sipas pikës 2 dhe 3 të këtij neni.
9. Shoqëria e sigurimit duhet të përfshijë sistemin bonus-malus në përcaktimin e tarifave të primeve të sigurimit të përgjegjësisë së të siguruarit për dëmet shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti motorik, me përjashtim të policës kufitare dhe kartonit jeshil.
10. Autoriteti përcakton kriteret e sistemit bonus-malus, kategoritë e mjeteve ku zbatohet si dhe të dhënat e nevojshme për zbatimin e këtij sistemi.

### E DREJTA PËR DËMSPËRBLIM

1. Pasagjeri ose përfutuesi, ka të drejtë sipas kushteve të kësaj kontrate të kërkojë tek shoqëria e sigurimit me të cilën është lidhur kontrata e sigurimit të paguarit dëmshpërblim.
2. Pronari i mjetit të transportit publik vendos në një vend të dukshëm të mjetit të transportit publik emrin e shoqërisë së sigurimit të përcaktuar në kontratën e sigurimit si dhe të drejtën e pasagjerit për të përfutur nga kjo kontratë.

c) pagesën e dëmshpërblimit ndaj pasagjerit në rastet kur pronari i një mjeti motorik në transportin publik nuk ka lidhur kontratë për sigurimin e pasagjerëve. Vlera minimale e Fondit të

Kompensimit me qëllim pagesën e dëmeve nuk mund të jetë më e vogël se 150 000 000 lekë. Kjo vlerë mbahet nga Enti, si fond garancie në një llogari bankare qëllimore në njërin nga bankat dhe/ose

degët e bankave të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe investohet vetëm në bono thesari dhe/ose depozita bankare, me afat maturimi jo më të vogël se 1 vit. Enti krijon dhe

mban provigjone teknike të dëmeve të kompensimit. Provigjonet teknike të dëmeve duhet të llogariten nga aktuari i autorizuar. Ndërkohë bazat, metodat e llogaritjes, mënyrat e

mbajtjes së provigjoneve teknike, investimi i aktiveve në mbulim të provigjoneve si dhe raportimi në Autoritet përcaktohen me rregulloren të miratuar nga Autoriteti



Më 21 maj, i riu Mata denoncoi "ish-bashkëshorten" në polici: Më mori paratë

TIRANË

Krimi i rëndë që ndodhi mëngjesin e së premtes në "Don Bosko" dhe që tronditi kryeqytetin dhe jo vetëm, duket se ka qenë i paralajmëruar. Një ditë pas vrasjes së 19-vjeçares Xhuljeta Çuni nga ish-i dashuri i saj 31-vjeçar Xhafer Mata me origjinë nga Kukësi janë zbardhur detaje të reja në lidhje me këtë krim pasion. Mësohet se një muaj më parë (më 7 maj), vajza kishte denoncuar në komisariat nr.3 Matën për përndjekje. Ndërkohë që 31-vjeçari nuk ishte mbajtur për 10 orë i shoqëruar në polici, siç ndodh në raste të tilla. "Më datë 07.05.2018, u referuan materiale në Prokurorinë e Tiranës pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për shtetasin Xhafer Taip Mata, i datëlindjes 01.05.1987, banues në Tiranë, me arsim të lartë, sepse në mënyrë të përsëritur, në kohë e vende të ndryshme, ka përndjekur ish-të dashurën Xhuljeta Sulejman Çuni, e datëlindjes 24.11.1999, banuese në Tiranë, me arsim 12 klasë". Ky është denoncimi i Xhuljeta Çunit, i regjistruar zyrtarisht si kallëzim penal në policinë e kryeqytetit. Ajo akuzonte 31-vjeçarin se e përndiqte vazhdimisht dhe e shqetësonte. Sipas burimeve konfidenciale, 19-vjeçarja kishte hyrë e kishte dalë e përlotur nga komisariati ditën që kish-

# Vrasja e paralajmëruar në zonën e 'Don Boskos', 19-vjeçarja denoncoi mes lotësh Xhafer Matën

Skandali, 31-vjeçari u mbajti pak orë në komisariat dhe u procedua penalisht në gjendje të lirë



31-vjeçari Xhafer Mata



Viktima XHULJETA ÇUNI

te bërë kallëzimin. Ndërkaq, 31-vjeçari Mata është proceduar penalisht në gjendje të lirë pas kallëzimit të bërë. Pas denoncimit të Xhuljeta Çunit, ish-i dashuri i saj, Xhafer Mata kishte bërë,

gjithashtu, kallëzim. Ai kishte denoncuar 19-vjeçaren në policinë e Tiranës më datë 21 maj. Kallëzimi është bërë po në Komisaratin nr.3. Sipas denoncimit, Xhafer Mata pretendon se 19-vjeçarja, për të

cilin ka thënë se ishte bashkëshortja, i ka marrë një shumë parash. "Më datë 21.05.2018, u referuan materiale pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për shtetasin XH.C. 19 vjeç, banuese në Tiranë, pasi me anë të mashtrimit, ish-bashkëshortit Xh.M., vjeç 31, banues në Tiranë, i ka marrë një shumë paund", thuhet në denoncimin e policisë bërë nga Xhafer Mata ndaj Xhuljeta Çunit. Refuzimi i 19-vjeçares, e shtyu Xhafer Matën deri në marrëzi. Një muaj pas denoncimit të vajzës (mëngjesin e 8 qershorit), ky i fundit qëlli me dy plumba pistolette Xhuljeta Çunin, duke e lënë të vdekur në vend. Më pas ai qëlloi edhe veten me armë dhe ndërroi jetë në spital.

Maturantja e gjimnazit "Qemal Stafa" u vra rrugës për në provimin e letërsisë.

## KUH ISHTE XHAFER MATA

31-vjeçari Xhafer Mata, i cili vrau dy ditë më parë ish-të dashurën dhe më pas veten, nuk ishte emër i panjohur për policinë, sidomos për komisaratin nr. 3. Mësohet se pak vite më parë 31-vjeçari ishte përfshirë në disa konflikte. Rasti i parë ishte ai i 23 shtatorit të vitit 2012, ku gjatë një konflikti me policinë, ai bashkë me familjarët e tij u përplas fizikisht me efektivet. Shkak i sherrit të dhunshëm ishte bërë motori pa letra i vëllait të tij. Pasi çështja ndaj tij ishte pushuar për mungesë provash, Xhaferi kishte për-

## 19 VJEÇARJA

Xhuljeta ishte vajza e madhe e familjes Çuni, dhe, megjithëse, ishte ende adoleshente paralelisht me shkollën ajo punonte për të ndihmuar familjen. Mëngjesin e së premtes, ajo u nis për në shkollë, me ankhin e provimit të letërsisë, por nuk mbërriti dot, pasi vetëm pak metra larg banesës u vra me dy plumba. Në shtëpinë e saj u hapën dyert e morit dhe në mesditën e të shtunës ajo u përcoll për në banesën e fundit.

funduar sërisht në telashe me policinë. Në një intervistë për emisionin "Kjo javë" në "News24" gazetari Spartak Koka deklaroi dje se për të riun kishte një raport shoqëror në vitin 2017, pasi akuzohej për vjedhje të energjisë elektrike. Mes të tjerash ai kishte bërë edhe dy denoncime, një në 2008 me pretendimin për tentativë grabitje nga 5 persona, si dhe për kanojë nga një person në vitin 2011.



Save the Children

## TENDER NOTICE

Save the Children believes every child deserves a future. In Albania and around the world, we give children a healthy start in life, the opportunity to learn and protection from harm. We do whatever it takes for children – every day and in times of crisis – transforming their lives and the future we share.

Save the Children International in Albania is inviting submissions of tenders for a contract to provide the following products:

- To construct two Crèches for children 0-3 age in city of Korçe and Elbasan.

Detailed technical specifications are included within the tender documents.

If you are interested in submitting a bid, please contact Ina Sefa at the following address [procurement.albania@savethechildren.org](mailto:procurement.albania@savethechildren.org) or [info.albania@savethechildren.org](mailto:info.albania@savethechildren.org) to express your interest and request the tender documents. Tender documents will be sent to you by return.

You may find full invitation to tender reference number 2018/001 at <https://albania.savethechildren.net/work-for-us/service-provision>.

It is recommended to request / collect the tender documents as soon as possible.

Completed tender documents are due to be submitted by 02/07/2018.

## Mashtrimi, ndalohej biznesmeni i ndërtimit, nën hetim administratorja dhe ekonomistja e firmës

TIRANË - Një biznesmen nga Tirana ka rënë në pranga, pasi akuzohet se ka shitur një apartament dy herë. Bëhet fjalë për shtetasin Besnik Allmuça. Ndërkohë po procedohen në gjendje të lirë administratorja dhe ekonomistja e firmës së ndërtimit. Burime zyrtare nga policia e kryeqytetit dje bënë me dije se Seksioni për Hetimin e Krimin Ekonomik dhe Financiar më datë 08.06.2018, në kuadër të operacionit policor të koduar "Banesa 2", ndaloi shtetasin: B.A., banues në Tiranë (me profesion ndërtues dhe aktivitet privat në fushën e ndërtimit). Sipas bluve, arrestimi i 57-vjeçarit u bë, pas denoncimit të bërë nga shtetasi G.Sh.. Mësohet se ky i fundit ka bërë kallëzim se është mashtruar nga



shtetasi B.A. për blerjen e një apartamenti me sipërfaqe 65 m<sup>2</sup>, me leje zhvillimore Nr.224, datë 16.06.2010, në vlerën 30 000 euro, apartament të cilin ndërtuesi B.A. më datë 17.03.2018 ia ka rishitur shtetasit B.L. duke përfituar një shumë 35 milionë lekë. Gjithashtu, u proceduan në gjendje të lirë shtetasat: A.A., 57 vjeçe, banuese në Tiranë (me detyrë administratore e

firmës së ndërtimit) dhe G.Ç., 35 vjeçe, banuese në Tiranë (me detyrë ekonomiste e firmës së ndërtimit). Materialet iu referuan prokurorisë së Tiranës në ngarkim të shtetasve të mësipërm për veprat penale: "Mashtrim në shuma të mëdha", "Falsifikimi i vullave, stampave ose Formularëve" dhe "Fshheje e të ardhurave".

Tahir Muço: Çlirim Shaholli ishte xheloz e pijanec, s'ka punuar asnjë ditë

Klodiana Haxhiaj

DURRËS

Ana dhunohej sistem atikisht nga bash këshorti. Ajo e ka denoncuar të shoqin disa herë në polici, pasi ai ishte xheloz dhe i dhunshëm. Çlirim Shaholli e mbanin disa orë në polici dhe pastaj e kthenin në shtëpi. Edhe pse ai e rrihte, Ana nuk e hapte gojën për hir të fëmijëve". Kështu deklaroi dje daja i 40-vjeçares Ardiana Shaholli, e cila u vra mbrëmjen e së premtes nga burri i saj 42-vjeçar. Një ditë pas ngjarjes së rëndë të ndodhur në banesën e çiftit, në lagjen nr.15 të qytetit të Durrësit, të afërmit e viktimës kanë zbardhur detaje të reja. Dëshmitë e tyre hedhin poshtë versionin e dhënë pas vrasjes nga autori i krimit, i cili deklaroi se gjithçka ndodhi pas një shërri banal dhe se ai vetëm e kishte shtyrë nënën e 6 fëmijëve dhe më pas kjo e fundit ka rënë me kokë në dysheme. "Që kur u martuan, Çlirim i dhunonte mbesën time. Ai vuante nga sëmundja e xhelozisë", tha Tahir Muço, daja i viktimës. Ndërkaq, ky i fundit u shpreh se 40-vjeçarja punonte në një lavanteri, ndërsa i shoqi nuk punonte.

# Vrasja e 40-vjeçares, daja i viktimës: Mbesa dhunohej shpesh nga burri

"Ana e ka denoncuar disa herë të shoqin se e rrihte, por policia e mbante pak orë dhe e linte të lirë



Viktima Ana Shaholli

"Çlirim nuk ka punuar asnjëherë. Ajo kishte 1 muaj që punonte në lavanteri. Ne i thoshim të divorcohej, por ajo thoshte se kam për të rritur fëmijët. Ana i ka rritur fëmijët me ndihma, pasi janë shumë fukarenj. Tani fëmijët kanë mbetur në mes të rrugës", - pohoi Muço. Ndërkohë, nusja e dajës së viktimës, në një intervistë

për "Gazeta Shqiptare" tha se autori i krimit ishte pijanec.

**Si e njihit çiftin?**  
Çifti jetonte në skamje, në mjerim. Ana ishte grua shumë e mirë, punëtore, e urtë, nuk i ndihej zëri i gojës. Nuk e hapte njëherë gojën që të ankohej. E kam mbesën e burrit. Im shoq e ka gocën e motrës.

**A kishin konflikte, sherre bashkëshortët Shaholli?**  
Kam pasur herë pas here. Me çfarë dëgjojmë këtu, pasi ne nuk kemi qenë këtu përditë, ngjarja e rëndë ka marrë shkas nga skamja, mjerimi. Burri i Anës është

pijanec. Pinte dhe nuk punonte. Ai nuk ka punuar asnjëherë.

**Po ajo punonte?**  
Po ajo kishte filluar punë. Punonte herë pas here. Por nuk e linte i shoqi të punonte se ishte xheloz. I thoshte pse punon. Në skamje e nuk e linte të punonte. Me 6 fëmijë, gjynah. Herë me bukë e herë pa bukë.

**Çfarë bëhet tani me fëmijët e mbetur jetimë?**  
Nuk di çfarë të them. Nuk na e priste mendja se Çlirim Shaholli do të arrinte deri këtu. Se për të rrahur, ai e ka rrahur sistemtikisht Anën dhe ajo s'e hapte gojën asnjëherë.

**SHKURTE**

**31-vjeçari bën për spital babain e moshuar, arrestohet**


**LUSHNJË** - Dhuna në familje nuk ka të ndalur, këtë herë një djalë ka dhunuar babain e tij në Divjakë të Lushnjës. Sipas burimeve nga policia lokale, dje është vënë në pranga 31-vjeçari Tani Kaboçi, banues në fshatin Gradishtë. Burimet e mësipërme pohuan se arrestimi i këtij shtetasi u bë pasi dy ditë më parë ka ushtruar dhunë fizike ndaj babait të tij, shtetasit M.Kaboçi, 68 vjeç. Mësohet se i moshuari ka shkuar në urgjencë për t'u mjekuar. Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje për veprën penale: "Dhunë në familje".

**Maskat grabisin dy lokale bastesh dhe godasin pronarin**

**FUSHË KRUIË** - Dy lokale bastesh në zonën e Fushë-Krujës janë grabitur në orë të para të mëngjesit të djeshëm nga persona të maskuar. Sipas burimeve policore, njëri prej lokaleve që ndodhet në afërsi të qendrës së Fushë-Krujës, në pronësi të shtetasit A.C. është hapur me thyerje rreth orës 03:00. Pasi i është thyer brava, janë vjedhur 3 televizorë nga 4 persona të maskuar. Pas këtij lokali është grabitur dhe një lokal tek "Ura e Gjolës" në fshatin Bubq. Ndërsa dyshohet që grabitja të jetë bërë nga njëjti grup. Edhe në këtë pikë janë vjedhur disa televizorë dhe janë dëmtuar disa të tjerë. Në këtë pikë grabitësit kanë hapur bravat dhe kanë hyrë brenda. Të pikasur nga pronari F.H., ata e kanë goditur dhe janë larguar. Policia po punon për identifikimin e autorëve të krimit.

**Mashtrori 44-vjeçar dhe i mori 7500 euro, kapet 'magjistaria'**

**FIER** - Policia e Fierit ka vënë në pranga një grua për mashtrim, pasi i kishte marrë 7500 euro një shtetasi nga Patosi. Mësohet se gruaja është një emër i njohur në zonën e Fierit, pasi shumë njerëz shkonin tek ajo për shërim. E njohur si 'magjistare' ose 'yshitare', Liljana Llapashtica, banuese Radostinë-Vadhizë i kishte marrë disa ditë më parë shtetasin me iniciale A.I. një shumë prej 7500 euro për t'i zgjidhur hallet. Pas denoncimit të 44-vjeçarit nga Patosi, blutë kanë arrestuar 51-vjeçaren. Sipas burimeve nga policia, Liljana Llapashtica ka qenë dënua më parë për të njëjtën veprë penale.



**Njoftim i shoqërisë ALBtelecom Sh.A.**

ALBtelecom njofton të gjithë abonentët e tij të telefonisë së levizshme se duke filluar nga data 16 korrik 2018, për pajtimtarët me parapagesë, do të ofrojë paketat 30 ditore Super me përfitimet si më poshtë:

Paketat Super	Super 500	Super 700	Super 1100	Super 1300	Gigastike	Super 1900
Çmimi (me TVSH)	500 Lekë	700 Lekë	1.100 Lekë	1.300 Lekë	1.300 Lekë	1.900 Lekë
Minuta Kombëtare (përfshirë rrjetet e tjera fikse)	300	200	2500	3000	400	3500
Minuta drejt rrjetit ALBtelecom Fiks	300	400	500	3000	400	3500
Minuta Ndërkombëtare				30		60
SMS drejt ALBtelecom Mobile	300	400	1000	2500	400	3000
SMS Kombëtare			500	400		300
SMS Ndërkombëtare						
Internet 3G/4G		300 MB	3 GB	5 GB	5 GB	12 GB
Internet 3G/4G+						3 GB
Përfitimet të tjera					10 GB (Social & Chat)	
TV				ALBtv Mobile	ALBtv Mobile	ALBtv Mobile
Vlefshmëria	30 Ditë	30 Ditë	30 Ditë	30 Ditë	30 Ditë	30 Ditë

Paketa 30 ditore Super 1000 nuk do të ofrohet më në treg. Të gjithë pajtimtarët me parapagesë të cilët e kanë këtë paketë aktive në momentin e ndryshimit, do të vazhdojnë ta përdorin deri në përfundimin e afatit të vlefshmërisë së saj. Të gjithë pajtimtarët me parapagesë të cilët kanë të aktivizuar Paketën Super 500, Super 700, Super 1300 dhe Super 1900 në momentin e ndryshimit, do të vazhdojnë t'i përdorin këto paketa të pandryshuara deri në përfundimin e afatit të vlefshmërisë së tyre.

Për më shumë informacion vizitoni dyqanet tona ALBtelecom, faqen tonë zyrtare [www.albtelecom.al](http://www.albtelecom.al) ose telefononi Shërbimin e Klientit në 123.\*

## Drama në familjen Shaholli, 3 fëmijët e vegjël të çiftit nuk e dinë për vdekjen e nënës

**DURRËS** - Zi dhe lot në familjen Shaholli në Durrës. Pasditën e djeshme, rreth orës 15:00, 40-vjeçarja është përcjellë në banesën e fundit nga miq, të afërm dhe të njohur. Por dhimbja nuk ka fund. 6 fëmijët e saj, ku më i madhi 17 vjeç (maturant) dhe më e vogla 8 vjeçe kanë mbetur jetimë. Të afërmit të viktimës dje deklaruan për "Gazeta Shqiptare" se vetëm 3 fëmijët e mëdhenj e dinë se nëna e tyre është vvarë nga babai. Ndërsa 3 fëmijët më të vegjël ende nuk e dinë fundin tragjik të nënës së tyre. Mësohet se këta të fundit janë marrë nga një shoqatë dhe janë dërguar në një kamp veror. Askush nga të afërmit nuk e dinë se çfarë do të bëhet me 6 fëmijët e çiftit. Ata u shprehën se familja Shaholli jetonte në skamje dhe se nuk ngopnin as barkun me bukë. Ishte nëna e tyre që bënte të pamundurën për t'i rritur, pasi babai i tyre nuk ka punuar qoftë dhe një ditë të vetme që kur është martuar.





Dosjet e viteve 1993-2008, formulari-tip për informim në lidhje me ecurinë e vendimeve

Ornela Manjani

# Pronarët në Korçë, ATP merr në shqyrtim 10 mijë dosje

Problematikat, procedurat për t'u njohur me ecurinë e shqyrtimit

Agjencia e Trajtitimit të Pronave publikon listën me 10 mijë dosje ish-pronarësh, që janë në proces shqyrtimi nga kjo agjencia. Kërkesit janë në qarkun e Korçës. Në listën e përditësuar jepet numri i dosjes dhe data e aplikimit, gjeneralitetet e kërkesit, sipërfaqet e njohura për kompensim, dosjet për pronarët që kanë marrë vendim negativ dhe dosjet që duhet të plotësohen. Dosjet janë të viteve 1993 deri në vitin 2008. Agjencia e Trajtitimit të Pronave ka vënë në dispozicionin të pronarëve formularin-tip, "Informacion në lidhje me ecurinë e dosjes", i cili duhet të plotësohet dhe të dorëzohet në 'Agjenci' për t'u njohur me fazën në të cilën ndodhet shqyrtimi i saj. Agjencia Trajtitimit të Pronave është e detyruar që brenda 15 ditëve nga momenti i dorëzimit të kërkesës t'i kthejë përgjigje pronarit në lidhje me ecurinë e dosjes.

**FORMULARI**

Formulari i aplikimit për informacion në lidhje me ecurinë e dosjes është i ndarë në tri seksione. Aplikanti duhet të plotësojë gjen-

eralitet, adresën dhe të jetë i pajisur me mjet identifikimi në momentin e aplikimit. Në seksionin e dytë duhet të jetë përkthyer në mënyrë të saktë se në lidhje me çfarë kërkon informacion pala e interesuar, në këtë rast pronari që ka aplikuar për kthim e kompensim prone. Dhe në seksionin e fundit janë të specifikuar pesë dokumentet që duhet të disponojë pronari në momentin e aplikimit.

**APLIKIMI**

Për t'u njohur me ecurinë e dosjes, subjekti duhet të plotësojë dhe të paraqesë dorazi ose me postë pranë ATP-së kërkesën për informim në lidhje me ecurinë e dosjes, fotokopje të kartës së identitetit, dëshmi trashëgimie

**DOKUMENTACIONI QË DUHET TË PARAQISNI**

- Formulari-tip
- Fotokopje e kartës së identitetit
- Kopje vendimi nga ish-KKP/AKKP (nëse ka)
- Dokumente të tjera

dhe prokurë të posaçme. Në faqen zyrtare të ATP-së mësohet se subjekti plotëson kërkesën me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes pranë Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun, në 'Agjenci'. Më pas, kërkesa i kalon zyrës së protokollit, e cila pasi e protokollon, ia dërgon të gjitha kërkesat e ardhura drejtorit të përgjithshëm. Kreu i AKKP-ës ia delegon kërkesat sek-

torit përkatës për ndjekje dhe zbatim. Më pas, sektori përkatës përgatit informacionin e kërkuar dhe njofton subjektin. Në përfundim të shqyrtimit, subjekti paraqitet pranë zyrave të ATP-së për të tërhequr shkresën e kthimit të përgjigjes në lidhje me ecurinë e dosjes ose i dërgohet me postë, sipas kërkesës. Aplikimi për kërkesën për informim mbi dosjen nuk ka kosto.



**KORÇË**

Nr./Dosjes	Rrethi	Emri (Subjekti kërkesues)	Atesia 2	Mbiemri (Subjekti kërkesues)	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Problematika
17	Pogradec	Vasil	Sotir	Shegani	1435	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë Për Sipërfaqen 12 m2 ku ndodhet stalla marëdhënia sipas ligjit
16	Pogradec	Stefano	Angli	Shegani	1765	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
18	Pogradec	Vangjel	Bendo	Gjoka	Nj=359 m2 Mos/Njohje=136 m2	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
19	Pogradec	Donika	Stavri	Kratellari	121	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
30	Pogradec	Ismail	Isuf	Turka	138	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
27	Pogradec	Le na	Tasi	Bale	Nj=170 m2 Mos/Njohje=188 m2	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
1	Pogradec	Gani	Isuf	Ibi	670	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
	Pogradec					Kjo Pasi interpretimi për ti hequr nga përdorimi 100 m2 Isa Ibit është i gabuar pasi 100 m2 është në përdorim të vetë Gani Ibit
22	Pogradec	Thomas	Naum	Shegani	84	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
23	Pogradec	Trajçe	Klime	Kratellari	152	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
2	Pogradec	Mersin	Bedulla	Ibi	730	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
2	Pogradec	Mersin	Bedulla	Ibi	1770	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
6	Pogradec	Mehmet	Qani	Bejlliu	10565	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
7	Pogradec	Remzi	Islam	Ili	187	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
11	Pogradec	Fejzi	Emir	Bësholli	1120	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
5	Pogradec	Çaush	Ali	Ibi	6883	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
	Pogradec	Çaush	Ali	Ibi	5056	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
8	Pogradec	Emin	Fezulla	Muçi	Nj=2154 m2 Mos/Njohje=1812 m2	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
	Pogradec	Emin	Fezulla	Muçi	784	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
24	Pogradec	Gjergji	Fani	Krate	216	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
25	Pogradec	Trajçe	Vasil	Proptisht	285	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
26	Pogradec	Hekuran	Shefki	Sulo	60	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
28	Pogradec	Velo	Gjergji	Gjore	Nj=150 m2 Mos/Njohje=35	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
29	Pogradec	Makbile	Selman	Avdullari	Nj=260 m2 Mos/Njohje=370 m2	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë Në sip. 370 m2 janë shitur nga pronari 300 m2
10	Pogradec	Kadri	Bedulla	Ibi	990	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
3	Pogradec	Hekuran	Mahmut	Kapo	4102	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
11	Pogradec	Sadik	Riza	Oshafi	8400	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
12	Pogradec	Jakup	Ahmet	Xhemollari	Nj=2000 m2 Mos/Njohje=7000 m2	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
13	Pogradec	Avni	Ramadan	Mëkollli	180	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë Trajtuar sip. 180 m2 për sipërfaqen (jetër (1674-180) e ka në sotërim 1494 m2

Nr./Dosjes	Rrethi	Emri (Subjekti kërkesues)	Atesia 2	Mbiemri (Subjekti kërkesues)	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Problematika
14	Pogradec	Lutfi	Telha	Oshafi	6155	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
15	Pogradec	Ferit	Zahja	Oshafi	2250	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
16	Pogradec	Ferit	Istref	Mimini	Mos/Njohje=1491 m2	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
	Pogradec				Nj=1241 m2 Mos/Njohje=259 m2	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
17	Pogradec	Hysni	Sejet	Oshafi	2250	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
8	Pogradec	Guranden	Veiz	Isallori	3560	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
7	Pogradec	Razim	Sali	Xhemollari	3550	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
	Pogradec	Razim	Sali	Xhemollari	6000	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
18	Pogradec	Qamiran	Bektash	Oshafi	6740	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
30	Pogradec	Meleq	Shyqyri	Capo	2094	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
29	Pogradec	Refat	Demir	Manellari	Mos/Njohje 662 m2	Krijona mbivendosje me pronën e rrethor me 20 dt. 28.02.1994 subjekti Mazlilëm Latollari
1	Pogradec	Sefulla	Bari	Selko	102	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë Për ndërtimin në sipërfaqen 102 m2 të zbatohet ligji i privatizimit
13	Pogradec	Naske	Riza	Purba	4016	Vërtetim i Arkivit Shtetëror Ka Hartë
12	Pogradec	Mazlilëm		Latollari	1500	Me Vendim Gjyqate ka Planvendosje
11	Pogradec	Jetnor	Zyko	Latollari	1470	Me Dokument Kadastral ka Planvendosje trajtuar sipërfaqja truallli 1470 m2 sip. 2670 m2 jashtë vijave kufizuese
10	Pogradec	Selami	Ahmet	Latollari	1640	Me Dokument Kadastral ka Planvendosje Në Këtë Sipërfaqe ka një Hangar Dukani
8	Pogradec	Xhevat	Nasuf	Xhudollari	1500	Sipërfaqe është ndërtuar Posta Kufiri Hudenisht
7	Pogradec	Guri	Rapush	Durollari	8604	Arkivi Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
16	Pogradec	Resmi	Ismail	Seitllari	3278	Arkivi Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
2	Pogradec	Kurti	Arif	Zeqollari	Nj=1905 m2 Mos/Njohje=3980 m2	Arkivi Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
1	Pogradec	Sabire	Hajdar	Lipo	3470	Me Dokument Kadastral ka Planvendosje
12	Pogradec	Fuat	Demir	Barjaktari	1575	Arkivi Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
11	Pogradec	Neshet	Beshir	Kaseullari	10425	Arkivi Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
24	Pogradec	Xhevat	Qemal	Xhemollari	4400	Arkivi Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
27	Pogradec	Syrja	Kajo	Capollari	Nj=1621 m2 Mos/Njohje=539 m2	Arkivi Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
14	Pogradec	Feim	Selim	Meko	Mos/Njohje=1180 m2	Me Dokumentacioni i pronës së dhe Dëshmia e Trashëgimisë

10 - SPECIALE

4	Pogradec	Agim		Cela	11330	08 dt. 28.02.2003-Vendosi: Mos Pranimi e Kërkesës për Mulli 36 m2 Arkivi Vendor Shtetërorë Ka Planvendosje
18	Pogradec	Sejat	Sejat	Fekolli		Mungon dokumentacioni Ligjorë
30	Pogradec	Faik	Avdulla	Dorova		Subjekti ka tërhequr kërkesën për ta trajtuar me ligjin 7699
43	Pogradec	Xhelal		Hymettari		Mungon Dokumentacioni Ligjorë dhe Hartografik
2	Pogradec	Sadik	Veseli	Spaho		Mungon Dokumentacioni Ligjorë dhe Hartografik
4	Pogradec	Bekdash		Leka		Mungon Vërtetimi I Pronësisë për vitin 1945 para reformës dhe Dëshmia e Trashigimisë
	Pogradec	Hekuran	Refit	Kullolli		Mungon Vërtetimi I Pronësisë për vitin 1945 Planimetria e pa ardhuruar pretendimi I pa ndarë
3	Pogradec	Qani	Gani	Alla		
10	Pogradec	Mejreme		Liqi	3000	Me Vendim Gjykatë Ka Planvendosje
18	Pogradec	Ilo		Jaçellari		Mungon Dokumenti Ligjorë para 45
34	Pogradec	Ridvan		Xhemollari	1938	Me Vendim Gjykatë Ka Planvendosje
	Pogradec	Ridvan		Xhemollari	4000	Me Vendim Gjykatë Ka Planvendosje Nga Kjo Sipërfaqe Subjekti ka shitur 342 m2 pra ( 4350 342= 4008 m2)
245	Pogradec	Kolli		Tili	690	Me Vendim Gjykatë Ka Planvendosje
256	Pogradec	Ermir		Oranliu		Sipërfaqja është njohur me vendimim 147 dt. 26.08.1998-KKKP-Stefan Ilo
248	Pogradec	Lutfi		Kadilli	15000	Vërtetim Kadastral Ka Planvendosje (Diferenca e Marrë me 7501)
250	Pogradec	Myrteza		Hoxha		Me Vendim Gjykatë Ka Planvendosje Sipërfaqja 713 m2 mbivendosje me Nazim Topasi sipas Vendimi I Gjykatës Korçë 1174 dt. 17.11.1998
257	Pogradec	Zamir		Seitllari	670	Me Vendim Gjykatë Ka Planvendosje
246	Pogradec	Hamidi		Hoxha	3000	Me Vendim Gjykatë Ka Planvendosje
1	Pogradec	Slave		Ilo	3000	Me Vërtetim Kadastral+Vendim Gjykatë Ka Planvendosje
12	Pogradec	Rexhep	Rapush	Mimini		Mungon Dokumentacioni Ligjorë e Hartografik
2	Pogradec	Khafër	Sajfulla	Minqe		Mungon Dokumentacioni Ligjorë e Hartografik
10	Pogradec	Suzana		Kreste	3500	Mungon Dokumentacioni Kadastral Ka Planvendosje
17	Pogradec	Olivera	Kostaq	Jovani	1240	Me Dokumentacion Kadastral Ka Planvendosje
2	Pogradec	Kamber	Idriz	Hoxha		Me Dokumentacion Kadastral Ka Planvendosje
3	Pogradec	Fatmir	Ahmet	Corbaxhiu		Nj=1684 m2 Mos/Njohje=16233 m2
4	Pogradec	Nazar	Faik	Mimini		Nj=6227 m2 Mos/Njohje=1452 m2
9	Pogradec	Sulejman	Ali	Hoxha		Me Dokumentacion Kadastral Ka Planvendosje Ky Vendim Ankimuar në Gjykatë sipas Fletë Thirrjes S'ka Vendim në Dosje Hiqet Pronësi 528 m2 Dybere Topallit dhënë në Kundërshtim me Ligjin
9	Pogradec	Agush	Beshir	Corbaxhiu		Nj=8233 m2 Mos/Njohje=1454 m2
6	Pogradec	Sefedin		Elmazllari		Nj=1726 m2 Mos/Njohje=1132 m2
7	Pogradec	Petrit	Muharrem	Corbaxhiu		Nj=3170 m2 Mos/Njohje=9154 m2
8	Pogradec	Besart	Myrsel	Corbaxhiu	816	Me Dokumentacion Kadastral Ka Planvendosje Bashkëpronësi 376 m2 në pallatin 2 kat për të ndërtuar katin 3
15	Pogradec	Tomorr	Sadik	Elmasllari	714	Me Dokumentacion Kadastral Ka Planvendosje
14	Pogradec	Myfit	Riza	Pambuku		Nj=2612 m2 Mos/Njohje=5493 m2
13	Pogradec	Muredin	Haki	Velollari		Nj=3092 m2 Mos/Njohje=6154 m2
11	Pogradec	Kudret	Isa	Branellari		Nj=1385 m2 Mos/Njohje=1398 m2
15	Pogradec	Fuat	Hajdar	Purba	5425	Me Dokumentacion Kadastral Ka Planvendosje
1	Pogradec	Fuat		Baqi		Mos/Njohje=8050 m2
9	Pogradec	Dane	Hymër	Jaçellari	1496	Me Dokumentacion Kadastral Ka Planvendosje
6	Pogradec	Ieftër	Shebi	Corbaxhiu	2460	Me Dokumentacion Kadastral Ka Planvendosje
5	Pogradec	Çerçiz	Sulejman	Bajraktari		Nj=609 m2 Mos/Njohje=1575 m2
4	Pogradec	Osman	Avdulla	Dervishi	754	Bashkëpronësi e dyqanit me truallin e pronarit
3	Pogradec	Qibir		Alla		Nj=3276 m2 Mos/Njohje=1948 m2
2	Pogradec	Reiz		Biba	1310	Me Dokumentacion Kadastral Ka Planvendosje Njeh Bashkëpronësi me Pronarët që Kanë Objektet Ka Kërkesë padi të dt. 08.10.1996
1	Pogradec	Ali	Feta	Biba		Nj=4840 m2 Mos/Njohje=28320 m2
10	Pogradec	Çaush	Zaim	Dakollari		Nj=230 m2 Mos/Njohje=8750 m2
18	Pogradec	Medet		Elmasllari	1076	Ka Kërkesë padi sipas fletë thirrjes së dt. 04.05.2000 Nuka ka vendim të depozituar
17	Pogradec	Bajram	Shaban	Shyti	6010	Me Dokumentacion Kadastral Ka Planvendosje Në Sipërfaqe ndodhen objekte të ndërtuara
28	Pogradec	Anif	Dilaver	Elmasllari	1170	Me Dokumentacion Kadastral Ka Planvendosje Për sipërfaqen 578 m2 e zënë me magazina marrëdhëniet zgjidhen sipas Ligjit
26	Pogradec	Fazlli	Rexhep	Elmazllari	830	Me Dokumentacion Kadastral Ka Planvendosje

25	Pogradec	Sulejman	Tahir	Hyskollari	1656	Me Dokumentacion Kadastral Ka Planvendosje Sipërfaqja 48 m2 e zënë nga peshorja marrëdhëniet rregullohen sipas Ligjit Për sip e zënë nga ndërtimet pa leje të drejtohet organeve kompetente
19	Pogradec	Xhevat	Shazo	Latollari	3200	Me Vendim Gjykatë Ka Planvendosje Marrëdhëniet e pronarit të truallit me pronarin e objektit rregullohen sipas Ligjit
22	Pogradec	Isuf	Ismail	Izeilari	571	Me Dokumentacion Kadastral Ka Planvendosje
23	Pogradec	Kurti	Zyko	Purba		Mos/Njohje=1740 m2
33	Pogradec	Jenije	Myftar	Muqllari		Nj=544 m2 Mos/Njohje=691 m2
32	Pogradec	Nilut	Reis	Sulkollari	4119	Me Dokumentacion Kadastral Ka Planvendosje
31	Pogradec	Dervish	Shefik	Seitllari	3566	Me Dokumentacion Kadastral Ka Planvendosje
14	Pogradec	Brahim	Haxhi	Elmasllari	874	Me Dokumentacion Kadastral Ka Planvendosje Në Sipërfaqe ndodhen objekte të ndërtuara Magazina
21	Pogradec	Enver	Fazlli	Capollari	3069	Me Dokumentacion Kadastral Ka Planvendosje
20	Pogradec	Avni	Ismail	Capollari	3570	Me Dokumentacion Kadastral Ka Planvendosje
17	Pogradec	Namik		Bardhi		Nj=2463 m2 Mos/Njohje=503 m2
16	Pogradec	Flamur	Skënder	Elmasllari	2469	Me Dokumentacion Kadastral Ka Planvendosje
13	Pogradec	Sami		Mahmutllari	3143	Vërtetimi I Arkivit Shtetëror Ka Hartë
1	Pogradec	Vangjel		Pllinxhi		Nj=480 m2 Mos/Njohje=344 m2
15	Pogradec	Vangjel		Gjeli		Nj=135 m2 Mos/Njohje=Te Benesës 2 katëshe
46	Pogradec	Floresha		Belli (Shytka)		Nj=537 m2 Mos/Njohje=400 m2
18	Pogradec	Sotiraq		Kreste		Nj=1800 m2 Mos/Njohje=1000 m2
1	Pogradec	Ali		Molla		2988
20	Pogradec	Agron		Zeka		950
19	Pogradec	Mehmet	Demir	Topi		2848
16	Pogradec	Mesti		Vako		88
7	Pogradec	Selami		Jakupllari		2638
14	Pogradec	Zisi		Qafko		1300
12	Pogradec	Piro	Uazi	Mehillli		151
8	Pogradec	Skënder		Kuqo		2621
4	Pogradec	Llazi		Tasellari		1300
11	Pogradec	Hamit		Jakupllari		3520
12	Pogradec	Figjirle		Zeka		1500
13	Pogradec	Vasil		Uakmani		Nj=765 m2 Mos/Njohje=3265 m2
47	Pogradec	Kujtim		Kadilli		Mos/Njohje=9587 m2
49	Pogradec	Kamber		Belli		Nj=620 m2 Mos/Njohje=280 m2
45	Pogradec	Nazmi		Topuzi		Nj=1499 m2 Mos/Njohje=1501 m2
44	Pogradec	Fatime		Shyti		Mos/Njohje=240 m2
14	Pogradec	Neshat		Dervishi		Nj=1661 m2 Mos/Njohje=2900 m2
21	Pogradec	Qani		Afisllari		1944
16	Pogradec	Petro		Tona		1192
2	Pogradec	Gurije		Zeka		1019
3	Pogradec	Myqerem		Dumbo		
10	Pogradec	Illa		Turshinka		Nj=855 m2 Mos/Njohje=1855 m2
9	Pogradec	Fuat		Kuqo		6825
17	Pogradec	Nikolla		Turshinka		2000
2	Pogradec	Aniz		Molla		10025
11	Pogradec	Ilo		Mato		Mos/Njohje=1059 m2
	Pogradec	Roberta		Mato		1300
6	Pogradec	Hamit	Beqir	Jakupllari		1669
5	Pogradec	Nurije	Xhemal	Zeka		6000
4	Pogradec	Lutfi	Ilaz	Dumbo		3245
3	Pogradec	Fetije	Jakup	Jakupllari		Nj=1250 m2 Mos/Njohje=1300 m2
8	Pogradec	Margarita		Tasellari		2751
7	Pogradec	Lale	Uazi	Kapbardhi		1051
6	Pogradec	Thoma	Miti	Mitllari		3677
5	Pogradec	Llazi	Gaqo	Shyta		2811
3	Pogradec	Kopi	Naum	Mitllari		1200
2	Pogradec	Kristaq	Gaqi	Mitllari		2500
1	Pogradec	Thoma	Gaqo	Shyta		Me Vendim Gjykatë+Planvendosje Ka Kërkesë Padi për 03 dt. 04.10.1995 Nuk Vendim Gjykatë në Dosje
28	Pogradec	Gafer		Haxhillari		2010



4	Pogradec	Vaid		Manellari	1207	Vërtetim Kadastral Ka Planvendosje
	Pogradec	Gafër		Haxhillari	2100	Me Vendim Gjykatë Ka Planvendosje
73	Pogradec	Avdulla		Blacëri	3000	Arkivi Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
146	Pogradec	Hida	Koli	Kodra	50	Me Vendim Gjykatë Ka Planvendosje
291	Pogradec	Përparim		Seitllari	217	Me Vendim Gjykatë Ka Planvendosje
160	Pogradec	Pandi	Sandi	Petre	1242	Në Dosje ndodhet vetëm Vendimi i Komisionit. Nuk ka asnjë dokument tjetër
94	Pogradec	Dylber	Gjyladin	Dikellari	1066	Arkivi Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
	Pogradec	Zenel		Dikellari	396	Arkivi Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
	Pogradec	Dylber		Dikellari	Nj=61.1 m2 dhe të drejtën e parablerjes	Arkivi Vendor Shtetëror Ka Planvendosje Trajtuar vetëm 611 m2 Truali
193	Pogradec	Lida		Kora	450	Me Vendim Gjykatë Ka Planvendosje
119	Pogradec	Mondi		Semini	2250	Me Vendim Gjykatë Ka Planvendosje
25	Pogradec	Bajram		Berberi	Te mos shprehet	Arkivi Vendor Shtetëror Ka Planvendosje Sipërfaqja trajtuar sipas Ligjit 8053 dt. 26.12.1995 dhe në Ndërmarrjes Bujësoje
26	Pogradec	Ymer		Mukollari		Me Vendim Gjykatë Ka vepruar Ligji 8053 dt. 26.12.1995
22	Pogradec	Rakibe	Jaki	Berberi	450	Arkivi Vendor Shtetëror Ka Planvendosje Trajtuar 450 m2 pasi sip. 2350 m2 trajtuar me Ligjin 8053
118 (51)	Pogradec	Mereme		Selko	546	Me Vendim Gjykatë Ka Planvendosje
10	Pogradec	Nexhmije		Hoxhallari	Mos/Njohje=80 m2	Me Vendim Gjykatë Kjo Sipërfaqja është Njohur Nuri Berberi me 512 dt. 08.07.1996
345	Pogradec	Enver		Sulollari	482	Me Vendim Gjykatë Ka Planvendosje
104	Pogradec	Merita		Eminaj	930	Me Vendim Gjykatë Ka Planvendosje
109	Pogradec	Sherif		Frashëri	1200	Me Vendim Gjykatë Ka Planvendosje
253	Pogradec	Spiro		Mile	922	Arkivi Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
8	Pogradec	Neim		Shkullaku	2834	Me Vendim Gjykatë Ka Planvendosje
4	Pogradec	Pali		Kujtimi	385	Me Vërtetim Kadastral Ka Planvendosje
24	Pogradec	Shaban	Haki	Haxhillari	1629	Me Vendim Gjykatë Ka Planvendosje
21	Pogradec	Naum		Pasko	846	Me Vendim Gjykatë Ka Planvendosje
137	Pogradec	Josif		Velo	1100	Me Vendim Gjykatë Ka Planvendosje
211	Pogradec	Niazi		Blacëri	Nj=1088 m2 Mos/Njohje=1441 m2	Arkivi Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
	Pogradec				1126	Arkivi Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
53 - 54	Pogradec	Niko	Llazi	Kole	140	Me Vendim Shpronësimi të 1959 Ka Planvendosje
	Pogradec				3015	Me Vërtetim Kadastral+Vendim Gjykatë
	Pogradec				1200	Me Vendim Gjykatë Ka Planvendosje
	Pogradec				1000	Me Vendim Gjykatë Ka Planvendosje. Vendimi Nr. 96, date 31.01.2000 në emër të subjektit të shpronësuar Kristo Divjaka ndodhet në Dosjen Nr. 906 me subjekt të shpronësuar Pali Petro Kujtimi.
111	Pogradec	Vangjel		Alabaku	861	Me Vendim Gjykatë Ka Planvendosje
33	Pogradec	Robert		Dhami	97.5	Me Shpronësim Ka Planvendosje
	Pogradec	Remzi		Dervishi	976	Arkivi Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
	Pogradec	Robert		Dhami	500	Me Vërtetim Kadastral+Vendim Gjykatë Ka Planvendosje
11	Pogradec		Hekuran	Berberi	Nj=2322 m2 Mos/Njohje=478 m2	Arkivi Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
9	Pogradec	Hysen		Shkullaku	Nj=4563 m2 Mos/Njohje=880 m2	Me Vërtetim Kadastral nga Arkivi Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
141	Pogradec	Muhamet	Aslan	Guge	320	Me Vendim Gjykatë Ka Planvendosje
22	Pogradec	Bardhyl	Filip	Papajani	839.5	Me Vendim Gjykatë Ka Planvendosje
119	Pogradec	Edmond		Semini	2250	Me Vendim Gjykatë Ka Planvendosje
87	Pogradec	Remzi		Hyka	601	Me Vërtetim të Arkivit Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
19	Pogradec	Skënder		Konomi	188.5	Me Vendim Gjykatë Ka Planvendosje
	Pogradec	Skënder		Konomi	577	Me Vërtetim të Arkivit Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
161	Pogradec	Sazan		Sokoli	542	Me Vendim Gjykatë Ka Planvendosje
31	Pogradec	Hadid	Ibrahim	Topçiu	118.5	Me Vendim Gjykatë Ka Planvendosje
279	Pogradec	Gjigjirije		Mato	3028	Me Vërtetim të Arkivit Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
61	Pogradec	Neim		Blacëri	Nj=7206 m2 I Njihet e Drejta Parablerjes	Me Vërtetim të Arkivit Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
209	Pogradec	Avni		Biba	1208	Me Vërtetim të Arkivit Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
124	Pogradec	Ramadan		Mancellari	576	Me Vërtetim të Arkivit Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
	Pogradec	Ramadan		Mancellari	Mos/Njohje=104 m2	Me Vërtetim të Arkivit Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
	Pogradec	Ramadan		Mancellari	Nj=610 m2 E drejta Parablerjes	Me Vërtetim të Arkivit Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
126	Pogradec	Kristaq		Shuke	50	Me Vërtetim të Arkivit Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
134	Pogradec	Vasil		Rovina	1402	Me Vërtetim të Arkivit Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
36	Pogradec	Bexhet		Molla	3480	Me Vërtetim të Arkivit Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
599	Pogradec	Hamdi		Nekuti	90	Me Vërtetim të Arkivit Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
604	Pogradec	Tori (Viktor)		Cerepi	870	Me Vërtetim të Arkivit Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
	Pogradec	Tori (Viktor)		Cerepi	238	Me Vërtetim të Arkivit Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
616	Pogradec	Anastasi		Kace	11388	Nuk ka Dokument Ligjorë Ka Hartë
340	Pogradec	Ikbalë		Berberi	Mos/Njohje=328 m2	
202	Pogradec	Dhimritraq		Gusho	5860	Me Vërtetim të Arkivit Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
102	Pogradec	Gjergj		Manushi	350	Me Vërtetim të Arkivit Vendor Shtetëror Ka Planvendosje

320	Pogradec	Muhamer		Manellari	3018	Me Vërtetim të Arkivit Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
293	Pogradec	Petro		Jorgolli	400	Me Vërtetim të Arkivit Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
67	Pogradec	Kristaq		Palo	1400	Me Vërtetim të Arkivit Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
268	Pogradec	Shpresa		Berberi	1500	Me Vërtetim të Arkivit Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
	Pogradec				Nj=3350 m2 Mos/Njohje=1967 m2	Me Vërtetim të Arkivit Vendor Shtetëror Ka Planvendosje Sipërfaqja 1967 Njohur Avdulla Berberi me 284 dt. 24.05.1995 KKKP Bashkia Pogradec
210	Pogradec	Petrof		Kadilli	6.25	Me Vërtetim Kadastral Ka Planvendosje
169	Pogradec	Bexhet		Guri	782	Vërtetim i Faktit Juridik Ka Hartë
102	Pogradec	Gjergji		Manushi	350	Vërtetim i Faktit Juridik Ka Hartë
34	Pogradec	Fiqiri		Hysenbegasi		Vërtetim i Faktit Juridik Ka Hartë
35	Pogradec	Gëzim		Fero	90.4	Vërtetim Hipotekor Ka Hartë
86	Pogradec	Petra		Davilo		Vërtetim Hipotekor Ka Hartë
618	Pogradec	Arben		Hima	802	Vërtetim i Faktit Juridik Ka Hartë
259	Pogradec	Sefedin		Blacëri	Mos miratoje kerkesen	Nuk Plotësim Dokumentin Ligjorë
301	Pogradec	Stasi		Vako	Mos miratoje kerkesen	Nuk Plotësim Dokumentin Ligjorë
21	Pogradec	Filoreta		Kerthi		Me Vërtetim të Arkivit Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
136	Pogradec	Feridon		Hoxhallari	350	Me Vërtetim të Arkivit Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
607	Pogradec	Fatmir		Minarolli	1250	Vërtetim i Faktit Juridik Ka Hartë
91	Pogradec					Me Vërtetim të Arkivit Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
92	Pogradec				462	Me Vërtetim të Arkivit Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
308	Pogradec	Thoma		Tasellari	Mos/Njohje 2835 m2	
598	Pogradec	Nebi		Manellari	Mos/Njohje=1600 m2	Vërtetim i Faktit Juridik
	Pogradec	Nebi		Manellari		Vërtetim i Faktit Juridik Ka Hartë
612	Pogradec	Ajjan		Starova	748.5	Vërtetim i Faktit Juridik Ka Hartë
615	Pogradec	Hamet		Mukollari	320	Vërtetim i Faktit Juridik Ka Hartë
272	Pogradec	Bardhyl		Killogjen	Mos/Njohje=800 m2	Mos Plotësim Dokumentin Ligjorë
605	Pogradec	Mihallaq		Tona		Vërtetim i Faktit Juridik Ka Hartë
597	Pogradec	Bedrie		Bega		Vërtetim i Faktit Juridik Ka Hartë
	Pogradec	Bedrie		Bega	Mos/Njohje=1.042 m2	Vërtetim i Faktit Juridik Dokumenti Ligjorë jo i Plotë
608	Pogradec	Xhemal		Guri	1.163	Vërtetim i Faktit Juridik Ka Hartë
623	Pogradec	Dylber		Dikellari	1020	Me Vërtetim të Arkivit Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
622	Pogradec	Selami		Berberi	1611	Me Vërtetim të Arkivit Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
5	Pogradec	Muhamet		Llapushi	Nj=2896 m2 Mos/Njohje=3623 m2	Me Vërtetim të Arkivit Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
624	Pogradec	Shyqyri		Lami	1157	Me Vërtetim të Arkivit Vendor Shtetëror Vërtetim i Faktit Juridik Ka Planvendosje
110	Pogradec	Donika		Sasa	676	Vërtetim i Faktit Juridik Ka Planvendosje
596	Pogradec	Nexhat	Riza	Mujllari	1013	Vërtetim i Faktit Juridik Ka Planvendosje
	Pogradec	Nexhat	Riza	Mujllari	6150	Vërtetim Hipotekor Ka Hartë
629	Pogradec	Nazar		Berberi	1498	Me Vërtetim të Arkivit Vendor Shtetëror Vërtetim i Faktit Juridik Ka Planvendosje
	Pogradec	Nazar		Berberi	1390	Me Vërtetim të Arkivit Vendor Shtetëror Vërtetim i Faktit Juridik Ka Planvendosje
283	Pogradec	Petra	Thanas	Vllahu	Mos/Njohje=1292 m2	
273	Pogradec	Nikolla		Vako	Mos miratoje kerkesen	
304	Pogradec	Anastas		Piqoni	144	Vërtetim i Faktit Juridik Ka Planvendosje
	Pogradec	Anastas		Piqoni	Vendosi: Të Mos Miratoje Kërkesën për Sipërfaqen e Pretenduar pasi Dokumentacioni i Paraqitur nuk është i Plotë dhe Konform Ligjit	
297	Pogradec	Fatos		Jasherllari	Vendosi: Të Mos Miratoje Kërkesën pasi Dokumentacioni i Paraqitur nuk është i Plotë dhe Konform Ligjit 7698 dt. 15.04.1993	
601	Pogradec	Qefserë		Berberi	1750	Vërtetim i Faktit Juridik Ka Planvendosje
609	Pogradec	Mihallaq		Marko	150	Vërtetim i Faktit Juridik Ka Planvendosje
	Pogradec				Vendosi: Mos Miratimi e Kërkesës sepse Prona e Pretenduar bie Brenda Sipërfaqes së pronës së njohur/trajtuar të këtij ish pronari me 20 dt. 28.07.1997 KKKP-Rrethi Pogradec	
625	Pogradec	Hajdar	Ahmet	Collaku	Vendosi: Të Mos Miratoje Kërkesën pasi Dokumentacioni i Paraqitur nuk është i Plotë dhe Konform Ligjit 7698 dt. 15.04.1993	
249	Pogradec	Pëllumb		Hoxhallari	Vendosi: Të Mos Miratoje Kërkesën pasi Dokumentacioni i Paraqitur nuk është i Plotë dhe Konform Ligjit 7698 dt. 15.04.1993	
613	Pogradec	Gazment		Berberi	2.745	Vërtetim i Faktit Juridik Ka Planvendosje
	Pogradec	Gazment		Berberi	1000	Vërtetim i Faktit Juridik Ka Planvendosje
302	Pogradec	Mirika		Shkurti	Mos/Njohje=500 m2	Mos Plotësim Dokumentin Ligjorë
610	Pogradec	Argjen		Prishtina		Vërtetim i Faktit Juridik Ka Planvendosje
	Pogradec	Argjen		Prishtina	Vendosi: Të Mos Miratoje Kërkesën	
603	Pogradec	Zyber		Dervishllari		Vërtetim i Faktit Juridik Ka Planvendosje Sipërfaqja e pa shprehur jashtë vijave kufizuese të Dytetit
66	Pogradec	Gjergji e Petrika		Çomo	5426	Me Dokument Kadastral Vendimi Nuk Ka Planvendosje Ka Planvendosje Pronë të pa Firmosur dhe Vulosur
	Pogradec	Gjergji e Petrika		Çomo	Drejta Parablerjes=60.8 m2	Me Dokument Kadastral Vendimi Nuk Ka Planvendosje Ka Planvendosje Pronë të pa Firmosur dhe Vulosur
	Pogradec	Gjergji e Petrika		Çomo		Me Dokument Kadastral Vendimi Nuk Ka Planvendosje Ka Planvendosje Pronë të pa Firmosur dhe Vulosur
	Pogradec	Gjergji e Petrika		Çomo		Me Dokument Kadastral Vendimi Nuk Ka Planvendosje Ka Planvendosje Pronë të pa Firmosur dhe Vulosur

DATA HISTORIKE

# Propaganda Fide: Porta e Lartë ankohet për përfshirjen e klerit në politikë

140 vite nga Lidhja e Prizrenit, ekspozohen dokumentet e fotografitë

Fatmira Nikolli


Një letër e Zyrës së Propagandës së Fesë në Romë dërguar mbikëqyrësit apostolik në Lezhë, bën me dije se Porta e Lartë ka shprehur pakënaqësitë e veta për pjesëmarrjen e klerikëve katolikë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, si edhe i sugjerohet të mos përzjehet në çështje politike. Ky është një nga dokumentet e ekspozuara së fundit në kuadër të 140-vjetorit të Lidhjes së Prizrenit. Po në të njëjtën stendë është edhe korrespondenca mes Arqipeshkvit të Durrësit dhe prefektit Françeskan të Lezhës ku shkëmbejnë in-



Shtëpia që shërbeu si qendër e Degës së Shkodrës për Lidhjen e Prizrenit

formacione dhe porosi lidhur me sjelljet arbitrare të autoriteteve osmane ndaj të krishterëve, duke ushtruar

dhunë dhe duke prishur kryqet e varreve. Një ekspozitë me dokumente që ritregojnë Lidhjen e Prizrenit është çelur në hollin e Bibliotekës Kombëtare të Prishtinës. E ardhur si bashkëpunim mes Arkivit Qendror Shtetëror dhe Agjencisë Shtetërore të Kosovës ajo rrok një kohë të shkuar përmes dorëshkrimesh e imazhesh të atyre që u përpoqën të ruajnë tokat shqiptare. 10 qershor 1878 - 10 qershor 2018, 140 vjet nga Lidhja e Prizrenit, sillet në vëmendje se ajo ishte një organizim kombëtar i shqiptarëve të të gjitha trojeve, me qëllim kundërshtimin e vendimeve të Traktatit të Shën Stefanit dhe Kongresit të Berlinit. Kërkesat e Lidhjes ndaj Perandorisë Osmane dhe Fuqive të Mëdha ishin të qarta: 1. ruajtja e tërësisë territoriale të shqiptarëve; 2. autonomia administrative e trojeve shqiptare. Në mbështetje të këtyre kërkesave u ngritën degë të Lidhjes së Prizrenit në shumicën e qyteteve shqiptare, siç tregohet në një prej hartave të ekspozitës. Ekspozita përmbledh situatat politike të kohës, letërkëmbimet për çështjen dhe për trojet shqiptare, sikundër edhe raportet e vilajeteve me Portën e Lartë, por edhe hapat kryesorë që i paraprimë a e ndoqën Lidhjen e Prizrenit. Ekspozita shpërfaq imazhet e anëtarëve të Lidhjes së Prizrenit, rregulloren e saj, thirrjen e Komitetit Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave të Shqiptarëve drejtuar të gjithë bashkëkombësve ku ftohen të kundërshtojnë



Letër e Zyrës së Propagandës së Fesë në Romë dërguar mbikëqyrësit apostolik në Lezhë, përmes së cilës ky i fundit njoftohet se Porta e Lartë ka shprehur pakënaqësitë e veta për pjesëmarrjen e klerikëve katolikë në lëvizjen kombëtare shqiptare. Në dhe i sugjerohet të mos përzjehet në çështje politike

Korrespondenca mes Arqipeshkvit të Durrësit dhe Prefektit Françeskan të Lezhës ku shkëmbejnë informacione dhe porosi lidhur me sjelljet arbitrare të autoriteteve osmane ndaj të krishterëve, duke ushtruar dhunë dhe duke prishur kryqet e varreve

copëtimin e trojeve. Po aty, shihet edhe memorandum i njohur që iu drejtua Lordit Beaconsfield, kryeministër i Mbretërisë së Bashkuar përmes të cilit kundërshtohet vendim i Kongresit të Berlinit dhe copëtimi i trojeve. Janë ekspozuar edhe dokumentet që tregojnë protestat e popullsisë së Shkupës, Podgoricës, Zhabjakut, Grudës dhe Kuçit drejtuar Kongresit të Berlinit, kundër dhënies së tokave Malit të Zi dhe protesta e Shqipërisë së Jugut dhe asaj të mesme, promemoria e Vaso Pashë Shkodranit drejtuar Konsullit të Austro-Hungarisë në Stamboll më 22 tetor 1878. Mes të tjerash jepet edhe peticioni i Abdyl Frashërit dhe Mehmet Ali Vriionit dërguar Sulltanit ku shprehen në mbrojtje të tërësisë territoriale të viseve shqiptare. Telegrame, procesverbalet e vitit 1880 për rrymat në Lidhjen e Prizrenit, projekti për riorganizimin e sistemit administrativ të Osmanëve realizuar nga doajeni shqiptar Sami Frashëri janë përfshirë në ekspozitën ku nuk mungojnë as dy projektet e redaktuara nga Ferid Pasha në Kuvendin e Parisë së Toskërisë mbledhur në Janinë më 1878, ku i kërkohet Sulltan Hamidit që Shqipëria të bashkohet në një vilajet, të hapen shkolla shqipe dhe të njihet shqipja si gjuhë zyrtare e mandej edhe një kërkesë për organizimin e një milicie shqiptare.

## Fushata #lumturiaesaj është një lëvizje sociale e mbështetur nga Fibank

Aktivitetet e Përgjegjësive Sociale nga Fibank synojnë në impaktin afatgjatë për përmirësimin e shoqërisë

FIBANK synon të jetë një nga 10 bankat e para në Shqipëri dhe në rajon që njihet si dinamike, inovative dhe e orientuar ndaj klientëve, që ofron produkte dhe shërbime cilësore, duke gjetur mundësi të shkëlqyeshme për të zhvilluar punonjësit si edhe për të kontribuar në shoqëri.

Një nga shtyllat kryesore të strategjisë së Fibank është të jetë një institucion me përgjegjësi sociale i cili kontribuon në komunitet. Aktivitetet e Përgjegjësive Sociale të Fibank synojnë të kenë një kontribut afatgjatë në shoqëri duke marrë pjesë aktivisht në ngjarje shoqërore, duke mbështetur kompanitë jofitimprurëse dhe organizatat me qëllime idealiste që punojnë në fushën e arsimit, kulturës, bamirësisë etj.

Fondacioni Spitalor i Nënës dhe Fëmijëve është një nga partnerët afatgjatë që Fibank ka mbështetur vazhdimisht me qëllimin për ndergjegjësimin e të Rinjve mbi Dhunën Kundër Grave, duke u fokusuar në dhunën e partnerit.

Fushata #lumturiaesaj është një lëvizje sociale e zhvilluar nga fondacioni Spitalor i Nënës dhe Fëmijëve dhe e mbështetur nga Fibank. Kjo fushatë është një thirrje për drejtësi dhe adresimin e pabarazive me të cilat ballafaqohen gratë dhe vajzat përmes mesazheve pozitive dhe jo për të adresuar drejtpërdrejt Dhunën kundër Grave.

Fibank synon të promovojë mesazhin pozitiv **Ne besojmë se ndryshimi është i mundur!** Ne besojmë se gratë dhe burrat e zakonshëm janë të aftë të veprojnë për të ndryshuar rrethanat e tyre.



Fondacioni në partneritet me Fibank ka prezantuar mënyra të ndryshme të ndikimit të ndergjegjësimin kundër dhunës. Ata kanë organizuar disa veprimtari si: "CelebrateHer-Walts of Love", një vallëzim masiv me pjesëmarrjen e studentëve dhe punonjësve në sheshin Skënderbej, "Përmes syve të fëmijëve", një konkurs fotografik që solli aspekte të jetës së përditshme të nënave shqiptare, siç shihet dhe perceptohet nga fëmijët e tyre, etj.


Aktivitetet e Përgjegjësive Sociale të Fibank gjithmonë do të mbështesin lëvizjet shoqërore që sjellin përmirësim në planin afatgjatë, si mentaliteti dhe edukimi për të gjitha gjeneratat.



E DIEL

10 Qershor

2018



In memoriam



**Dasha Drndić**  
(10 Gusht '46 - 5 Qershor '18)

Ndërroi jetë shkrimtarja kroate Dasha Drndić, një mike e singertë dhe e madhe e shqiptarëve, historinë e të cilëve e ka përfshirë në veprat e saj të përkthyer në shumë gjuhë, mes tyre dhe shqipja. Ajo paraqiti si pakkush egërsinë e shekullit të 20-të dhe e fitoi famën ndërkombëtare për talentin e saj 'shpesh brutal, por në të njëjtën kohë jashtëzakonisht të bukur', referuar kritikës. "Milosao", në numrin e ardhshëm, do t'i kushtohet me një hapësirë të posaçme

Në nderim të 140-vjetorit të Lidhjes shqiptare të Prizrenit

NGA PROF. GAZMEND SHPUZA

# Lidhja islamike, që u shndërrua në Lidhjen shqiptare

(Prizren, 15-17 qershor 1878)

**K**uvendi historik i Prizrenit, në të cilin u themelua Lidhja Shqiptare, i mbajtur pranë Bajrakhami-së të këtij qyteti ka mbetur i paverësuar dhe madje i anatemuar keqas si një tubim i organizuar dhe i manipuluar nga elementët sulltanistë. Kararnameja, i vetmi dokument i miratuar në këtë kuvend, përshkoi nga besnikëria ndaj sulltanit dhe Sherijetit. Edhe vetë organizata e porsakrijuar qenka quajtur lidhje islamike dhe më vonë u quajt Lidhja Shqiptare! Kuvendi u mbajt pranë Bajrakhami-së. Edhe pse pranë një kulti islam, në të morën pjesë jo vetëm 38 pjesëmarrës muslimanë, por përkrah tyre u rreshtuan dhe pesë delegatë kristianë (ortodoksë e katolikë). Aty,

ndryshe nga sa vijon të paragjykohehet, u morën vendime historike për fatet e atdheut dhe për të ardhmen

e tij. Këtë qëndrim të paimagjueshëm për atë kohë e diktonte momenti historik, i cili shtronte

para kuvendarëve detyrën e ngutshme të bashkimit pa dallim feje për shpëtimin e trojeve shqiptare

nga rreziku i copëtimit. Ky bashkim i elementëve të ndryshëm fetarë vinte natyrisht në vijim të traditës shekullore të bashkëjetesës ndërfetare midis bartësve të besimeve të ndryshme. Për autorin Sylejman Kyççe, me prejardhje nga Tetova apo nga Luma, i cili na kumton vendimet e punimeve të këtij kuvendi, është plotësisht e qartë dhe e padiskutueshme që këta delegatë kishin ardhur aty jo për hir të interesave të ngushta, të veçanta, por, ashtu sikurse nënvizon ai, "për mbrojtjen e të drejtave të Shqipërisë" mbarë.

Kuvendarët, edhe pse përfaqësues vetëm të një pjese të Shqipërisë, vilajeti i Kosovës dhe ish vilajeti i Manastirit dhe pas dy javësh dhe ata të Shkodrës ndanë të njëjtat mendime lidhur me rrugët e shpëtimit të atdheut nga rreziquet që i kërcënoheshin. Si masë të parë ata ndërmoren formimin e një organizate kombëtare të njësuar mbarëshqiptare, e cila ka hyrë në histori me emrin Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Këtë e dëshmojnë venimet që u morën aty.

[➔Vijon në faqen 14](#)

**Në këtë numër: PROF. GAZMEND SHPUZA, ENNIO GRASSI PËR VISAR ZHITIN, MARKO POGAÇAR, BUJAR KAPEXHIU PËR AZIS NDRUN DHE ILIRIAN AGOLLI PËR PORADECIN, ETJ...**

P

PËRKUJTIM

Formimi i Lidhjes shqiptare, si një organizatë kombëtare mbarëshqiptare me përkujtesën e 15 qershorit drejtuar Kongresit të Berlinit dhe Portës së Lartë dhe, sidomos, me miratimin e programit politik të Lidhjes shpreh qartë vullnetin dhe vendosmërinë e kombit shqiptar për krijimin e një fronti të përbashkët të mbarë shqiptarëve përballë armiqve të huaj që kërkonin ta gjymtonin tërësinë territoriale të atdheut dhe t'ia mohonin Shqipërisë të drejtat kombëtare...

Në nderim të 140-vjetorit të Lidhjes shqiptare të Prizrenit

NGA GAZMEND SHPUZA

Prizren, 15-17 qershor 1878

Vijon nga faqja 13

Fall pas hapjes së Kongresit të Berlinit këta delegatë pa prituri ardhjen e përfaqësuesve të viseve të tjera, sepse koha nuk priste, njoftuan menjëherë më 15 qershor - 1878, Portën e Lartë me një shpallje të nënshkruar, siç thekson jo rastësisht S. Kylçe, bashkërisht dhe me krerët e krishterë, deklarorin: të gjithë shqiptarët ishin të vendosur të përballonin çdo vendim negativ që do të dilte nga ai forum i fuqive të mëdha në kryeqytetin e Gjermanisë dhe çdo agresion që do të vinte nga fqinjët.

Kuvendarët e sapombledhur në Prizren deklarorin me vendosmëri: "Qoftë i mallkuar kush ndjek interesat egoiste në këtë kohë kur atdheu na thërret në shërbim të tij. Ne, në Lidhjen tonë, vendosëm që para së gjithash të provojmë që, pa diskutuar për fenë, jemi shqiptarë". Siç shihet për ndarje krahinore as që bëhej fjalë. Pjesëmarrësit e Kuvendit qenë të vetëdijues plotësisht për identitetin e tyre të njëjës kombëtar. Shpaloja e bashkimit mbifetar të shqiptarëve, u vlerësua që herët, siç shkruan Sylejman Kulçe, në mënyrë të natyrshme, "një vepër zgjimi e madhe".

Kuvendarët e Prizrenit miratuan po atë dite programin politik kombëtar bazë, për zbatimin e të cilit do të punonte Lidhja. Autonomia e Shqipërisë u konsiderua me të drejtë për vetë kushtet, si rruga më e mirë për sigurimin jo vetëm të tërësisë së trojeve shqiptare, por edhe të së ardhmes së atdheut të bashkuar. Mos të harrojmë se vendimarrësit e fuqishëm të Kongresit të Berlinit u pajtuan për ruajtjen e status quo-së në Ballkan.

Edhe pse në kuvend, një herë për një herë, merrnin pjesë dhe diskutonin vetëm përfaqësues të një pjese të trevave shqiptare ata u shprehën dhe morën vendime në këtë tubim historik edhe në emër të të gjithë bashkatdhetarëve të tyre, si përsa i përkiste ruajtjes së tërësisë së trojeve shqiptare ashtu dhe për sa i takonte sendërtimit të të drejtave kombëtare të mbarë shqiptarëve.

Detyrën e shpëtitimit të viseve shqiptare të rrezikuara nga Traktati i Shën Stefanit dhe më pas dhe nga Kongresi i Berlinit përfaqësuesit e vilajetit kuvendarët e Prizrenit, e shihnin të pandarë nga synimi i tyre për sigurimin e të drejtave kombëtare qoftë edhe në formën e një administrate shqiptare në kuadër të "vilajeteve të bashkuara" me një autonomi sa më të gjerë.

Në këtë kushtetut të Lidhjes, siç e quan Kylçe, shtrohet qartë

# Kuvendi themelues i lidhjes shqiptare

dhe prerazi qysh në ditët e para të Kuvendit të Prizrenit, pa arritur ende përfaqësuesit e viseve të tjera, synimi për të kaluar pa humbur kohë në realizimin e menjëherëshëm të autonomisë së Shqipërisë me bashkimin e vilajeteve shqiptare me qendër Manastirin. Po ashtu, kërkohet ngritja e administratës së Lidhjes me organizmat përkatese jo vetëm për mobilizimin e shqiptarëve në luftën kundër copëtimit të trojeve shqiptare por dhe për sendërtimin e kësaj autonomie. Qysh në fillim parashikohej që administrata e Lidhjes të merrte në dorë mbledhjen e taksave dhe ngritjen e organeve të ruajtjes së rendit dhe të forcave ushtarake të "Vilajeteve të Bashkuara" për mbrojtjen e trojeve shqiptare.

Për autorin S. Kylçe "ishte e qartë haptazi që vendimet e para të Lidhjes së Prizrenit nuk përputheshin me qenien dhe interesat e shtetit osman". Prandaj autoritetet osmane morën masa të menjëhershme për t'iu kundërvënë zbatimit të këtyre synimeve dhe kërkesave.

Fillimisht, shqiptarët e vilajetit të Kosovës dhe fill pas tyre edhe ata të mbarë viseve të Shqipërisë verilindore, veriore, dhe lindore, nuk shkuan në Kuvendin e Prizrenit vetëm dhe thjesht si përfaqësues të krahinave apo të sanxhaqeve të veçanta.

Deri më tani nuk dihen emrat e pjesëmarrësve të kuvendit që nënshkruan dokumentet themelore të Lidhjes. Ne kemi emrat e atyre që miratuan Kararnamën e datës 17 qershor, për organizimin e forcave për mbrojtjen e trojeve shqiptare dhe ngritjen e administratës shqiptare. Ata qenë përfaqësuesit e viseve të Rrafshit të Dukagjinit, të Kosovës, Dibrës Tetovës,

Lidhja e Prizrenit e porsakrijuar, në të vërtetë, bashkoi nisimat popullore të komiteteve të vetëmbrojtjes dhe lidhjet lokale, krahinore dhe ndërkrainore në një organizatë të përbashkët kombëtare mbarëshqiptare.

Pas formimit të Lidhjes Shqiptare si një organizatë kombëtare mbarëshqiptare me përkujtesën e 15 qershorit drejtuar Kongresit të Berlinit dhe Portës së Lartë dhe, sidomos, me miratimin e programit politik të Lidhjes u shpreh qartë vullneti dhe vendosmëria e kombit shqiptar për krijimin e një fronti të përbashkët të mbarë shqiptarëve përballë armiqve të huaj që kërkonin ta gjymtonin tërësinë territoriale të atdheut dhe t'ia mohonin Shqipërisë të drejtat kombëtare. Ky front që në ditët e para të krijimit të tij u shndërrua ndryshe nga çfarë pretendohet, në një organizatë politike kombëtare, me fizionomi të mirëfilltë shqiptare të shpalur pa mëdyshje botërisht.

Në pamundësi tashmë për t'iu injoruar, si deri më tani, dokumentet themelore të Lidhjes të datës 15 qershor 1878, vërehen për ta nënv-

lerësuar gjithësesi Kuvendin historik të Prizrenit.

Tani në literaturën tonë historike kushtuar themelimit të Lidhjes Shqiptare nuk bëhet më fjalë për mbizotërim në Kuvendin e Prizrenit të elementëve sultanistë e madje, edhe të moderuar. Prapë se prapë, elementët radikalë kërkohen jashtë mureve të xhamisë, ku u mbledhën delegatët e kuvendit dhe, madje, larg vatrës së themelimit të Lidhjes. Porse, në fakt, janë pikërisht këta përfaqësues të popullit shqiptar, të trevave verilindore të Shqipërisë, të cilët morën vendimet historike në Kuvend, ata të cilët qenë nismëtarë të lëvizjes për themelimin dhe orientimin e drejtë të Lidhjes së Prizrenit qysh në hapat e para të saj.

Përfaqësuesit e viseve të sipërpërmendura, kryesisht muslimanë, i dhanë Lidhjes, që më 15 qershor 1878, platformën mbarëshqiptare, programin atdhetar dhe taktikën kombëtare, me fizionomi të mirëfilltë shqiptare të shpalur pa mëdyshje botërisht.

Në pamundësi tashmë për t'iu injoruar, si deri më tani, dokumentet themelore të Lidhjes të datës 15 qershor 1878, vërehen për ta nënv-



Kuvendi i Prizrenit

Matit, Lumës, Novipazarit, Gucisë, Shkupit, Manastirit, Ohrit, Kërçovës, etj., mbi 50 vetë. Edhe pse në Kuvendin e Prizrenit munguan përfaqësuesit më të shquar të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare pjesëmarrësit e tij qëndruan në lartësinë e kuptimit dhe të shprehjes së drejtë të detyrave që shtroheshin përpara vendit në rrafsh kombëtar për kohën dhe për të ardhmen.

Të parët që mbështetën vendimet dhe protestat e dala nga Kuvendi i Prizrenit ishin përfaqësuesit e viseve të kërcënuara nga vendimet e Traktatit të Shën Stefanit.

vjet rresht në krye të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Rreth saj, gjatë viteve 1878-1881, u bashkuan forcat atdhetare nga vilajetet e tjera, nga të katër anët e viseve shqiptare.

Në kundërshtim me realitetin historik të atyre ditëve të qershorit të vitit 1878, edhe sot e kësaj dite afishohen si dokumentet më të para të Kuvendit të Prizrenit dhe, njëkohësisht, themeluesit të Lidhjes Shqiptare Kararnameja, e cilësuar gabimisht pa dashje apo dhe me dashje turkomane apo turke, Talimati dhe madje i ashtuquajturit Kanun i Ri i 2 korrikut 1878. Pra, ende ndeshim në për-



pkjeje për t'u kthyer, përmes pohimesh kategorike apo kontradiktore, në vlerësimet e dikurshme tërësisht apo dhe pjesërisht negative të Kararnamesë dhe të Kuvendit themelues të Prizrenit. Ruhet ende hendeku i thellë midis vlerësimit pozitiv të përgjithshëm të Lidhjes si krijesë e shqiptarëve dhe karakterizimit negativ të dokumenteve të konsideruara si akte themeluese të saj.

Programi i 15 qershorit 1878 me kërkesën për autonomi, edhe kur përmendet, zhvlehtësohet menjëherë me pretendimin tejet të thjeshtëzuar, se përbajtja e tij nuk u përfshi në dy dokumentet pasardhës që u miratuan nga Kuvendi, më 17 qershor 1878, në Kararnamenë (Akti i Vendimeve) dhe në Talimat (Udhëzimet). Në këto rrethana shihet me vend të ndalimi edhe një here për të saktësuar dhe theksuar se cilët janë, në fakt, aktet themeluese të Lidhjes Shqiptare të viteve 1878-1881. Analizën dhe rivlerësimin e punimeve të Kuvendit të Prizrenit nuk e dikton vetëm përkujtimi i përvjetorëve të Lidhjes.


Ndryshe nga qindra protesta të mëparshme të dërguara deri më atëherë nga viset veriore, verilindore dhe lindore, akti i 15 qershorit nënkrahur, tashmë, në emër të themeluesve të Lidhjes Shqiptare të sapo formuar. Këtyre protestave iu bashkëngjit pas afro pesëjavë e gjysmë dhe protesta e Degës së Lidhjes Shqiptare, në Janinë në datën 24 korrik 1878, e pasuar nga protestat e tjera të shqiptarëve të Jugut kundër vendimeve të Kongresit të Berlinit lidhur me kufijtë e Jugut në fillim të vitit 1879 dhe më pas.

Programin autonomist të Kuvendit themelues të Lidhjes së Prizrenit Sylejman Këlçe e quan turqisht, jo pa të drejtë, *anayasa*, domethënë, Kushtetutë. Ajo në të vërtetë ishte skicë e projekt-kushtetutës së Shqipërisë autonome.

S. Këlçes si autor, njohës i mirë i burimeve osmane për historinë e Shqipërisë së atyre shekujve, më së pari, i intereson qëndrimin politik i delegatëve të Kuvendit të Prizrenit i shprehur në të dhe jo thjesht masat organizative sidomos në fushën ushtarake, për arrijtjen e tij. Prandaj, ai nuk u referohet fare as Kararnamesë dhe as Talimatit, dhe aq më pak të ashtuquajturit Kanuni i Ri. Edhe pse përbajtja e pretenduar islamike apo proosmane e proslulltanore e Kararnamesë do t'i shkonte për shtat autoriteteve më të larta perandorake, ai nuk e përmend fare këtë dokument, i cili nuk duhej të ishte i panjohur për autoritetet osmane dhe për vetë atë. Prandaj, jo rastësisht, Këlçe ndalet në publikimin dhe vlerësimin vetëm të akteve të 15 qershorit.

Programin e Lidhjes të 15 qershorit e pasuan dhe plot parashtrësia me kërkesën për autonomi. Kronologjia, gjeografia e parashtrimit dhe formulimet e tyre paraqesin interes për të gjykuar lidhur me ecurinë e përpjekjeve të organeve të Lidhjes në shkallë kombëtare dhe lokale në drejtim të mendërtimit të shtetit autonom shqiptar.

S. Këlçe është një autor serioz dhe plotësisht i besueshëm. Për dokumente të cilat ka dijenit lidhur me ekzistencën e tyre, por nuk ka arritur t'i shtijë në dorë, ai jo një here nuk i jep vetes të drejtë të flasë rreth të dhënave të tyre, të siguruar nga burime të tërthorta. Prandaj, mund të thuhet me bindje, se



### Lidhja e Prizrenit

Lidhja e Prizrenit u konceptua dhe lindi si një organizatë kombëtare mbarëshqiptare, që në ditët e para të themelimit të saj dhe nuk u shndërrua në një të tillë, siç pretendohet ende, as më 17 qershor, as më 2 korrik të atij viti, kur aty arrijnë përfaqësuesit e vilajetit të Shkodrës, dhe më 1 nëntor 1878 dhe ata të Janinës.

burimi, dhe vërtetësia e përbajtjes së dokumenteve të 15 qershorit 1878, të vëna në qarkullim shkencor prej tij në vitin 1944, vështirë të vihen në dyshim dhe, për rrjedhim, dhe në diskutim.

Si dokument bazë "Kushtetuta" e Lidhjes nuk u përfshi dhe nuk kishte pse të përfshihesh, siç shohim të pretendohet dhe sot e kësaj dite, në aktet e përpiluara dhe të miratuara pas saj, siç genë Kararnameja apo Talimatit.

Aktet themeluese të Lidhjes së datës 15 qershor dhe aktet e tjera që i pasuan ato ishin vepër e qarqeve atdhetare të qarta politikisht që në hapat e para të veprimtarisë organizative të Kuvendit të Prizrenit.

Ky realitet historik vështirë të mohohet. Ai as nuk mund të vihet në dyshim nga përpjekjet për karakterizimin e plotë apo dhe të pjesshëm negativ që vijon t'i bëhet me të padrejtë Kararnamesë si një dokument islamik apo proslulltanor.

Shprehja e besnikërisë ndaj Perandorisë Osmane dhe sovranit që formulohej në të, nuk i binte ndesh programit autonomist të miraturar dy ditë më parë në Prizren. Atë e ndeshim dhe në sa e sa parashtrës drejtuar Stambollit dhe Fuqive të Mëdha. Me këtë gjuhë do t'i drejtohet sultanit, padishahut të 25 milion nënshtrësive osmane dhe kalifit të 220 milion muslimanëve, edhe vetë Abdyl Frashëri. Prandaj, nuk ka pse të paragjykoheh pjesëmarrësit e Kuvendit të Prizrenit dhe t'u ngarkohen "gjynah" që nuk i kanë apo i bartin në se mud të quhen të tilla, dhe të gjithë personalitetet e tjera të Rilindjes që nga ajo kohë e deri në nëntor të vitit 1912.

Kur bëjmë fjalë për referim të Kararnamesë në ndonjë rast të feja islame duhet të kemi parasysh se ligjit fetar musliman organet e Lidhjes do t'i drejtohem, siç thuhet aty shprehimisht dhe pa asnjë mëdyshje, vetëm për mbrojtjen e jetës, të pasurisë dhe të nderit të bashkatdhetarëve muslimanë, dhe siç theksohet po aty, ashtu si për vete, d.m.th. për vetë muslimanët. Në këtë formulim të përpiluar dhe të miraturar në Bajrakxhaminë e Prizrenit kemi të bëjmë, siç del qartë, me një nen, i cili u bën nder shumë të madh autorëve të tij, kuvendarëve të

kombëtare mbarëshqiptare, që në ditët e para të themelimit të saj dhe nuk u shndërrua në një të tillë, siç pretendohet ende, as më 17 qershor, as më 2 korrik të atij viti, kur aty arrijnë përfaqësuesit e vilajetit të Shkodrës, dhe më 1 nëntor 1878 dhe ata të Janinës.

Autorë ballkanas, në radhë të pare ata serbe, që nga Haxhivasiljeviçi e deri të Bogdanoviçi, pretendojnë se përfaqësuesit shqiptarë në Kuvendin e Prizrenit qenë ballafaqur në dy rryma sipas ndarjes gjeografike e krahnore: në atë të progresistëve të Shqipërisë Jugore e të Mesme dhe në atë të konservativistëve të Shqipërisë Veriore e Verilindore. Këto pikëpamje nuk mbten pa jehonë dhe në ditët tona në ndonjë studim serioz kushtuar Lidhjes.

Analiza e dokumenteve themeluese të Kuvendit të Prizrenit, hedh poshtë karakterizime politike dhe shoqërore të tilla negative për pjesëmarrësit e Kuvendit historik të Prizrenit të 15 qershorit 1878. Në këtë mënyrë të shtrimit të problemit harrohet fakti që elementet të moderuar apo dhe konservatorë nuk mungonin dhe nuk ishin më të paktë edhe jashtë vilajetit të Kosovës, Shkodrës dhe

udhëheqës politikë dhe burra shteti. Ata kanë ditur gjatë gjithë historisë, ashtu sikurse bashkëkombësit e tyre në trevat e tjera shqiptare, të luftojnë jo vetëm me çark, siç shprehet dhe ndonjë autor i yni, por dhe me mend.

Janë pikërisht përfaqësuesit e popullsisë shqiptare të Kosovës, e Shkodrës dhe të Manasirit si Ali Gucia, Iliaz Dibra, Daut Boriciç e sa të tjerë me Pashko Vasë Shkodranin në kry, nismëtarë të lëvizjes për themelimin dhe orientimin e drejtë të Lidhjes së Prizrenit, qysh në hapat e para të saj. Qenë pikërisht këta, të cilët, duke folur në emër të mbarë popullit shqiptar, i dhanë Lidhjes, qysh në fillimet e saj, platformën mbarëshqiptare, programin atdhetar dhe taktikën revolucionare të luftës për ruajtjen e tërësisë së trojeve amtare dhe, njëkohësisht, dhe të luftës për sigurimin e të drejtave kombëtare në shkallë e një autonomie politiko-administrative në kuadër të Perandorisë Osmane. Këtë detyrë ata e kryen, me që koha nuk i lejonte, pa pritur ardhjen e përfaqësuesve të viseve të tjera. Prandaj dhe delegatët e vilajeteve të Shkodrës dhe madje edhe ata të Janinës u bashkuar me besim të plotë rreth nismëtarëve dhe themeluesve të Lidhjes së Prizrenit, kryesisht nga Kosova, duke i dhënë asaj tashmë edhe faktikisht dhe jo vetëm në letër karakterin mbarëshqiptar.

Përpjekjet për të evidencuar ndonjë kuvend, si i ashtuquajtur Kuvend i Frashërit mbajtja e të cilit nuk vërtetohet përveçse në kujtime të mëvonshme të padokumentuara, nuk gjen mbështetje. Data e supozuar e tij ka ndryshuar disa here, duke e sjellë deri në prag të Kuvendit Themelues të Lidhjes në Prizren, për ta eklipsuar rëndësinë e vendimeve historike të 15 qershorit 1878.

Mbi Kuvendin historik të Prizrenit nuk mund të hedhin hije as përpjekjet e një kuvendi të dëshuar si Kuvendi i Gjirokastrës, pa varësisht nga pikëpamjet mjaft të përparura të njerit prej organizatorëve të tij që ka ngelur anonim. Kuvendi në fjalë u paraluzia tërësisht, siç pretendohet, nga shqetësimi për fatet e trojeve të Jugut dhe nuk arriti të dilte me një rezolutë të përbashkët jo vetëm për çështjen e autonomisë por as edhe për mbrojtjen e trojeve nga rreziku i aneksimit të tyre prej Greqisë.

Lidhjes, midis të cilëve nuk mungonin dhe përfaqësues të të krishterëve. Aty kemi të bëjmë me një qëndrim tejet të emancipuar, jo vetëm për atë kohë kur ai është shpalosur; por dhe më vonë e deri në ditët tona. Një qëndrim tejet human dhe tolerant që vështirë ta gjejmë ndër fuqitë tanë jo më atëherë por dhe më vonë e, madje, as edhe sot. Ky qëndrim ngërthen në vet vete edhe në ditët tona një mesazh tepër aktual dhe të vlefshëm, të cilin shqiptarët, pa dallim besimi, duhet dhe behohet se do t'i përmbahen edhe sot e kësaj dite.

Me rezolutën e pretenduar të 2 korrikut, e cila gabimisht vijon edhe në botimet e sotshme (shih: Historia e popullit shqiptar, vëll. II, Tiranë, 2002, 159-160), t'i kundërvihet në një shkallë apo në një tjetër, "Kushtetutës" së 15 qershorit të vitit 1878 të Lidhjes, nuk u arrit gjë tjetër veçse të konfir-



të Manasirit.

Para se të frikësohemi se mos historia e Lidhjes mistifikohet mbetet detyrë e rëndësishme e jona që ajo të cmistifikohet nga falsifikime të çdo lloji.

Ruga e Lidhjes së Prizrenit që në hapat e para të saj dëshmon katërcipërisht se popullsia e treleve veriore, verilindore dhe lindore nuk ka qenë vetëm një rezervë luftarake e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare të të gjitha kohërave, dhe konkretisht të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Ajo ka nxjerrë jo vetëm luftëtarë dhe komandantë të shquar por dhe

# K

## KUJTIME

NGA ILIRIAN AGOLLI

Vijon nga numri i shkruar

Në 13 prill studenti i sëmure Lasgush Poradeci u kthye në vendlindje, shkroi Shqipëri e Re. Mjekët e këshilluan të shkante në Shqipëri për t'u përmirësuar nga shëndeti dhe për të kaluar disa ditë të lumtura me nënën dhe me të afërmit e vet, që nuk i shihte prej disa vjetëve. Një shoqëruar rasti solli detaje të udhëtimit. Studenti poet erdhë në Durrës mbremjen e të shtunës më 13 prill pa e marrë vesh kush, shkroi *Gazeta e Re*. Të nesërmen në orën 10 zuri vend në veturë. Djaloshi shtatmesëm, i veshur thjesht, me fytyrën simpatike por të zbehët kërkoi të ulej larg shpërit në vendet e pasme. "Kam qenë i sëmure dhe akoma nuk e kam marrë veten. Shoh një përmirësim në shëndetin tim dhe kam shpresë të bëhem më mirë, kam 6 ditë që udhëtoj. Jam nga Poradeci, student në Austri, në fakultetin e Letrave. Isha i sëmure në një sanatorium në Graz, dhe pasi doktorët më këshilluan se vetëm me ndryshimin e klimës mund të shpëtoja, vendosa të kthehem në atdhen e dashur" - i foli Lasgushi bashkudhëtarit. Ai tha se në pak kilometrat e para kishte ndërjer një lodhje të madhe, por udha e keqe mes Durrësit dhe Elbasanit u zhduk dhe poeti e ndjeu veten më mirë, ndaj tregoi disa histori për Malin e Vashës dhe për vende të tjera, që shquhen për legjenda të moçme. Makina mbërriti në Elbasan në një pasdrekë, ku për gjysmë ore të gjithë drekuan dhe u shplohën për 30 minuta në restorantin Adriatik. Poeti tha se po kthehej pas 8 vjetësh në atdhe dhe se vendi kishte ndryshuar shumë qysh nga 1921, kur ish larguar. Makina iu afrua Pogradecit në orën 7 dhe ai tha i mallëngyer se "ky ishte liqeni më i bukur i botës" dhe se ishte i lumtur që mbërriti gjallë në qytetin e tij të zburruar. Automjeti bëri edhe një orë tjetër rrugë deri në Korçë, ku vazhdonin prenotimet<sup>3</sup> për vëllimin poetik të Lasgushit. Pëtraq Katro dha 30 frari sa për 12 kopje libri, Rev. Phineas Kennedy 20 frari, Llambi George, Pandi Nini, ing. J.Adam, Manol Vaçi, Dhimitër Faló, Evelyn Scibolt, Nikolla Mitace, Andon Frashëri dhe zonja, një anonim 5 frari, Gjini Katundit 4, Farenqji Harallambi, Sotir Kozma, O.Melo 3 frari, Eleni Konda, Elpinqi S. Kozma, Sali Çaushi, Tife Çarkaradija, Efigjeni Rahall, Andoneta Sarajdari, Athina Dhemi Shqoti, Dhimitra Pano, Th. Trebicka, Pandeli Bogadini, Muharrem Rexhepi, Muharrem Gega, Shaban Ademi, Rini Halle, Fetah Nevruzit dhuruan 2.50, Qani Panariti, Vani T. Botka, Hella Logory, Aleksanda Filce, Evridhqi Gilava dhanë nga 2 frari. Po ashtu, Rev. Tackër. Zonja Plumbi, Zonja Gjakoreci, Zon-

Në këtë pjesë vazhdon përshkrimi nga publicisti të momenteve të vështira të jetës së Lasgush Poradecit. Me ankimet e zakonshme të poetit që po lulëzonte dhe përkëdhelitet që e rrethojnë ngado dhe që në fund konkretizohen me ndihmë, autori na jep dhe momentin kur Poradeci shpërblehet për Himnin e Rinisë, që bëhet në kremtimet e ditëlindjes së Mbretit Zog...

# Kthimi i studentit Lasgush Poradeci në vendlindje

usha Qamo dhanë nga 7 korona, Nikolla Çeno dhuroi 3 korona, nxënëset Kaliopi Qirjako dhe Marianthi Apari dhanë nga 1 koronë / gjithëgjatë 33 korona dhe 152.50 frari. Kaq shumë dhurime ndihmash u mbështetën edhe nga shkrime prej studiuesve mbi vlerat e poezive të studentit. "Lasgush Poradeci na hap portën e një jete të re<sup>4</sup> në poezinë shqiptare, në lëmin e këngës shqiptare, një stil të ri, të cilin do ta kërkosh më kot ndër poetë të tjerë shqiptarë, por më kot edhe ndër shkrimtarë të huaj, nga shkaku i origjinalitetit, që e shquan këtë poet djalosh" - shkroi te *Gazeta e Re* gjuhëtari Eqrem Çabej, edhe vetë një studiues i ri.

## Lasgush Poradeci për veten

"Megjithëse i sëmure, s'kam dashur të rri pa vepruar: kam dërguar për të shtypur disa krijime origjinale: kam bërë këngën "Dita e Laes" për "Gruan Shqiptare", mbarova lumturisht "Marshin himn të Djalërisë që përgatitet", (i ngarkuar nga dega e Pogradecit. Marshi u destinua për Entin Kombëtar. Me këtë vjershë të madhërisme më pat ngarkuar Mbreti Zog I. Titullin e zjodha vetë); po mendohej të vë në shtyp "Parafjalën", një tufë poezish organike, që simbolizon triumfin e Dritës së Përgjithësisë në lakminin e një vdekjeje premature... "Parafjalën", e cila është mbaruar që më 1924, kur shkrofta vjershën e fundit "Rri me shëndet", e kish filluar ta vë në urdhër shtypi në fillim të këtij muaji në Pogradec nga Çervenaka, fshat klimaterik, ku isha ngjitur për t'i rënë pas shëndetit të humbur..."

Ai theksoi se stili modern i Lasgushit ndryshon nga stili i Naimit dhe i Fishtës aq sa ndryshon një pjesë beethoveniane nga një mozartiane. Në një faqe gazete të tërë Çabej e krahasoi Lasgushin me poetë të famshëm botërorë, me shpresën se po lehtësonte kuptimin e poezive të djaloshit, "të cilin in një fat i mirë ia ka falur Shqipërisë, që të bëhet ai shkrimtar, të cilin Shqipëria do t'ia falë një herë botës"... Gjuhëtari shprehu shqetësimin se Lasgushi nuk krijonte prej kohësh, ndërsa djalëria i kaloi nëpër një sëmurdje të rëndë dhe të pamëshirshme, që po e shtypte tragjikisht. "A është sëmurdja shkak i vuajtjeve të tij, apo vuajtjet e tij u bënë shkaqet e sëmurdjes; këto janë probleme tepër të koklavitura. Por letërsia shqiptare do të fitonte shumë, ose



Lasgush Poradeci

do të humbiste shumë me Lasgush Poradecin. Ne duam të parën. Po Fati e ka në dorë" - shkroi Eqrem Çabej nga Grazi në shkurt 1929.

Nga Roma, Kudret Kokoshi i kushtoi Lasgushit një poezi të gjatë plot figura letrare, epite dhe lavdërime, po te *Gazeta e Re*. Nga Amerika poetit iu kushtua një tjetër shkrim në gazetën *Albania*. Një studiues me pseudonimin Tom Fakiri theksoi se sëmurdja e Lasgush Poradecit lidhet me të ardhmen e shqiptarëve të penës, puna e të cilëve është njaft e rëndë. "Në Shqipëri njeriu i letrave nuk shpërblehet për punën e merituar që bën, por duhet të prishë edhe nga xhepi, që të nxjerrë shkrimet e tij në shesh. Duhet të ketë siguruar rojtjen e tij me një mënyrë tjetër duke punuar, dhe nëse i mbetet kohë, mund të marrë penën për gjëra më të larta" - shkroi autori. Disa prej tyre i zuri tesh, siç thonë në Korçë për ata që nuk e kanë bukën e përditshme, aq sa u zhdukën nga shpirti çdo shqetësim për vepra të bukura. Sipas tij, në Greqi dhe shtete të tjera të Ballkanit ata që shkruajnë janë avokatë, nëpunës të qeverisë, ose mësues që kanë siguruar më parë mjetet e jetesës. Në Shqipëri, edhe

meve të tyre, njoftoi *Shqipëri e Re*. Sipas vendimit të ministrisë së arsimit, nga 1 tetori studentët morën këto bursa: Në Bullgari - për universitet 140 frari në muaj, në Rumani - për shkollë të mesme 100 frari në muaj, në Stamboll - Robert Kolezh 1200 frari në vit, në Francë - Universiteti Montpellier 190 frari në muaj, Universiteti Paris 210 frari në muaj, Universiteti Trav.Publik 230 frari në muaj, universiteti elektrik 230 frari në muaj, në Angli Universiteti Oxford 450 stërlina në vit, Cambridge 450 stërlina në vit, universitete të tjera 220-240 stërlina në vit, në Itali përgjithësisht 120 frari në muaj, Greqi për Universitete 200 frari në muaj, Austri dhe

## Ndërprerja e bursës

Një zyrtar i lartë i ardhur nga Tirana, më ngarkoi t'i bëj një vjershë për kremtimet e 8 tetorit... Punoja me zell, kur më 5 shtator, një shkrues zyrtar e papritur ma nguli thikën në gj: ministria e arsimit më lajmëronte më datë 4 shtator 1929 se ma ka prerë bursën që në fillim të gushtit. Kjo gjë, i dashur doktor, ishte për mua të rinë më tepër se për t'u çmendur. Po e përmbajta veten prapë. Veç më vjen keq se bëra me pahir të pabërën. I thashë vetes: Ata, të mëdhenjtë, më thonë të punoj, pors i një ka i mbështetur, brazdën e thellë në ugarin e shkretuar kombëtar, po... ku është tagjia?! Ku?! Pa zë çbëhet ç'u pat bërë, ç'u godit zë çkatërohet..."

Gjermani për shkollë të mesme 180 frari në muaj, për universitete filologjike etj. 250 frari në muaj, për universitetin e mjekësisë etj., 250 frari në muaj, për universitete teknike etj. 230 frari në muaj. Nga ana tjetër, ministria ndërpreu si çdo vit një mori bursash të studentëve jashtë shtetit, sepse kishin mbetur në provime. Midis tyre ishte edhe Lasgushi, student në Graz të Austrisë, i cili nuk shkoi në provime, sepse po kurohej në sanatorium.

Edhe pas një viti shëndeti dhe ekonomia e tij nuk u përmirësuan aspak. Më 22 shtator 1929 Lasgushi i shkroi<sup>5</sup> nga Pogradeci mikut të tij Dhimitër Pasko në Konstancë, i cili i propozoi "t'i mblodhë poezitë e përhapura andej-këtej në një volum", se ai nuk kishte të hantë për

→ Vijon në faqen 18



KUJTIME

**Ky tekst, kushtuar Mjeshtrit të Madh Hazis Ndreu, është shkëputur nga libri i artistit Bujar Kapexhii "Burri i Odës Dibrane". Shkrimi është enkas me rastin e tetëmbëdhjetë vjetorit të ndarjes nga jeta të tij**

# “Burri i Odës dibrane”

NGA BUJAR KAPEXHII

Në një kthinë të fshehtë, potohuajse të humbur e të harruar të historisë së artit shqiptar, mbuluar me tis pluhuri gri, hesht e përgjumur, e lënë pas dore, krijimtaria e një prej krijuesve më origjinalë, më të rrallë, më interesantë, unikale në kontributin shumëplanësh, e Mjeshtrit të Madh Hazis Ndreu.

Nëse studiues e teoricienë, fare rastësisht do të hedhin hapin e tyre mbi dyshemën e kësaj kthine, brenda godinës së artit e të kulturës, me siguri, instinktivisht, vetvetiu do i ngadalësojnë hapat dhe papritur do i qëndrojnë një hop, duke dëgjuar zërin melodioz të një rapsoidi, tinguj plot variane të një melodie me çiftelise... Do mahnitën me lëvizjet energjike të një valltari popullor, do qeshin me gjithë shpirt me vargjet e poezive humoristike... Për një çast do mbeten të hutuar e në mëdyshje nga kuptimi i fshehur i alegorive dibrane... Më pas do befasonin nga qindra e qindra emra për topnimin e studimeve për Skënderbeun, do mrekullohen kur të prekin ornamentet e kostumet popullore, të kërcuara, të zbuluara e të studiuar si thesar etnografik... Dhe, së fundi, ndoshta nuk do besojnë se në raftin e pluhurosor gjenden libra që kanë çmime nëpër konkurse kombëtare. E dikush, nga habia, befasia e kurioziteti do pyesë se cilët janë këta njerëz kaq të talentuar që kanë ushtruar këto profesione, e cilët janë këta emra, autorë të gjithë kësaj krijimtari artistike, shkencore dhe studimore. Dhe përgjigja do të jetë e veçantë, e rrallë, ndoshta e pabesueshme, por e vërtetë: Të gjitha këto profesione janë ushtruar nga vetëm një njeri. Veptrat artistike janë krijuar nga një artist.

Kërkimet, zbulimet e studimit, nga një emër. Gjithçka që dëgjuat dhe shikuat kanë shpërthyer nga mendja dhe shpirti i një njeriu të vetëm... e ai quhet Hazis Ndreu. Kam lexuar e dëgjuar shumë për të. Kujtoj kohën kur pak herë e kam takuar. Dhe atëherë, thjesht kalimthi, takime të shkurtra midis meje, regjisor në Estradën e Tiranës dhe ai rapsoidi, aktor e valltar nga Peshkopia. Takime të shkurtura me buzëqeshje estradeske, shtërngim duarsh, urime të singërta, lëndata, vlerësime të ndërsjella e këshura takimi përfundonte me “Suksesë të tjera! Mirë ardhshi në Tiranë! Mirë se të vini në Peshkopi!”. Kaq. Prisnim takimin tjetër të estradave në një tjetër qytet të Shqipërisë.

Në atë kthinë e harruar që përmenda në fillim të këtij shkrimi nuk kalova rastësisht. Jo!

Djemtë e Hazisit më trenguan gjërë e gjatë projektin e tyre. Unë kaq desha. Ndeza dritat e krijimtarisë sime, fshiza pluhurin mbi dosje dhe nisa të njëj pas gjurmëve krijimtarinë e tij. Brenda meje, si një llavë që zien në thellësi të një vullkani, nisi të ziejë dëshira për ta njohur edhe më mirë këtë krijues të rrallë, të pashtershëm, gazmor e hokatar, që këndoi, recitoi, vallëzoi, krijoi poezi, rapsoidi dhe humor me ndodhi gazmore. Vetëm mendja e tij pjellore mund të derdhte të tillë pasuri krijuese, përmes një shpirti artistik, për 50 vjet rresht pa ndërprerje. Edhe tani që po rradhis këto fjalë të thjeshta, të ndjera dhe të vërteta, më duket sikur zëri i tij vallëzoj

ftohtë, kalimthi, si për diçka të largët, tashmë të harruar. Unë mbeta i shtangur. Prisja që të thoshë me pasion: “Eh, Hazis Ndreu, mrekullia e artit dibran!” Jo vetëm dibran. Më thuaj, të lutem, një tjetër si ai. Nuk e gjen. Prandaj unë them me bindje: unikale. Ka shkrimtarë të mirë, që nuk dinë të këndojnë; ka këngëtarë të dëgjuar, që nuk dinë të kërcëjnë; ka valltarë profesionistë, që nuk dinë të interpretojnë me veglat muzikore; ka instrumentistë virtuoze, por që nuk dinë të shkruajnë poezi. Ka poetë të talentuar, por që nuk dinë as të kërcëjnë, as të bëjnë humor. E pra, Hazisi i bënte të gjitha. Dhe të gjitha me nivel artistik. Te të gjitha i vlerësuar me duartrokitje nga publiku dhe me çmime të shumta nga juritë e letrave e të skenës. Prandaj, mos mblidhni buzët, duke më tërhequr vëmendjen se po e teproj me lëndata, me vlerësime paksa të tepruara. Aspak. Po them një të vërtetë.

Ka shkrimtarë, dramaturgë, poetë të vlerësuar, por që nuk janë të zotë të shkruajnë humor... Janë seriozë, nga që nuk dinë të qeshin. Të dish të qeshësh është dhunti.

Jo të gjithë dinë të qeshin. Hazisi fliste seriozisht e qeshte seriozisht. Hazisi ishte serioz me të qeshurën e tij e jo si disa që janë qesharakë me seriozitetin e tyre. Mençuria që hijeshonte bisedat, romuzet, epitetet dhe historitë në Odat dibrane e mësuan si të fliste, si të mendonte, si të pyeste e si të përgjigjej. Kur të



qeshte, si të qeshte e sa të qeshte. Si të qëndronte serioz e kur të qëndronte serioz. Kur të bënte shaka e kur të tallej, të thumbonte, të ironizonte. E kur të zemërohej, e kur të shante e të bërtiste. Mësoi edhe kur të heshtte. Dhe heshtja e tij shpesh herë ka folur e bërtitur shumë më shumë se fjala. Brenda vetes, si në një enë të mbyllur fort, i zienin mijëra fjalë e fraza. I zienin nga zemërimi, nga revolta dhe mbeteshin në thellësi, sepse regjimi i diktuarës t'i pranoste fjalët, t'i torturoonte frazat, t'i pushkatonte idetë, ta shuante frymëzimin e ta degdiste mendimin. E megjithatë, ai diti të flasë me alegorinë dibrane, të mençur, të fshehtë, thersëse, tallëse, goditëse.

Ai e njihte mirë regjimin. Nuk e donte. Në krijimtarinë “diversante” si me parashutë zbrisnin vargje goditëse, të dymshata dhe të parapuneshme për shabllonet e artit socialist, vargje pyka, të fshehta, që tallshin me regjimin. Ish-te humor që i shpëtojnë, ishte e qeshura që detrononte të prano-

Shumë shpesh kujtoj si në një sekuençë filmi gishtërinjtë e dorës së një poeti që shtërngojnë penën, duke ndjekur me radhë rreshtat nga fillimi i faqes në fundin e saj. Kështu është sekuenca e parë e punës së një poeti...



Ndërkohë po ndjek edhe sekuençën e gishtërinjve të Hazis Ndreu, me penën që shkruan mbi faqen e bardhë.

Mollëzat e buta të gishtërinjve të tij energjike kanë prekur edhe telat e hollë të çiftelisë, duke shkëputur prej tyre tinguj marramendës, të cilët, duke u shoqëruar me zërin e trallë melodioz, harboheshin e vallëzonin në ajër, duke mberthyer dhe ekzaltuar qindra njerëz, që harronin realitetin, ëndërronin, për të shpërthyer pastaj në duartrokitje entuziaste, të gjata pa pushim... Për virtuozin gazmor, me qeleshe të bardhë, jekë-kun me viza të zeza e tirq të bardhë: “Eh, Hazis Ndreu, të lumtë goja, na kënaqe!”

Gishtërinjtë e Hazis Ndreu nuk ndalojnë, por me zhdërvjellësi valëvitin në ajër edhe shaminë në vallet dibrane. Të palodhur, ata

doherë në qenien e Hazisit. Të dukej sikur i kishte në xhep, të gatshme, të paketuara me emërtime përkatëse dhe me dozën e “helmit” humoristik apo satirik të batutave, citateve, përkufizimeve, apo borsollet e atypëratyshme, që i jepnin më shkëlqim bisedave. Batuta të mençura humoristike plot finesë e mençuri për të kaluar herë pas here edhe situata të koklavitura që të turbullonin mendjen e të shtonin ankthin për pasojat që mund të vinin nga interpretimet e mediokre sipas shabloneve socialiste. Çdo batutë shpëtimtare që si ato tullat që vendosen në pellgun me ujë për ta kaluar atë pa u lagur, gjër në bregun tjetër. Kështu edhe Hazisi, në shumë raste me shoqëri bënte humor me zar, por me shkathësi hidhte tullat humoristike, për të kaluar më qetë e pa u lagur nga kërcënim i ideologjik. Megjithatë, disa herë nuk doli pa u lagur. Batutat e tij herë të tharta e herë të hidhura, shkaktonin nervozizëm e indinjatë në nëpunësit partiakë që shtrembëronin buzët, picëronin sytë, kruanin zverkun, ndiznin cigaret e tymosnin vrullshëm. Por shpejt mbi thartirën e hidhësinë, Hazisi në vazhdimësi të muhabetit hidhte lëngun e ëmbël, zbutës, që i qetësopte papritur dhe, duke harruar çka u tha pak më parë, ndiqnin me kureshtje e buzë në gaz vazhdimin e interpretimit me recitime, këngë e valle.



Qofsh i nderuem Hazis Ndreu Pastë uratën nana që t'leu Jam përjepk me t'ba portretin E gjatë rruqa, fort e vshtirë, Si me kalue në kamb detin, Po rri në breg, se t'shof ka mir. Hazis Ndreu je vet' deti Tallazi i larit vjen nga thellësia Sipas meritës dhe adetit Kto pra janë vargjet e mia. Sot asht viti i tetëmbëdhjetë Si Mjeshtër i Madh nuk je në jetë. Me kë't rast kam amanet Se kam pritë kaq shumë vjet Në rrugën e blicëve, n'trouar Ka plot buste me lufëtar' Aty ka vend dhe për këngëtar, Për poetë e shkrimtar, Për aktor e regjisor Për piktor, kompozitor Të gjithë bashkë të pandarë Ndoshita Zoti e ban mbarë Se bashkia në gjum' ka ra Për artistët s'po ban kurrjia. Luftën s'them 'mos e kujtoni, Po edhe paqen mos e harroni Sakrificat janë njësoj Edhe në paqe ka heroni. Për Hazisin në kë't kuvend Propozoi një monument. Ktu po e mbyll or mik i vjetër Gjithçka e ke të shkrueme n'letër, Mirupafshim n'bōtën tjetër!





Është një cikël poezish të mrekullueshme prej autorit kroat, një nga poetët më të lexuar të rajonit në kohën tonë. Autori punon me simbolika dhe koncepte dhe jep një letërsi me karakteristika realisht shumë të larta...



# SHESHI I SHEN MARKUT

presin të bëhen kapi me lajme të reja. aty-këtu zolat gugin nga varret, si pellumba. dhe populli i tyre gugat në sytë e popujve të tjerë, po gjatë natës, kjo po ndodhin natën. ditën mugullon dhe zogj të kthehen në qytet; letat e rënda të këngës dhe toka pjellore prej jashtëqitjesh mbërthen fytyrën. gardhet zvarriten në qiell. kamerierët gatisin tavolinat dhe mizat bien brenda gotash. e gjetbra shpejt e mëson gjuhën e vet - fjalor i besueshëm i qiparisit, shkronjat e ahut dhe meshleknes; madje edhe e zeza nën thonjtë është gati të lulezohet. megjithatë kjo s'është pranverë, s'është asgjë. nuk ka pranverë pa ty, e mjaft pra mjaft me gënjeshtra.

## KORRIK, I Pakryer

Ja kështu është qyteti  
pjatë që nata i avitet shumë ngadalë  
pjatë flakëruese, por nata megjithatë po bie

ky është një qytet i madh  
e gjithësesi rrallë dikushi ka ndonjë zbatimje

korrik

ai presion, kërcu nën krye të vitit  
tragjedia e kohës sonë.

ky është qyteti, ky është qyteti a po e dëgjoni vallë  
kioskat njëra pas tjetres çojnë qepenat  
shiu në avull tretet sakaq, populli ynë në qiell  
populli në trupin e një oxhaku

ende megjithatë më ka ënda ditët e fshira shpejt në të djeshmen  
që më shpejt se iriqet imatçi ia mbathin  
makthit prej labirintit të shkurrese së palëvizshme

po, shumë më tepër ditë dielli mbi krye  
dhe e gjitha po bëhet më e vështirë t'i përball faktet  
njerëzia rri e prangosur në qiell me yjet  
si *Gould* mu atje tutje në Kanada, në një pyll të tërë yjesh

poshtë këtu gjendemi në Korrik e lekura po m'digjet  
kudo përreth është Kroacia, një bumerang i marre  
zjarresh, shezlongësh, këngësh të pakta

kur rrobat thahen sakaq  
dhe vdekja shtrëngohet në vetëm tri pika  
fundit të një fjalie të papërfunduar.

*\*Glenn Gould, pianist i njohur kanadez (1932-1981)*

## E shtunë, Vithisja

Lind tekta qielli po rrezohet  
si një dardhë e kalbur  
nën tryezë.

krimbat zvarriten

si kamerierë.

kurse faturat e pagapaguara  
prehen njëra mbi tjetrën.

Maria hyn, unë ia them Marisë,  
ajo veç m'i përshfaq dhembët.

prej tani krusulloset dhe pret, krusulloset  
dhe duke pritur, vendos  
për ta ndryshuar aromën e saj.

pirërm nga derrat:  
e vendos trupin mbi mish'n e bardhë  
dhe tekta mbyll sytë, këqyr

mbi të gjithë hapësirën e natës flokëshprishur.

## EPIKA, Atje lart

Lumi është i paanë atje sipër, një pellg i pamasë katrani.

qielli një filxhan i boshhtë kafeje.  
gjurmë buzëkuqi ndër dhembë, detyra e rrezikshme e kalimit  
përshëndetjet e shpërndara vetes si tavolinat e një terrace verore,  
hi në zgavrata e veshëve, gojë, pëllembët,  
tavllat e braktisura të botes.

është dita e të gjithë shenjtëve, ani nuk besoj as edhe tek njëri syresh.  
vjeshta e të gjitha gjërave: trefja e trupit dhe kohës, kalendari i kuq,  
ekskursione, vrima në boshësi, netët, të cilat në mënyrë kronike ngjizin dritën.

prej diku kundërmon bluarja, çmenduria e fronit të ftohtë vjeshtor: bie shi  
dhe buron kafe, që e gjerbim me aq sa mundemi: po veç qëndrojmë ende këtu.

## Pengesa të bukura

Shlëpia është një kuti.  
ka shlepë të ndryshme dhe po kuti të ndryshme, thonë.  
varesisht prej nevojave, klimës  
shpirtit dhe gabimesh të tjera. ka kaq shumë syresh  
saqë ndonjëherë është kaq e vështirë t'i identifikosh.

megjithatë, shlëpia është një kuti, them unë.  
ashtu si furra e nxehtë vetë dielli  
kafaz brinjësh për butin e pagjume të zemrës,  
ballin e një gote dhe çdo është si flaut. e jo.  
s'jam fare i interesuar në ç'mënyrë mbërriten.

kjo është thjesht arkeologjia e shtëpisë  
dhe filozofia e kullës ose anasjelltas.  
është e rëndësishme të ketë kule nëse i doni muret  
dhe dije se ato pengesa të bukura gjenden ngado.  
se çdo shtëpi dhe kuti duhet të ketë mundësi mbyllje.

çelësi i suksesit është të mbulesat, dritaret në shtëpi.

më të forta se dyert, më linzare: më shumë t'përrura së fsheshtës.  
oxhaku është një vrimë në zverc. hapje ajrit  
kapur prej një fyndyelli, e nëse do kish lepur në të, më mirë ende:

marmidë, për daljen e të gjallëve nga jeta.

jo. tymi nuk është shpirt. nuk ka gjë më të heshtur dhe më të merzitshme  
sesa shpirti. tymi është ajo pra çka e ben të mundur një shtëpi-kuti:  
tradhtia e mureve. një thirrje për hapjen e qjellit.

## Viti i Çajit


E mora dhe e dhashë sikur po sjell  
ndërmend dikë tjetër. magneti është metali im i preferuar.  
të dy gjithmonë lërheqim, por ai ka pak më shume sens  
për zgjedhje. atë që s'do thjesht s'e pranon. e unë s'jam  
aq sloik. mundohet t'hyjë në re  
dhe tani më mbush. dega rendohet,  
sikur në të po kendojnë zogj. ani askush s'kendon.  
nëse në rrugë do të shfaqej dielli  
do të kundroja yberin e plotë dhe asfalti do të avullonte. nga avulli  
çdo herë lind diçka. magneti është një mjet  
për percaktimin e dashurisë, edhe pse ndonjëherë s'ia del. dashuria  
e ndjek atë. në rastin më të mirë, nëse dielli ngrihet  
lart, në qoftë se davaritet mjegull, do të lëshonim hijen.  
ndaji mbaj dritaret e ulura dhe lekura  
e veshëve t'mi vuan. nuk mund t'ju dëgjoj. shoh mjeshtrin, i cili mberthen  
me gozhde. shoh një mace që ikën. shoh Vladimirin  
sesi ngjitet në shkallët dhe i bertas: ore Vladimir!  
ai kthehet, por nuk më njeh. shpejteshë tona janë  
të harmonizuar velle me rrotullimin e botës. kurse unë jam më i shpejtë.  
mbeshtetem në tekniken e keqe dhe taktikën e dobët  
e megjithatë të gjurmë. kur gjëj dikë shpejteshë  
të cilit është e ngjashme me limen i blatoj atij emrin. lart n'ajri  
zvarritet një avion. nuk e dëgjoj dhe as nuk e shoh dot, por ekzistenca e tij është  
plotësisht e qarte. nga lart përvijohet i gjatë si plumbi. tapa në këtë  
seksion të paparashikueshëm, pa peshë dhe ton. tradita  
thotë: poshtë nuk ia vlen të shkosh tradita thotë se je i martuar  
dhe se gruaja jote është lekurezeze, sepse ju jeni cigane. shiu  
po pakësohet, lulet janë të përgjakura dhe goja e kafshës shpërbehet.  
mizat kalojnë nëpër dritare. është qelësi. muzike e paqej e hapësirës,  
dhe ai po ndjek. nga varësia, ngadalë, kullon permes hapjeve të mia.  
çdo herë që udhëtoj e kujtoj shpejteshë time. kështu  
askush nuk vraponte. kur erdha njëherë në fshalin  
fqinj para makines. po birite shi. rrugët ishin  
mbushur me balte. disa herë u rrezova, isha shndërruar në një gjë krejt kafe, ani i  
lumtur.  
kurë s'kam vrapuar sepse doja që kështu të më kujtohej.  
mendova për njerëzit, nuk është e vërtetë se në këngët e mia  
nuk ka njerëz. atje është Vladimir. e thirra atëherë në Emër  
dhe ai ia doli, para qjellit të verit. është mesditë. hijet tona  
janë me ne ose ne po i paraprijmë. shpejteshë zvogëlohet. të gjitha  
kafshët u zhdukën për diku. vdekja është traditë: duhet ta frenosh,  
dhe të lihet të kalbet. duhet të jetë pra krejt si magnet. dashuria  
është një proces i rreptësise. burim i syrgjynosjes. po gjithë vitin thjesht gatova.  
isha duke zier çaj pra gjatë gjithë vitit.

*\*Përkthet nga origjinali kroatisht Ben Andoni*

...nga numri i shkuar

"Milosao" e këtij numri ishte relativisht e mirë. Redaktori e la vendin kryesor për një shkrim kushtuar Bienales së Venecias dhe pavionit shqiptar, në të cilin pati fatin të ishte gjatë inaugurimit në Venedik. Redaktori ishte për herë të parë në këtë aktivitet dhe u kënaq pa masë. "Pa asnjë dyshim, Bienala e Arkitekturës (e Artit) në Venecia është një nga ngjarjet më të rëndësishme të kulturës në botë dhe një atraksion shtesë i këtij qyteti historik. Përfaqësues shtetesh nga e gjithë bota mbledhen çdo vit, herë për art e herë për arkitekturë, duke konkurruar për 'Luanin e Artit', ose duke u rrekur të gjejnë hapësirën e merituar në Arsenale në mënyrë që ky fakt t'i fiksojë pastaj në kujtesën historike të këtij qyteti jo të vogël", shkroi ai i ngazëllyer për aktivitetin në përgjithësi. Gjithsesi, ai vetë, u mrekullua më shumë me pavionin e Kosovës për zgjedhjen shumë racionale, sesa nga Shqipëria që pati zhurmen më të madhe me ekzekutimin e projektit "#TiranaZeroSpace".

Ilirian Agolli, kolegu ynë gazetar, na kish sjellë prej shemjë kohësh një shkrim për Lasgush Poradecin dhe vuajtjen e tij shëndetësore por edhe angazhimin e të gjithë komunitetit shqiptar për ta shpëtuar. Një solidaritet i bukur që nuk e gjen sot e kësaj dite dot.



Për të treguar peshën dhe besimin e madh të publikut intelektual shqiptar të para Luftës ndaj Poradecit mund t'i referohesh kësaj sprovë të këndshme, që përbën fillimin e një botimi të gazetarit të njohur shqiptar...

Konstandin Dhamos i botuam një tregim dhe redaktori shkroi me këtë rast se *Narracioni i autorit është i drejtë dhe pa shumë stërrhollime, pasi synon të përcjtojë idetë e qarta të tij për subjektin...*

U shkrua dhe një shkrim për Entela Komninon dhe atë që ajo paraqiti në studimin e vet për Nolin. Redaktori u kujdes shumë që autorja e librit të vlerësohej sepse ka arritur të përcjellë në formën më moderne të duhur faktin se referimi i Fan Nolit është një model i duhur në kushtet e diskutimit mbarëshqiptar të vlerave shqipe, edhe pse kanë kaluar plot 100 vjet nga koha e shkrimeve të tij publicistike. Në një farë mënyre, ai na e ka treguar vetveten dhe është pjesë tek një kategori e atyre shqiptarëve që e shpëtuan Shqipërinë në fillim të shekullit XX dhe përcollin një trashëgimi të vyer. Puna e Komninës e vërteton këtë fakt.

Një sprovë e bukur ishte ajo e poezive që përktheu diplomati i njohur Kujtim Morina, që jo pak herë na ka bërë vërejtje dashamirë dhe shumë të gjetura...Në përgjithësi themi se ishte numër i mirë dhe pa shumë mëtime frymëzuese...

Letërsia shqiptare në gjuhë të huaj

LESSE

Prej dhimbjes dhe bukurisë

- Eseja që hap librin "Nata është atdheu im", poezi nga Visar Zhiti, botuar në Itali -

(NGA "LEJOJ FATIN E MBRËMJEJ")

Është sensi i asaj "dëshirë yjesh", që titullon dhomën e parë dhe që, në lutjen e përndritur e shkrirëse ndaj Birrit-Atë, e kthen, *trans-duce\*\**, në një këngë dhëmbshurie, në dhëmbjen e humbjes: "(...) ikonën e gjallë të fytyrës tënde mbaj/ me aureolën e shpirtit tim përreth. // Jepma dorën dhe bekomë/ Biri im, Ati im!"

Dhe është ndërkohë një këngë-rapsodi së bukurisë, jo vetëm si antidotë për dhimbjen, por vetë formë e asaj pyetje, pikërisht absolute, e cila vetëm mund të zbulojë gramatikën e jetës dhe nëpërmjet saj edhe të dhënat e një njohjeje të mundshme.

Në vendet ekstreme të shpirtit të banuar nga fjala, poezia e Zhitit inkorporohet deri sa bëhet botë, univers.

Pyetja (*Ku është jeta?*) është ende njehsori i dhomës së dytë. Dhjetë tekstet e një requiem, ku poeti, në dëshirën e një kupitimi të ekzistencës në detin e dhimbjes, kërkon fjalët që thonë një domosdoshmëri jete, pavarësisht nga jeta:

Ku është jeta, se ndonjëherë më duket se gjendet jashtë meje dhe bën dhe pa mua?

Po unë a mund të bëj pa jetën si për t'u hakmarrë?

Një pyetje, pra dialoguese me misterin e humbjes, me *non-sensin\*\*\** e tij, i njëjti si i Maries, nënës së të Kryqëzuarit, i njëjti mister që ndjell Leopardi në *Canto notturno* ("Po pse, moj Jetë, /më ngarkon ndërkaq me ato që dot nuk i mban (...)" dhe fjalët "memece" të lutjesimit të *Pyetësorit* (*Libro delle interrogazioni*) të Edmond Jabës.

Fjala ngrihet atëherë, në një epifani të re, në rilindjen e birit. Dritë e një vullneti të papërmbyshëm të jetës ("Dua ta gdhënd dritën, / dhe pas vdekjes,") me forcën e një dëshirë që bëhet mermer dhe ujë i bekuar.

Dhoma e tretë (*Kjo ditë e gjithë për të kujtuar*) hap më së fundi këngën shenjtërore. Në pajtimin e shpirtit me vetë *da-sein\*\*\*\** në zërin që bëhet i tërë njësh me arkitekturatur vizionare të një bote të përtërirë dhe ku dhëmbja gjen vetë ngushëllim: "Dhe vjen nata dhe fati im i mbetur/ ndricon si mermer në errësirë..."

<sup>\*)</sup> ligan vital – fr, forca vitale, impulsi i jetës, term i përdorur nga filozofi francez Henri Bergson në librin e Tij "Kreativ evolution", princip i krijimit në morfogjenezën e gjërave, komplekse dhe rilëse.

<sup>\*\*)</sup> trans-duce – lat, të konvertosh diçka në një formë tjetër si energji ose si mesazh, energjinë fizike ta kthesh në një sinjal nervor.

<sup>\*\*\*)</sup> non-sens – fr. në filozofinë e gjuhës dhe të shkencës mbar kuptimin e absurdit dhe të komikës, është përdorur nga poetë e romancierët për të shpalosur çështje të gjuhës dhe të arsimit.

<sup>\*\*\*\*)</sup> da-sein – gjerm. ka kuptimin e ekzistencës. Haidegger e përdorte si referim të përvosjes se të qenit, që është kaq e veçantë, e pazakonte, bizarre të qenies njëzërore.

NGA ENNIO GRASSI

"Letërsia, si i gjithë arti, është rrëfimi që jeta nuk mjafton". Fernando Pessoa

Biografia letrare e poetit shqiptar Visar Zhiti, në panoramën evropiane ndër më të mëdhenjtë e kohës tonë, është një gjë e vetme me atë ekzistencialen.

Në fillësë ishte dhëmbja, burim dhe formë së bashku i *élan vital*,\* i ndjekur me çdo çmim, pavarësisht gjithçkaje, për t'u bërë kërkim i pashmangshëm i sensit dhe i pyetjes absolute.

Nëse tekstet e përmbledhjes së parë në italisht, *Croce di carne*, 1997 (*Kryqi prej mish*), pjesë të së cilës u ruajtën në kujtesë nga burgu i ashpër në Gulagët e Enver Hoxhës, i zbuluan lexuesit italian një zë me intensitet të paparë, të endur në dëshminë e një tragjedie individuale dhe kolektive, me ato të *Confessione senza altari*, 2012 (*Rrëfim pa altare*), paraqitën botën me një vizion të ndërthurur mbi arkitektura leximi të një imagjinatë që nuk njih kanone, nga Esenini të Tsvetavaeva e Achmatova, nga Walt Whitman të Borges, nga Montale të Federico Garcia Lorca, forma të një fjale që kërkon portat e jetës në lirinë më absolute.


Në *La notte è la mia patria*, 2018 (*Nata është atdheu im*), kemi poetin që lexon në errësirën e shpirtit, si në një dorë kozmike, shenjat e "agimeve të reja", copra yjesh që përndezin papritmas, në shenjë e një shprese të mundshme, zemrën e territ.

Tre "dhomat" e kësaj përmbledhjeje (*Dëshirë yjesh. Ku është jeta?*, *Kjo ditë e gjithë për të kujtuar*) janë të banuara pikërisht nga çështja: britmë, pëshpërtje, venie në skenë të hapësirave, vertikale e vizionare, të pa përshkrueshme ndryshe.

Fjala merr vlerën e një universi tjetër, por asnjëherë jo vetëreferues, aq më tepër i mishëruar fizikisht në emocionet e poetit lutejplot.

Marr dorën e butë të kësaj mbrëmjeje e ledhatoj, pastaj e hap për të parë fatin. Kjo vijëz e brishtë është rruga,

ku po ecim, që do të na çojë në agsholet e reja, andej ku jeta është e gjatë, e gjatë sa lumenjtë e diejt dalin nga ujrat si ëndrrat e arta nga shtrati. (...)



ENNIO GRASSI

Ennio Grassi është kritik arti, esist dhe sociolog i letërsisë italiane. Studioi për magjistër në Universitetin e Urbinos dhe u laurua për Letërsi në 1969, më pas për Filozofi, në 1972 dhe sociologji në 1979. Ka dhënë mësimë në lece, në universitet Filologjinë Moderne dhe drejton kurse specializimi pasuniversitar. Ka punuar këshilltar për kulturën në Komunën e Riminit, ku dhe banon si dhe këshilltar në Ministrinë e Arsimit, kordinator në koperimet me Ballkanin dhe në programet e bashkëpunimit Itali-Shqipëri, ku dhe ka ardhur si diplomat special. Po kështu ka qenë këshilltar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Drejtorinë e universiteteve për Shqipërinë dhe Kinën. Është zgjedhur tre herë deputet në Parlamentin Italian. Është dërguar si vëzhgues ndërkombëtar në zgjedhjet e para demokratike në disa vende.



DISA TITUJ NGA VEPRO E TIJ:

- *Lo scrittore e il potere* (Shkrimtari dhe pushteti), 1974
  - *Sociologia e psicanalisi dell'opera d'arte* (Sociologji dhe psikoanalizë e veprës së artit), 1975
  - *L'antifascismo dell'intelligenza* (Antifashizmi i inteligjencës), 1977
  - *Immagini di parole* (Imazhe të fjalës), 1982
  - *I poeti della terra d'Albania, Antologia* (Poetët e tokës Shqiptare), me R.Sportelli, In forma di parole", 2002
  - *Tirana, genealogia di un ritratto in un esterno*, (Tirana, gjenealogji e një portreti nga jashtë),
  - *La cultura letteraria, in Storia della Chiesa riminese*, (Kultura letrare, në historinë e Kishës rimineze), 2015
  - *Nota al testo* (Shënime në tekst), me Manuela Ricci, 2018
- Ndërkaq është antar i Komitetit Shkencor i "Osservatorio Balcani e Caucaso", bashkëpunëtor i shumë revistave të njohura, drejtor për botuesin "Pazzini" kolanën e poezisë dhe është konsulent i projekteve të arealit ballkanik.

Përktheu dhe pajisi me shënime Ed. Ag.



Opinion *i* Ditës

# Nga frenimi te zgjidhja e krizës

Dr. Jorgji KOTE

(vijon nga faqja 1)

... të vërtetë politike në Belgjikë, sepse është tejet e dhimbshme që një fëmijë që i ka shpëtuar luftës në Irak të vritet nga policia në një shtet evropian si Belgjika.

Veç Mawdës fatkeqe, që azilkerkuesit «nuk duhen futur në një thes» si kriminelë, se ata vijnë për t'i mbijetuar urisë, skamjes, dhunës dhe persekutimit e tregoi dhe gesti heroik i të riut malian 22 vjeçar Maoumato Gassama që më 26 maj shpëtoi një fëmijë 4 vjeç në një lagje të Parisit duke u kacavjerrë me guxim të paparë në katin e katërt. Ky veprim u përshëndet nga gjithë Franca; Presidenti Makron e priti, i dha shtetësinë franceze që maliani e kërkonte nga shtatori i kaluar dhe u punësua si zjarrfikës.

Në kontrast të plotë me këto dy raste, javët e fundit në Gjermani ka plasur skandali i azilit; zyra përkatëse BAMF në Bremen ka abuzuar me 3.000 dosje të azilkerkuesve, duke shkelur më të dyja këmbët ligjet dhe procedurat më elementare zyrtare. Për pasojë, gjatë dy viteve të fundit kanë përfutuar leje qëndrimi dhe një numër jo i vogël të dyshuarish, si kriminelë, terroristë, islamikë dhe keqbërës të tjerë. E ndërsa në Berlin po luhet «pingpongu» institucional për hedhjen e fajit dhe përgjegjësisë, po shtohen me shpejtësi zërat politikë për ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar për këtë skandal; hije të shumta dëshmi për këtë skandal janë hedhur dhe mbi vetë Kancelaren Merkel.

Nërkohë, gjatë ditëve të fundit është rigjallërimi dhe përshkallëzimi i «Rruga e Ballkanit» për mijëra azilkerkues që tanimë ka prekur dhe vendin tonë duke ngritur një sërë shqetësimesh dhe pikëpyetjesh serioze.

Si për ta vështirësuar më tej situatën në këtë rajon, falë dhe qëndrimeve anti-migracion, disa ditë më parë në Sloveni riederhi në push-tet partia e djathtë nacionaliste e kryeministrit Jansa «shok armësh» me Orbanin.

Ndërsa zgjidhja e shumëkërkuar e kësaj krize duket vërtet luks pas krijimit të së parës qeveri populiste në një vend të madh anëtar dhe bashkëthemelues të BE-së si Italia; madje, qeveria e saj e re ka vënë në diskutim dhe vetë menaxhimin e kësaj krize sipas standardeve të njohura ndërkombëtare. Si hap i parë pritet të jetë dëbimi i gismë milionë azilkerkuesve, aksion ky gjithësi «shumë më i lehtë për t'u thënë, se sa për t'u bërë».

Mjaftojnë këto raste për të treguar se sa të vështirë e patën misionin e tyre ministrat e Brendshëm dhe të Azilit të 28 vendeve të BE-së që në fillim të javës u mblodhën në Luksemburg; bëhet fjalë për përgatitjen e strategjisë së re të shumëpritur të azilit dhe migracionit që do të marrë vullën përfundimtare gjatë



samitit të saj më 28 - 29 qershor.

Ky takim u zhvillua në kushtet kur në mungesë të alternativave bindëse për një zgjidhje tërësore qysh në burim të krizës së azilit janë përmendur dhe sugjeruar shembuj të ndryshëm e të diskutueshëm.

Kështu, modeli apo strategjia australiane «No way» synon minimizimin e skajshëm të pranimit të azilkerkuesve në atë vend, duke i paraseleksionuar ata në dy qendra të mbyllura priteje jashtë territorit australian.

Një ndër personalitetet më aktivë dhe që shkakton polemika në këtë drejtim, sekretari Federal belg i Shtetit për Azilin, Theo Francken ripërsëriti idenë e mëparshme se Belgjika do të studiojë mundësinë e zbatimit të këtij modeli. Pak a shumë të njëjtën gjë ka deklaruar së fundi edhe qeveria daneze për mbajtjen e azilkerkuesve diku në një vend tjetër që të jetë jo tërheqës për azilkerkuesit, përpara se të marrin vizën e hyrjes në Danimarkë.

Mirëpo, disa organizata për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të azilkerkuesve në Belgjikë dhe gjetkë e kanë kundërshtuar këtë model.

Sipas tyre, ai bie në kundërshtim të plotë me Konventën e Gjenevës të vitit 1951 dhe Deklaratën e Nju Jorkut të 12 Shtatorit 2016. Kjo e fundit i detyron vendet anëtare të pranojnë pa diskriminim azilkerkuesit për shkaqe lufte,

persekutimi, fatkeqësi natyrore, ndryshimeve klimatike dhe sipas të gjitha standardeve ndërkombëtarisht të njohura të njeriut. Deklarata e Nju Jorkut kërkon dhe një zgjidhje afatgjatë dhe të qëndrueshme.

Problemi i parë me këtë model ka të bëjë me shpenzimet marramendëse për identifikimin, pranimin dhe integrimin e azilkerkuesve të ardhur në vende të ndryshme që fare mirë do të ishin përdorur për qëllime të tjera të dobishme. Kështu, Australia ka akorduar një buxhet prej 3 miliardë euro për pesë vjet, kurse Gjermania në katër vitet e ardhshme do të shpenzojë plot 80 miliardë euro!

Shqetësimi tjetër është koncepti dhe praktika e pranimit selektiv të elitave ose «kremit» të azilantëve, siç e ve në dukje dhe instituti i mirënjohur australian «Lowy». Sipas «No way» në Australi pranohen vetëm emigrantë të bardhë, me nivel të lartë kualifikues dhe të rinj, por jo të tjerë.

E keqja më e madhe e këtij sistemi diskriminues është se largon trurin dhe elitën e vendeve të prapambetura që mbeten pa «motorin» e përparimit.

Nërkohë, kriza dhe tema të tilla të nxehta nuk mund të trajtohen e ca më pak të zgjidhen me releta dhe formula simpliste; as me urdhra administrativë dhe me «një të rënë të shkopit»; ca më keq me dëbime masive, ndërtime kampesh

dhe muresh duke i hedhur në det azilkerkuesit, por me strategji afat-gjata që fillojnë në vendet e origjinës.

Në këtë proces, krahas shtetit dhe qeverisë, përvoja tregon rëndësinë e madhe të bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe nisnat qytetare. Këtu shquhet Belgjika, ku gjatë dy viteve të fundit është krijuar «Platforma qytetare» me mbi 30.000 anëtarë. Krahas të tjerash, ajo siguron çdo darkë ushqim dhe fjetje për 400 azilkerkues pa dokumente. Për këtë ndihmesë të jashtëzakonshme, kjo nisimë u nderua me çmimin «Bruksel 2017». Kurse në Holandë, është krijuar Partia «Denk», e cila përfaqëson dhe mbrojtësit e refugjatëve dhe popullsisë me origjinë të huaj ndaj sulmeve që vijnë nga forcat e ekstremist të djathtë. Ajo ka fituar në shumë komuna në Amsterdam dhe shpreson të shtrihet dhe në vende të tjera dhe në zgjedhjet e Parlamentit Europian të vitit 2024.

Nisur nga sa sipër, parakushti kryesor për vënien në rrugën e zgjidhjes së kësaj krize është krijimi i një klime dhe mjedisi sa më miqësor ndaj azilantëve, me një vizion të ri dhe vullnetin e duhur politik, pa «sajesa dhe arnime ligjore» dhe jo siç ndodh në disa botime antiimigracion, sidomos në best seller «Vetëvrasja e Europës» të oksfordianit 38 vjeçar Douglas Murray; kur ky i fundit shkon deri aty sa të pohojë se «për shkak

të emigrantëve, evropianët kanë humbur vendlindjen!»

Kritika të shumta ndaj metodave simpliste dhe populiste në këtë fushë, që synojnë kryesisht kontrollin, largimin dhe dëbimin me forcë të emigrantëve ka dhe në Gjermani. Kohët e fundit, Seehofer, ministri i Brendshëm Federal dhe lideri i CSU-së bavareze ka propozuar ngritjen e disa qendrave pritëse «Anker» ku brenda gjashtë muajve do t'u jepet përgjigja azilkerkuesve me dokumente, ndërsa ata që janë pa të filla, do të presin deri në 18 muaj përpara vendimit përfundimtar.

Edhe ky propozim, ka hasur në shumë kritika dhe kundërshtitë, sepse nuk ndihmon zgjidhjen me rrënjë të problemit, pengon integrimin dhe nuk jep garanci për mosardhjen e refugjatëve të rinj. Veç shqetësimeve lidhur me azilkerkuesit e sëmure, të moshuar, fëmijë, gra, etj.

Propozimi tjetër i kundërshtuar është ndërprerja e fondeve të bashkëpunimit për zhvillim për vendet që nuk pranojnë të marrin mbapsh shtetasit e tyre. Mirëpo, sipas shumë ekspertëve dhe forcave politike, kjo nuk zgjidh gjë, madje e acarom më shumë këtë krizë. Sepse sot shtrohet çështja si të ndihmojmë dhe të shumë financiarisht vendet e origjinës, me qëllim që të përmirësohet niveli i jetesës dhe të shmanget fenomeni i azilit; por, shkurtimi i fondeve për zhvillim do të përkëqesojë më tej gjendjen në ato vende e për pasojë mund të priten valë të reja dhe më të mëdha emigrimi.

Në fakt, ky propozim është bërë dhe nga kryeministri hungarez Viktor Orban. Për këtë qëllim, ai ka propozuar përfshirjen e një klauzole dhe në Kushtetutë dhe i ka kërkuar BE-së që të mos akordojë asnjë cent për azilkerkuesit dhe politikant migratore. Në rast të kundërt, ai ka deklaruar se nuk do ta votojë buxhetin e saj të ri!

Ndaj, sot çështja themelore që pret përgjigje duke filluar nga Samiti i BE-së në fund të qershorit është se si mund të kontribuojnë shtetet, jo vetëm për kontrollin/menaxhimin e krizës, as për mbylljen e portave të brendshme dhe të jashtme të Europës apo duke e transferuar krizën jashtë saj; por për zgjidhjen e saj të qëndrueshme, me programe, strategji dhe veprime tërësore dhe afat-gjata. Vetëm kështu mund të ketë me riclikim të kësaj krize të pashembullt ose shfaqjen e saj në forma të tjera të rënda.

Për këtë, krahas ndihmës dhe bashkëpunimit me vendet e origjinës, suksesi kërkon forcimin e bashkëpunimit shumëpalësh dhe sidomos në kuadrin e BE-së dhe organizmat përkatëse të OKB-së; sepse asnjë vend i vetëm nuk mund të zgjidhë këtë problem madhor. Mirëpo, tendencat negative të nënvlefësisimit të multilaterizimit e për pasojë të këtyre grupeve nga ana e forcave nacionaliste dhe mbylljen hermetike të Evropës, në vend të zgjidhjes në fjalë, mund ta kthejnë këtë synim në «wishful thinking» ose «dëshirë të mirë» dhe asgjë më tepër.

Dje në "Europa e Lire"

# Ecja e ngadaltë e Kosovës me agjendën europiane

Nga Artan Konushevci

(vijen nga faqja 1)

... europiane, thonë zyrtarë të qeverisë dhe ata të shoqërisë civile. Funksionimi i ngadalshëm i Kuvendit të Kosovës, shihet si një prej pengesave më të mëdha në këtë drejtim.

Ministrja e Integritimit Europian në qeverinë e Kosovës, Dhurata Hoxha, thotë për Radion Europë e Lirë, se institucionet po vonojnë me miratimin e ligjeve që ndërlihen me agjendën për reformë europiane.

"Ne jemi vonë me agjendën për reformë europiane, prandaj duhet të procedojmë sa me shpejt me miratimin e këtyre ligjeve në Kuvendin e Kosovës. Po e shohim një ngecje apo vonesë, që po shkaktohet, e që besoj se ndoshta me një bashkëpunim më të mirë, qoftë të qeverisë, qoftë Kuvendit, së bashku të gjithë ta gjejmë një formulë që do të funksionojë dhe të shtyhet përpara agjenda e integritimit evropian", thotë Hoxha.

Ministrja Hoxha pranon se edhe qeverisë së Kosovës i duhet një dinamikë më e madhe në këtë drejtim: "Edhe ne, si qeveri, e kemi një pjesë të fajit, sepse edhe ne duhet të jemi më bashkëpunues me Kuvendin e Kosovës, por besoj se këtu duhet të punojmë që ta gjejmë një formulë që funksionon".


Kuvendi i Kosovës, aktualisht, ka më shumë se tridhjetë ligje që është duke i shqyrtuar, e të cilat kanë të bëjnë me integrimin evropian. Kuvendi i Kosovës para pak kohe ka miratuar nëntë projektligje që ndërlihen me agjendën për reformë europiane.

Pakojat e ligjeve që ndërlihen me integrimin evropian, është e madhe dhe në të bëjnë pjesë ligje nga sektorë të ndryshëm, si ai për sistemin e drejtësisë, pakojat e ligjeve antikorrupsion, ajo e reformave në administratën publike, për arsimin e të tjera.

Në rast të mosmiratimit të ligjeve që kanë të bëjnë me proceset integruese, sipas ministres Hoxha, Kosova si shtet, do të mbetet edhe më shumë mbrapa në këtë proces.

"Pra, nëse ne nuk arrijmë ta ndërtojmë një momentum që po ecim përpara, që jemi të përgatitur, institucionet po i marrin me përgjegjësi të plotë obligimet që na dalin nga procesi i integritimit evropian, atëherë ne vetëm mund të aplikojmë, por nëse nuk ka progres, mund të shkojmë me vite dhe nuk do ta marrim statusin e kandidatit. Procesi i liberalizimit të vizave ka treguar që institucionet e Bashkimit Europian janë institucione, të cilat kanë kritere dhe standarde dhe pa plotësimin e tyre, nuk lëvizin para", sqaron Hoxha.

Legjislatura aktuale e Kosovës



deri më tash është karakterizuar me planifikim të dobët të punës, kanë vlerësuar organizatat joqeveritare që monitorojnë punën e Kuvendit të Kosovës.

Artan Murati, analist nga Instituti Demokratik i Kosovës, thotë për Radion Europë e Lirë se puna e Kuvendit dhe efekti i vendimeve të saj është duke u demtuar jashtëzakonisht shumë. Ai

thotë se jo vetëm ligjet që kanë të bëjnë me integrimin evropian, por edhe ligjet e tjera Kuvendi nuk po arrin që t'i miratojë.

"Kuvendi, thjesht, nuk po arrin që ta përfundojë siç duhet ose nuk po mund ta përbushë rolin e vet legjislativ. Kjo vlen në masë të madhe për numrin për të gjitha ligjet, e këtu hyjnë edhe ligjet që kanë të bëjnë me reformën euro-

piane".

"Pra, nëse Kuvendi nuk do ta rrisë ritmin e vet të punës, është vështirë e besueshme se mund të qëndrojmë në hap me zhvillimet e nevojshme, të cilat kërkojnë pastaj edhe nga ne intervenim, qoftë ndryshim të ligjeve, apo miratim të ligjeve të reja. Kuvendi duhet të jetë shumë më aktiv dhe deputetët shumë më të përgjegjshëm për punën që janë duke bërë", vlerëson Murati.

Analistët thonë se fajin për jo-efikasitet në miratimin e ligjeve në Kuvendin e Kosovës, duhet ta mbajnë edhe partitë politike të përfaqësuara në legjislativ, si ato në opozitë, ashtu edhe ato në pushtet.

Mospajtimet dhe përplasjet e shpeshta ndërmjet deputetëve të partive politike, kanë bllokuar miratimin e shumë ligjeve dhe çështjeve të tjera.

Ministrja Hoxha pranon se edhe qeverisë së Kosovës i duhet një dinamikë më e madhe në këtë drejtim: "Edhe ne, si qeveri, e kemi një pjesë të fajit, sepse edhe ne duhet të jemi më bashkëpunues me Kuvendin e Kosovës, por besoj se këtu duhet të punojmë që ta gjejmë një formulë që funksionon".

## HOROSKOPI

### DASHI

Nëse po shqyrtoni mundësinë për një udhëtim, për argëtim apo për punë, mos u ktheni mbrapa. Parashikohen përvoja shumë interesante në vijim! Mund të pasuronit bagazhin tuaj kulturor me njohje dhe njohuri të reja. Me të vërtetë shumë mirë.

### DEMI

Mos u hidhni shumë përpjetë, nëse nuk doni të rrezikoni të rrëzoheni! Duhet të qëndroni me këmbë në tokë dhe të mos përfshihen nga aventura tepër të rrezikshme. Mendoni për pasojat e veprimeve që kryeni, do të shmangnit rrezikun për ta pësuar.

### BINJAKET

Kujdes nga kokëfortësia, sepse mund të sjellë gjëra të pakëndshme. Më mirë të udhëhiqeni nga dikë që ka më shumë përvojë sesa ju. Përvoja ju mëson, por nëse nuk jeni të sigurt për diçka njëqind përqind, nuk duhet as ta provoni.

### GAFORJA

Nëse në të kaluarën keni marrë një ndihmë të papritur, tani është koha ta ktheni favorin pa u tërhequr mbrapsht. Në fund edhe ju do të shpërbleheni. E rëndësishme është t'ia nisni mbarë: nganjëherë gatishmëria vlen, në disa raste, më shumë se çdo gjë tjetër.

### LUANI

Sot do të vini në jetë ide nismëtare. Jeni të palodhshëm, të aftë për të punuar pa ndaluar. Nganjëherë, megjithatë, nuk e kuptoni që e tejkaloni masën. Një ofertë pune duket shumë premtuese. Çfarë prisni për ta pranuar? Mos humbni kohë!

### VIrgjeresha

Ata që varen nga ju nuk bëjnë punën e tyre ashtu siç prisni, qortojni sigurisht, por pa e bërë të madhe. Nuk keni arsye përse ta bëni. Më mirë thojni gjërat siç janë, pa shumë lojë tjetër, në mënyrë të qartë, të drejtpërdrejtë dhe të saktë.

### PESHORJA

Shfrytëzoni favorizimin që planetët kanë për të zmadhuar dhuntitë tuaja dhe të përdorni çdo mënyrë për të vënë në vijë punët e juaja. Nganjëherë nuk duhet të lodheni shumë për të rënë në sy, mjafton të zgjidhni me kujdes mundësinë më të mirë.

### AKREPI

Keni të bëni me çështje të brendshme dhe familjare të pazgjidhura, dhe mund ta shfaqni më shumë sesa duhet nervozizmin. Përpunimi ndërkohë të jeni i mirëkuptueshmë. Mund të gjeni gjithmonë një pikë të përbashkët dhe të arrini kështu në një kompromis me të gjithë.

### SHIGJETARI

Planetët do të bëjnë që sot të ndiheni më materialistë sesa zakonisht. Por fatmirësisht pozicionimi i Uranit do t'ju ndihmojë që të çlironi fantazinë. Ndoshta zgjedhja që do të bëni nuk është ajo që do të pritej nga ju: po përdorni imagjinatën.

### BRICJAPI

Një ditë pa shumë bujë. Nëse mendoni se meritoni më shumë, nuk keni bërë llogaritë me ata me të cilët duhet të ndani meritat. Në fund do të dini si ta menaxhoni situatën, pasi nuk doni që të dilni keq.

### UJORI


Ndryshime të shpejta dhe pozitive me bashkëpunimin e Diellit me Hënë që ju favorizojnë. Në vazhdim e vendimeve të marra, popullariteti juaj do të pësojë një rritje! Pak krijimtari dhe fantazi në profesion do t'ju sjellë vlerësimin e një eprori.

### PESHQIT

Dilni nga kllapia dhe veproni menjëherë, nëse nuk doni që të ngeli mbrapa. Gjë që nuk është kushedi se çfarë, zakonisht. Për të gjetur çelësin e problemit, nevojitet që të keni qetësinë e duhur mendore dhe të mos shpejtoni.



**Fjalëkryqi (1)**



- 40. Në fillim të verës.
- 41. Cocker këngëtar.
- 43. Të fundit në tender.
- 44. Janë fletë trëndafili.
- 48. Fillojnë ideologjinë.
- 49. Është Krahinë e Athinës.
- 51. Emri i Zola.
- 52. Hari splune.
- 53. Janë kulla në xhami.

VERTIKAL

- 1. Njësi matëse për kondensator.
- 2. Artet pa re.
- 3. Fillojnë uraganin.
- 4. Nisin titrimin.
- 5. Janë në modë.
- 6. Inicialet e Kokoschka-s
- 7. Një mund të jetë ekspres
- 8. Mund të jenë ushtarake.
- 9. Jepen për hartim.
- 10. Janë të lira për hartim.
- 12. Është magjik ai i fatave
- 15. Janë aftësi prodhuese të fabrikës.
- 17. Një orgaizatatë humanitare
- 21. Janë shkurre.
- 22. Janë kapo kozakë.
- 23. Nino kompozitor.
- 24. Fillojnë teorinë.
- 27. Kryqyteti i asirëve.
- 31. Një verë në Paris.
- 32. Një vepër si romani.
- 34. Mbyllin një sherr
- 35. Kompozoi një Bolero.
- 37. Pak mbeturina
- 39. Një bëhet për të mirë.
- 42. Është dhomë.
- 44. Peter që humb hijen
- 45. Një pjesë e territorit.
- 46. Pak amerikanë.
- 47. Gjysmë litari.
- 49. Dy asa.
- 50. Kalimi në kufij.

HORIZONTAL

- 2. Një pikturë vetes.
- 11. Lindgren e Pippi çorapëgjatës.
- 13. Thirrej edhe kështu Persefoni.
- 14. Hapin ekspozitën.
- 16. Ruhet pa çifte.
- 18. Shiroka aktor.
- 19. Fillojnë masat.
- 20. Të parat në aksion.
- 21. Është gara më e gjatë.
- 25. Inicialet Pacino-s.
- 26. Janë sponsor të Tiranës.
- 28. Pavonë këngëtare.
- 29. Kështu thirrej Marco Pantani.
- 30. Dieta pa ekstreme.
- 32. Janë salla për projektione.
- 33. Duhet çarë më dritë.
- 36. Italia në tabela.
- 37. Janë katrorë në sipërfaqe.
- 38. Williams teniste.

**Fjalëkryqi (2)**

HORIZONTAL


- 1. Mondrian piktor.
- 5. Safin tenist.
- 9. Është e re pas Krishtit.
- 10. Janë grimca të familjes së adroneve të tilla.
- 12. Fillojnë matematikën
- 13. Mbarojnë fare
- 14. Josa trainer.
- 15. Në mes të dhomës.
- 17. Gjysma e inatit.
- 19. Ishin shkolla edukimi.
- 22. Janë ritransmetues televizivë.
- 24. Ishte djali që vrau Odiseun.
- 25. Një pjesë e opozitës
- 27. Një ekspres në binarë.
- 29. Kujt ia mbajnë... e mbështesin.
- 30. Mund të lakohen.
- 32. Një yll me bisht.

VERTIKAL

- 34. Italia në Internet.
- 35. Edouard piktor.
- 37. Shahu i fundit.
- 38. Gjysma e aortës.
- 40. Efekti... i François Truffaut.
- 41. Inicialet e Lendl
- 42. Kufizojnë një kënd.
- 44. Polanski regjisor.
- 46. Skuadër greke.
- 48. Britma e Armkimit.
- 49. Egoyan regjisor.
- 50. Fillojnë turnin.


VERTIKAL

- 1. Ishte shkolla e Arkimit.
- 2. Grandi këngëtare
- 3. Diftong teatral




- 4. I përkasin stinës së nxehtë.
- 5. Një shishe bombë.
- 6. Janë në qendër.
- 7. Ndiqet nga një mi
- 8. Janë këngëtarë lirikë.
- 10. Emër burri.
- 11. Një personazh i interpretuar nga Woody Allen.
- 15. Botom pa ekstreme.
- 16. Është figurë letrare.
- 18. Është enë kryesore gjaku.
- 20. Një pikë në liqj
- 21. Risia pa kufij
- 23. Ulen në Dhomën e lartë të tillë.
- 26. Janë fletë trëndafili.
- 28. Robert Mitchum.
- 29. Inicialet e Moravia-s.
- 31. Është si fatë.
- 32. Gjysma e ketrit.
- 33. Carolina e belle epoqe.
- 36. U shkrua nga Zola.
- 39. Me të bëhet trokë.
- 43. Duken të parat
- 45. Maten të parat.
- 47. Të parat në kufij.

**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

								6	
8			5	3					7
3	4	1							8
			5				9	1	
2	7		3				6		
							8	9	
	4	3				9	7		5
8		9	7				1		

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

4	6	2	7	8	9	5	1	3
5	3	7	6	1	4	2	9	8
9	1	8	5	2	3	4	6	7
7	2	5	8	3	6	9	4	1
3	9	1	4	5	2	8	7	6
6	8	4	9	7	1	3	2	5
1	4	3	2	6	5	7	8	9
2	7	6	3	9	8	1	5	4
8	5	9	1	4	7	6	3	2

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

*Argëtim filozofik*

-Çdo ditë e jetës sate është një faqe e biografit të sate, kujdesu ta shkruash mirë, sepse një faqe e keqe ndryshon gjithë librin. Njeriu duhet të përpiqet të mësojë çdo gjë, jo të tregojë veten e tij. - Askush nuk do të ngjiten mbi kurrizin tënd, nëse ti nuk përkulesh. - Një nga liritë më të mëdha është të mos interesohesh në të vërtetë se çfarë mendojnë të tjerët për ju.

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

7	15	3	6	4	6	5	1	4	1	7	F	T	F	S	T	O	P	K	P			
1	15		11	9	8	6		5	L	3	I	M	A	F	I	E	R	H	A	R	P	A
17		14	8	5	8	12	1	7	8	7	5	O	F	E	K	A	S	A	I	S		
6	3	7	9	6	1	13	8	7		14	8	K	O	F	A	N	A	T	I	K	E	T
17	9	6	19	13	3	7	3	7	3	7	13	A	F	E	N	O	M	E	N	A	L	E
9	16	8	15	1	7	9	15	8	7	7	7	K	A	R	A	M	E	L	E	I	R	
6		13	3		8	13	9			12	1	K	N	A	D	A	R	R	R	O		
16		4	13		13	3	6	1	5	5	3	O	I	T	A	L	I	A	R			
1	6	3	1	13	7		17			9	4	F	A	E	I	K	O	N	A	T		
13		9	7		8	17	3	16	9	15	8	I	R	T	O	T	A	L	I	T	A	R
3	7	15		8	7	3	5	8	13	3	8	N	A	F	D	E	N	S	H	T		
1	5	3	11	3		4	3	15	7	1	17	I	T	E	R	E	E	D	E	A	P	

PËRÇYLLI I FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

E	R	A	S	M	I	P	F	A	K	E	T	A	T
L	O	R	I	S	K	U	M	A	R	K	T	R	
U	N	I	K	S	A	N	P	R	S	E			
A	A	M	E	S	I	M	O	R	E	G			
R	B	M	E	R	E	M	E	T	I	M	E	T	
D	E	L	I	K	A	T	E	T	V	L	A		
S	A	R	A	F	E	T	R	A	C	E	R		
P	I	R	A	T	I	M	O	L	T	I	N	E	
M	I	G	E	N	A	R	E	N	A	T			
B	E	S	E	E	T	E	S	E	R				
A	T	A	E	T	A	S	A	K	R	A			
N	A	R	K	R	I	T	E	M	A				
P	A	Z	A	R	K	A	B	I	N	E	T		
I	K	O	N	K	E	E	T	I	M	Z			
T	M	S	E	K	E	E	T	E	R	I	O		
T	A	R	T	A	R	T	O	N	E	T	I	O	
T	M	T	I	T	I	A	N	E	T	I	N	A	
K	A	S	A	M	A	R	I	T	A	N	E		
E	L	I	M	A	N	E	E	D	S	H			
S	O	L	A	N	A	K	T	E	R	C	E		
I	D	B	O	R	G	U	R	E	R	O	S		
O	D	S	E	R	E	N	D	E	R				
K	A	N	N	A	S	A	R	A	H	E	P		
E	N	D	E	K	A	T	E	T	E	T	I		



*Thënie të mëdura*

- Është më lehtë t'i bësh keq një njeriu të mirë, se sa t'i bësh mirë një njeriu të keq.
- Statistikat janë si minifundet. Ato tregojnë shumë, por fshehin thelbin.
- Askush nuk është aq i pasur që të mos ketë nevojë për një buzëqeshje.
- Dhe askush nuk është aq i varfër që të mos mund ta japi!

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

# GAZETA SHQIPTARE

# GSH.AL

# GSH

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

## Tashmë edhe lundroni!

